1060	RREGULLORE NR. 03/2008 MBI AKTIVITETET KONSERVUESE DHE RESTAURUESE TË TRASHËGIMISË KULTURORE.	Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve	09.09.2008	Rregulloja ka bazë specifike ligjore (shih: Ligji NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE nenet 4, 6 dhe 9)	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	
1061	RREGULLORE NR. 02/2008 MBI QASJEN PUBLIKE NË TRASHËGIMINË KULTURORE NË PRONËSI PRIVATE.	Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve	09.09.2008	Rregulloja ka bazë të përgjithshme ligjore (shih: Ligji NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE nenet 5)	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	
1062	RREGULLORE NR. 01/2008 MBI PROCEDURAT PËR GËRMIMET/HULUMTIMET ARKEOLOGJIKE.	Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve	09.09.2008	Rregulloja ka bazë specifike ligjore (shih: Ligji NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE neni 7)	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	
1063	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 01/2021 PËR MASAT DHE PROCEDURAT E PRANIMIT DHE PËRDORIMIT TË TË DHËNAVE TË IPU DHE REU	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	18.03.2021	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 23, 24, 62 dhe 63 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, nenin 8 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Pas analizimit të këtij udhëzimi administrativ, shohim se ky udhëzim nuk është nxjerr në pajtim me dispozitat ligjore të ligjit përkatës. Kjo për arsyeje se ligji nuk autorizon ministrin në asnjë dispozitë të tij për nxjerrjen e një akti nënligjor të tillë siç është ky udhëzim administrativ. Pastaj, udhëzimi në fjalë thirret edhe në nenin 63 paragrafi 3, e cila dispozitë është e përgjithshme dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1064	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 01/2020 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI TË INFRASTRUKTURËS ELEKTROENERGJETIKE DHE PAJISJEVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	23.06.2020	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 38 të Ligjit nr.04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Në dispozitat kalimtare, në nenin 38 të Ligjit nr.04/ L-012 për mbrojtje nga zjarri, në mënyrë të përgjithshme, është përcaktuar nxjerrja e një numri të pakufizuar të akteve nënligjore lidhur me kushtet dhe mbrojtjen nga zjarri, në të cilin nen mbështet ky udhëzim administrativ. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1065	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 03/2020 PËR THEMELIMIN DHE PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË PUNËS SË KOMISIONIT TË ANKESAVE PËR SHTETËSI	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	27.07.2020	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 33 të Ligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ky rekomandim vjen si rezultat i asaj se udhëzimi administrativ është nxjerr në mbështetje të nenit 33 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës, respektivisht në dispozitat përfundimtare të ligjit dhe formulimi që është përdorur në këtë dispozitë është shumë i përgjithshëm. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1066	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 04/2020 PËR REFUZIMIN E HYRJES NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	01.09.2020	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 31, 32, dhe nenit 137, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe në lidhje me Ligjin Nr.06/L036 për Ndryshim Plotësimin e Liqit Nr.04/L219 për të Huajt.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e liqit.	Ky rekomandim është rezultat i harmonizimit të plotë të bazës ligjore në mes aktit nënligjor dhe dispozitës ligjore, respektivisht nenit 31 të Ligjit për të huajt. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1067	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 05/2020 PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E FITIMIT TË SHTETËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	04.09.2020	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 5 dhe 33 të Ligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Nga analiza e këtij udhëzimi del se mungon baza juridike ligjore, pasi që neni 5 i ligjit përcakton mënyrat e fitimit të shtetësisë, por nuk parashih lejitimin/detyrimin në mënyrë të duhur për nxjerrjen e aktit nënligjor. Gjithashtu të përcaktuar e lejimit të nxjerrjes së aktit nënligjor në formë blankete, është formë e gabuar e formulimit të dispozitës ligjore, aq më tepër kur udhëzohet në dispozitat kalimtare ku është formulim i përgjithshëm se mund të nxirren aktet e nënligjore, pa e specifikuar konkret se për cilat raste është e nevojshme nxjerrja e aktit nënligjor. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1068	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 06/2020 PËR PROCEDURËN DHE KRITERET E PËRCAKTIMIT TË STATUSIT TË PERSONIT PA SHTETËSI, MËNYRA E FITIMIT TË SHTETËSISË PËR PERSONIN PA SHTETËSI DHE PERSONIN ME STATUS TË REFUGJATIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	04.09.2020	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 15, të Ligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandimi për mbetje në fuqi të këtij udhëzimi administrativ është, nga njëra anë rezultat i nevojës për sqarimin e procedurave dhe kriterëve për njohjen e statusit të personit pa shtetësi, të drejtat e sigurisë pa shtetësi, si dhe mënyra e fitimit të shtetësisë për personin me status të pa shtetësisë dhe personit me status të refugjati në Republikën e Kosovës, nga ana tjetër rezultat i harmonizimit të bazës juridike ligjore në mes të udhëzimit administrativ dhe dispozitave ligjore në fuqi.
1069	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 07/2020 PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË POLICISË PËR PERCJELLJE POLICORE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	07.09.2020	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 181, paragrafi 5 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe nenin 7, paragrafi 3 të Ligjit 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksploziveve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në dispozitat ligjore, përkatësisht në nenin 181, paragrafi 5 të ligjit për rregullat e trafikut rrugor, si dhe në neni 7 paragrafi 3 i ligjit për përdorimin civil të eksploziveve, përcaktohet nxjerrja e një akti nënligjor nga ministria për procedurën e kërkesave të lejes për angazhim dhe përcjelljes së eksploziveve apo fshëkjarrëve, si dhe për mënyrën e mbulimit të shpenzimeve të policisë për lëshimin të lejeve dhe për angazhimin të përcjelljes. Akti nënligjor i krijuar nga ministri i punëve të brendshme, e që është ky udhëzim administrativ pikërisht mbulon fushat e lart cekura në dispozitat ligjore. Andaj, pasi që udhëzimi administrativ ka bazë ligjore të mirëfilltë dhe në përputhje me dispozitat ligjore, rekomandohet që të mbetet në fuqi.
1070	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.08/2020 PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, PËRMBAJTJES DHE PROCEDURËS SË LËSHIMIT TË PATENTË SHOFERIT NËRKOMBËTAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	11.09.2020	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 98 dhe nenin 134 paragrafi 1 i Ligjit 05/L-064 për Patent Shoferi.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Nga analiza e këtij udhëzimi del se mungon baza juridike ligjore në kuptimin e duhur, për arsye se: neni 98 i Ligjit për Patentë Shoferi i referohet rregullimit të çështjes me patentë shoferi ndërkombëtar por nuk përcakton autorizimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për nxjerrjen e aktit nënligjor në mënyrë shprehore. Kurse neni 134 shihet se është pjesë e dispozitave kalimtare që referohet kohës në të cilën duhet nxjerr aktet ligjore për zbatimin e këtij ligji. Madje, formulimi i përdorur në nenin 134 paragrafi 1, është i përgjithshëm, pra dispozita në fjalë nuk përcakton se cilat akte nënligjore do të nxjerrten dhe ekziston mundësia që në formë të pakufizuar të nxirren akte nënligjore. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1071	RREGULLORE (MPB) NR. 01/2020 PËR PËRMBAJTJEN, ADMINISTRIMIN DHE PËRDORIMIN E DOSJES SË PERSONELIT DHE SISTEMIT INFORMATIV TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	11.08.2020	Kjo rregullore mbështetet në nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të dispozitave në të cilat thirret kjo rregullore, respektivisht nenit 17 paragrafi 7 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, vërehet se dispozita në fjalë shprehimisht autorizon ministrin për nxjerrjen e një akti nënligjor, siç është edhe kjo rregullore. Andaj duke parë se rregulloja ka bazë të mirëfilltë ligjore, rekomandohet që rregulloja të mbetet në fuqi.
1072	RREGULLORE (MPB) NR. 02/2020 PËR PLANIFIKIMIN E PERSONELIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	11.08.2020	Kjo rregullore mbështetet në nenin 15, paragrafi 6, të Ligjit nr. 06/L- 114 për Zyrtarët publikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandimi i tillë vije pas konstatimit të ekzistimit të bazës së mirëfilltë ligjore, e cila është në harmoni me dispozitat ligjore, specifkisht me nenin 15 paragrafi 6, i cili nen në mënyrë eksplicite përcakton nxjerrjen e kësaj rregullore.
1073	RREGULLORE (MPB) NR.03/2020 PËR LARTËSIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE FORENZIKE NË AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	14.10.2020	Kjo rregullore mbështetet në nenin 23, paragrafi 6, të Ligjit Nr.04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, nenin 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L048 për Menaxhimin e Financave Publike.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Kjo rregullore në preambulë të saj, përcakton se mbështetet në nenet 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L048 për Menaxhimin e Financave Publike, mirëpo këto nene nuk parashohin nxjerrjen e një akti nënligjor siç është kjo rregullore. Po ashtu, në hyrje të kësaj rregulloreje, përcaktohet mbështetja në nenin 23 paragrafi 6, në të cilin nen kam evidentuar që nuk është në pajtim me parimin e ligjshmërisë, për arsyeje që ka një përmbajtje të përgjithshme, dhe i jep autoritet ministrat apo edhe Kryeshfitit ekzekutiv të AKF-së të nxjerr çfarëdo akte nënligjore, edhe për ato akte që nuk është përcaktuar në mënyrë eksplicite në ligj. Si pasojë e një analize të tillë, konstatohet se qëllimi i kësaj rregulloreje nuk përputhet me dispozitat ligjore në fuqi andaj dhe rekomandohet që rregulloja të shfuqizohet.

1074	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.01/2019 PËR PROCEDURAT DHE STANDARDET E PRANIMIT DHE TRAJTIMIT FILLESTAR TË APLIKUESËVE PËR MBROJTJE NËR KOMBËTARE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	12.02.2019	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 108 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-026 për Azil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ky udhëzim administrativ në preambulë thirret në nenin 108 paragrafi 2, respektivisht në dispozitat kalimtare të ligjit për Azil. Formulimi që është përdorur në këtë dispozitë është shumë i përgjithshëm dhe formulimi i tillë bënë të mundur krijimin e akteve nënligjore në mënyrë të pakufizuar. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1075	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 02/2019 PËR PROCEDURAT DHE STANDARDET E SHOYRTIMIT DHE MARRJES SË VENDIMIT LIDHUR ME APLIKACIONIN PËR MBROJTJE NËR KOMBËTARE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	12.02.2019	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 108 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-026 për Azil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ky rekomandim vjen si rezultat i asaj se udhëzimi administrativ në preambulë thirret në nenin 108 paragrafi 2, respektivisht në dispozitat kalimtare të ligjit për Azil. Formulimi që është përdorur në këtë dispozitë është shumë i përgjithshëm dhe formulimi i tillë bënë të mundur nxjerrjen e akteve nënligjore në mënyrë të pakufizuar. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1076	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 03/2019 PËR KTHIMIN E TË HUAJVE ME QËNDRIM TË PALIGJSHËM NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	15.03.2019	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 137, paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 dhe paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky akt nënligjor në preambulë thirret në nenin 137 respektivisht në dispozitat kalimtare të ligjit për të huajt, në paragrafin 1 nënparagrafi 1.6 ku shprehimisht përcaktohet se ministri do të nxjerr akt nënligjor për të rregulluar çështjet të cilat i përcaktuar në ligj. Nga analiza e dispozitave të ligjit për të huajt del se baza e mirëfilltë për këtë udhëzim administrativ është edhe në neni 94 par. 10, neni 97 par. 8 dhe neni 106 par.3, prandaj si u tha më sipër, është rekomanduar mbetja në fuqi.
1077	UDHËZIM ADMINISTRATIV MPB NR. 04/2019 PËR PERMBAJTJEN E EVIDENCAVE NË LËMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE MËNYRËN E MBAJTJES SË TYRE NGA AGJENCIA DHE KOMUNA	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	08.04.2019	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 30 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandohet që udhëzimi në fjalë të mbetet në fuqi, pasi që ka bazë ligjore të mirëfilltë. Ky udhëzim administrativ mbështetet në neni 30 paragrafi 2 të ligjit për mbrojtje nga zjarri, e cila dispozitë shprehimisht parashihet krijimin e një akti nënligjor i cili akt rregullon përbërjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave nga agjencia dhe komuna. Andaj, përdërsa ky udhëzim ka bazë ligjore, respektivisht mbështetet në neni 30 paragrafi 2, rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1078	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 06/2019 PËR PROCEDURËN E HUMBJES SË SHITESISË SË KOSOVËS ME LIRIM DHE PRIVIM	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	09.07.2019	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 19 dhe 33, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Nga analiza e këtij udhëzimi del se mungon baza juridike ligjore, pasi që neni 19 i ligjit përcakton mënyrat e humbjes së shtetësisë, por nuk parashihet lejimin/detyrimin në mënyrë të duhur për nxjerrjen e aktit nënligjor. Gjithashtu në nenin 33 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës i cili nen është pjesë e dispozitave kalimtare, ky nen ka formulim të përgjithshëm ku përcakton se mund të nxirren aktet nënligjore, pa e specifikuar konkret se për cilat raste është e nevojshme nxjerrja e aktit nënligjor. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1079	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 07/2019 PËR REGJISTRIMIN E MJETEVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	09.07.2019	Ky udhëzim administrativ mbështetet në Kapitullin VI neni 42, të Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim është si rezultat i harmonizimit të plotë të bazës ligjore në mes aktit nënligjor dhe dispozitës përkatesë të Ligjit për Automjete.
1080	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 08/2019 PËR PERKARTIMIN E PAJISJEVE MBROJTËSE, TEKNIKE DHE MJETEVE PËR ZJARRFIKJE DHE SHPËTIM	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	23.07.2019	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 25 të Ligjit nr.04/L049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi i tillë vije pasi që në nenin 25 të cilin është thirrë ky udhëzim administrativ, është i përgjithshëm dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Mbështetja në këtë nen, nuk parashihet bazë ligjore për nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1081	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 09/2019 PËR PROCEDURËN DHE KRITERET E LËSHIMIT TË LEJES SË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	03.09.2019	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 137, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, dhe në nenin 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-036 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr.04/L219 për të Huajt.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandimi i tillë është rezultat i harmonizimit të bazës ligjore të udhëzimit administrativ në fjalë me dispozitat e ligjit në fuqi.
1082	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 02/2018 PËR REGJISTRIMIN E MJETEVE ME TARGA KS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	16.03.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në Kapitullin VI neni 43, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë	Ky udhëzim administrativ është i shfuqizuar me vendim të ministrit. Andaj rekomandohet të hiqet edhe nga regjistri i Akteve Nënligjore të MPB.
1083	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 03/2018 PËR PERKARTIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË PATENTË SHOFERIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	16.03.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 105, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim vjen si rezultat i harmonizimit të bazës ligjore në mes aktit nënligjor dhe dispozitës përkatesë të Ligjit për Patentë Shofer.
1084	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 04/2018 PËR KATEGORIZIMIN DHE KLASIFIKIMIN E OBJEKTEVE NË KATEGORINË PËRKATËSE TË RREZIKSHMËRISË NGA ZJARRI	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	08.05.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ mbështetet në neni 7, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, në të cilën dispozitë përcaktohet që ministria me akt nënligjor do të përcaktojë kriteret për kategorizimin dhe klasifikimin e objekteve në kategorinë përkatesë të rrezikshmërisë nga zjarri. Duke parë që udhëzimi administrativ ka bazë ligjore në përputhje me dispozitat ligjore, rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1085	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 05/2018 PËR PROCEDURAT E PAJISJES ME LETËRNJOFTIM	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	12.07.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 24, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim vjen si rezultat i asaj se udhëzimi administrativ ka bazë ligjore specifike edhe pse nuk është e përcaktuar në preambulë mbështetja e udhëzimit administrativ në nenin 13 paragrafin 6 por vetëm në nenin 24 paragrafi 2 në kuadër të dispozitave kalimtare të Ligjit për Letërnjoftim. Andaj, konsideroj që më e preferueshme do ishte që baza ligjore për nxjerrjen e këtij Udhëzimi të mbetet vetëm në kuadër të Kreut IV të Ligjit, sepse baza ligjore e përsëritur edhe në dispozitat kalimtare është e panevojshme.
1086	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.06/2018 PËR PROCEDURAT E PAJISJES ME PASAPORTE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	12.07.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në kreun IV, të Ligjit nr.03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ e ka bazën ligjore specifike në ligj në kuadër të kuadër të dispozitave kalimtare përkatesë të kreun VIII nenin 36 pika c. Kjo dispozitë e parashihet se për procedurën e pajisjes me pasaportë do nxirret akt nënligjor. Meqenëse akti nënligjor ka bazë juridike përkatesë në ligj, rekomandohet që të mbetet në fuqi. Edhe pse udhëzimi ka bazë juridike në Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit, ky udhëzim thirret në kreun IV të ligjit. Prandaj rekomandohet që ky udhëzim administrativ në mënyrë që të harmonizohet me dispozitat e ligjit duhet të ndryshohet ashtu që në preambulë të thirret se është nxjerrë duke u bazuar në kreun VIII nenin 36 pika c të Ligjit nr. 03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit.
1087	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 07/2018 PËR MBAJTJEN DHE QASJEN NË EVIDENCËN E TË DHËNAVE PËR AKSIDENTET NË TRAFIK PËR SHOFERËT DHE PËR MJETET	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	28.08.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 256 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në Ligjin Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, neni 256 paragrafi 3, shprehimisht përcakton nxjerrjen e një akti nënligjor, qëllimi i të cilit akt nënligjor i përcaktuar në këtë dispozitë përputhet me qëllimin e këtij udhëzimi administrativ. Nga ky fakt, konstatohet se udhëzimi administrativ ka bazë të mirëfilltë dhe rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1088	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 08/2018 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJEN E DEPOVE NGA ZJARRI DHE SHPËRTHIMET	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	17.09.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 38 të Ligjit nr.04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Në dispozitat kalimtare, në nenin 38 të Ligjit nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, përcaktohet në mënyrë të përgjithshme, nxjerrja e një numri të pakufizuar të akteve nënligjore lidhur me kushtet e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, në të cilin nen mbështetet ky udhëzim administrativ. Ky formulim i tillë i cili e autorizon ministrin për nxjerrje të pakufizuar të akteve nënligjore. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1089	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 09/2018 PËR LEGALIZIMIN E ARMËVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	05.11.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municioneve dhe Mjeteve Shpërthyes.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim është rezultat i harmonizimit të bazës ligjore në mes udhëzimit administrativ në fjalë dhe dispozitës përkatesë të Ligjit për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municioneve dhe Mjeteve Shpërthyes.
1090	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.10/2018 PËR TRAJNIMIN FILLESTAR NË FUSHËN E MBROJTJES NGA ZJARRI	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	19.12.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 38 të Ligjit nr.04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandimi i tillë vije si rezultat i asaj që udhëzimi administrativ ka bazë ligjore, mirëpo kjo bazë ligjore gjendet në kuadër të nenit 32 të Ligjit për mbrojtje nga zjarri, andaj edhe është rekomanduar që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi por të thirret në nenin 32, pasi që aty e ka bazën ligjore të mirëfilltë.



1091	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 11/2018 PËR PËRDORIMIN E KOPJEVE TË CERTIFIKUARA TË REGJISTRAVE ORIGJINAL THEMELTAR TË GJENDJES CIVILE TË KOSOVËS, TË CILËT JANË MARRË NGA ISH-PUSHTETI SERB, PARA QERSHORIT TË VITIT 1999	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	21.12.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 66, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ky udhëzim administrativ në preambulë thirret në nenin 66 paragrafi 5, respektivisht në dispozitat kalimtare të ligjit për gjendjen civile. Formulimi që është përdorur në këtë dispozitë është shumë i përgjithshëm dhe formulimi i tillë bënë të mundur krijimin e akteve nëligjore në mënyrë të pakufizuar. Andaj, rekomandohet që Ministria të rishikojë dispozitat e ligjit për të shikuar se a ka nevojë për akt nëligjor apo jo, e nëse ka nevojë, atëherë t'i krijohet baza juridike, duke parashikuar në mënyrë shprehimore nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ që në mënyrë më të hollësishme do ta rregullonte çështjen për përdorimin e kopjeve të certifikuara të regjistrave original themeltar të gjendjes civile të Kosovës, të cilët janë marrë nga ish-pushteti serb, para qershorit të vitit 1999.
1092	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 12/2018 PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË PROVIMIT PROFESIONAL PËR ZYRTARË TË GJENDJES CIVILE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	28.12.2018	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 66, paragrafi 2, nënparagrafi 2.9 të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në Ligjin nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, në neni 61 paragrafi 2, përcaktohet shprehimisht që kushtet dhe procedurat për dhënie e provimit profesional për zyrtar të gjendjes civile do të rregullohen me akt nënligjor. Udhëzimi administrativ ka bazë ligjore specifike edhe pse nuk është e përcaktuar në preambulë mbështetja e udhëzimit administrativ në nenin 61 par. 2 por vetëm në nenin 66 par. 2 nënparagrafi 2.9 në kuadër të dispozitave kalimtare të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile. Andaj, konsiderohet që më e preferueshme do ishte që baza ligjore për nxjerrjen e këtij Udhëzimi të mbetet vetëm në nenin 61 paragrafi 2, sepse baza ligjore e përsëritur edhe në dispozitat kalimtare është e panevojshme.
1093	RREGULLORE (MPB) NR. 01/2018 PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR KËRKIM DHE SHPËTIM NË AVIACIONIN CIVIL	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	28.08.2018	Kjo rregullore mbështetet në nenin 84, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Përderisa neni në të cilin është mbështet kjo rregullore, përkatësisht neni 84 paragrafi 2, parasheh nxjerrjen e një rregulloreje, siç është rregullorja nr. 01/2018 që përcakton rregullat dhe procedurat për ushtrimin e kërkim-shpëtimin, konstatohet që baza juridike ekziston dhe është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, andaj dhe rekomandohet që e njëjta të mbetet në fuqi.
1094	RREGULLORE (MPB) NR. 02/2018 PËR METODOLOGJINË E GRUMBULLIMIT, PËRPUNIMIT, MBAJTJES DHE KOMUNIKIMIT TË TË DHËNAVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	15.10.2018	Kjo rregullore mbështetet në nenin 52 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, në nenin 52 paragrafi 4, në mënyrë shprehimore përcakton se për grumbullimin, përpunimin, mbajtjen dhe komunikimin e të dhënave do të nxirret një akt nënligjor. Përderisa ekziston përputhja e bazës ligjore me dispozitat ligjore, respektivisht me nenin 52 paragrafi 4, rekomandohet që rregullorja në fjalë, të mbetet në fuqi.
1095	RREGULLORE (MPB) NR. 03/2018 PËR FUNKSIONIMIN E QENDRËS PËR AZIL	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	21.12.2018	Kjo rregullore mbështetet në nenin 53 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-026 për Azil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim është si rezultat i harmonizimit të bazës ligjore në mes aktit nënligjor dhe dispozitës përkatëse të Ligjit për Azil.
1096	RREGULLORE (MPB) NR. 04/2018 PËR FUNKSIONIMIN E QENDRËS PËR MBAJTJEN E TË HUAJVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	26.12.2018	Kjo rregullore mbështetet në nenin 137, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ky rekomandim vjen si rezultat i asaj se akti nënligjor thirret në nenin 137 paragrafi 5, respektivisht në dispozitat kalimtare të ligjit për të huajt, ku përcakton se: Për zbatim të këtij ligji mund të nxirren edhe akte tjera nënligjore. Formulimi që është përdorur në këtë dispozitë është shumë i përgjithshëm dhe formulimi i tillë i cili bënë të mundur nxjerrjen e akteve nëligjore në mënyrë të pakufizuar. Andaj, rekomandohet që Ministria të rishikojë dispozitat e ligjit në fjalë, për të gjetur se a ka nevojë për akt nënligjor apo jo, e nëse ka nevojë, atëherë t'i krijohet baza juridike, duke parashikuar në mënyrë shprehimore nxjerrjen e këtij akti nënligjor që në mënyrë më të hollësishme do ta rregullonte çështjen për funksionimin e qendrës për mbajtjen e të huajve.
1097	RREGULLORE (MPB) NR. 01/2017 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË INSPEKTORATIN POLICOR TË KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	13.01.2017	Kjo rregullore mbështetet në nenin 31 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rregullorja në fjalë, ka bazë ligjore në nenin 31 të Ligjit për Inspektoratin e Policisë së Kosovës, dhe duke parë që kjo rregullore mbështetet pikërisht në këtë dispozitë, rregullorja ka bazë ligjore të harmonizuar me dispozitat ligjore dhe rekomandohet që e njëjta të mbetet në fuqi.
1098	RREGULLORE (MPB) NR. 02/2017 PËR ORGANIZIMIN DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË POLICISË SË KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	31.07.2017	Kjo rregullore mbështetet në nenin 33, paragrafi 5, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Rekomandohet që rregullorja në fjalë të harmonizohet me ligjin që është në fuqi, pasi që kjo rregullore mbështetet në në nenin 33, paragrafi 5, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, i cili ligji është shfuqizuar. Ligji i cili tanimë është në fuqi është Ligji Nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të pavarura. Në nenin 28 të Ligji Nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të pavarura, paragrafi 3 parasheh nxjerrjen e aktit nënligjor për organizimin e brendshëm edhe të agjencive ekzekutive siç është Policia e Kosovës, mirëpo gjithnjë duke pasur parasysh që autoritet për nxjerrjen e këtij akti nënligjor sipas ligjit është Kryeministri, andaj përderisa me ligjin i cili tashmë është i shfuqizuar nxjerrja e këtij akti nënligjor parashtej nga organi udhëheqës në konsultim me ministrin tanimë është përcaktuar që kjo është kompetencë e Kryeministrit, prandaj është propozuar që të bëhet harmonizimi me ligjin që është në fuqi.
1099	RREGULLORE (MPB) NR. 03/2017 PËR MARRJEN, DOKUMENTIMIN, EVIDENTIMIN, RUAJTJEN DHE TRANSPORTIMIN E PROVAVE MATERIALE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	31.05.2017	Kjo rregullore mbështetet në nenin 19, paragrafi 3, neni 23, paragrafi 6 të Ligjit nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandimi i tillë vije pasi që neni 19 paragrafi 3, autorizon nxjerrjen e një akti nënligjor siç është kjo rregullore për përcaktimin e procedurës për marrjen, dokumentimin, evidentimin, ruajtjen dhe transportimin e provave materiale. Duke parë që kjo rregullore është nxjerr nga autorizimi i dispozitave ligjore në fuqi, rekomandohet që e njëjta të mbetet në fuqi.
1100	RREGULLORE (MPB) NR. 04/2017 PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE TË HOLLËSISHME PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE THEMELORE TË PËRBASHKËTA NË FUSHËN E SIGURIMIT TË AVIACIONIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	26.09.2017	Kjo rregullore mbështetet në nenin 90, paragrafi 90.3 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në preambulën e kësaj rregulloreje, përcaktohet mbështetja në nenin 90 paragrafi 90.3 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, në të cilën dispozitë përcaktohet nxjerrja e rregulloreve të cilat i bëjnë rregullat ndërkombëtare të sigurimit në aviacion, të aplikueshme për shërbimet ajrore vendore. Duke parë që qëllimi i kësaj rregulloreje përputhet me dispozitën ligjore të lartcekur, konstatohet se rregullorja ka bazë të mirëfilltë ligjore dhe rekomandohet të mbetet në fuqi.
1101	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 01/2017 PËR PROCEDURAT LIDHUR ME KUSHTET E PUNËSIMIT DHE TË PUNËS PËR PUNONJËSIT E IPK-SË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	13.01.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 16, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të udhëzimit administrativ dhe dispozitave të Ligjit për IPK, vërejtja se udhëzimi administrativ ka bazë ligjore të mirëfilltë, dhe në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi, andaj rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi.
1102	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 02/2017 PËR PROCEDURËN E PAJISJES ME PATENTË SHOFERI TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	28.03.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 75, 91, 92, 99 nenit 105, nënparagrafi 1.2 dhe nenit 134, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Nga analiza e këtij udhëzimi administrativ del se baza juridike gjendet në neni 75 të Ligjit për patentë shoferi, sepse rregullon mënyrën e aplikimit dhe pajisjes me patentë shofer, ani pse nuk parasheh nxjerrjen e aktit nënligjor në mënyrë shprehimore, në parim kuptohet që Ministria i përcakton kushtet dhe procedurat për aplikim për patentë shofer nëpërmjet aktit nënligjor. Baza ligjore e udhëzimit administrativ gjendet edhe në nenin 99 paragrafi 2 dhe nenin 105 nënparagrafin 1.2, të përcaktuar si në preambulën e këtij udhëzimi. Për këtë arsye edhe është rekomanduar që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi. Ndërsa udhëzimi administrativ nuk ka bazë të mirëfilltë në nenet tjera që figurojnë në preambulën e këtij udhëzimi. Rrjedhimisht, Neni 91 i referohet lëshimit të patentë shoferit kur plotësohen kushtet e parapara me ligji, por nuk përcakton më tej se procedura për lëshim/pajisje me patentë shofer do të rregullohet me akt nënligjor që e nxjerr Ministria. Neni 92 i referohet kohëzgjatjes së vlefshmërisë së patentë shoferit por nuk ka përcaktuar nxjerrjen e aktit nënligjor për rregullimin e kohëzgjatjes së vlefshmërisë së patentë shoferit. Kurse neni 134 shpreh se është pjesë e dispozitave kalimtare që referohet kohës në të cilën duhet nxjerr aktet ligjore.
1103	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 03/2017 PËR SISTEMIN ELEKTRONIK TË PATENTË SHOFERËVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	23.03.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 81, 105, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ky rekomandim vjen si rezultat i mospërputhjes se dispozitave ligjore në mes të aktit nënligjor dhe ligjit për patentë shoferi. Nga përmbajtja e udhëzimit shihet se qëllimi është që të rregullohet procedura e krijimit dhe të funksionimit të sistemit bazë të të dhënave për patentë shoferi të Republikës së Kosovës si dhe përcaktimi i rregullave për shfrytëzimin dhe qasjen në sistemin bazë të të dhënave për patentë shoferi të Republikës së Kosovës. Mirëpo, nga ana tjetër po t'i referohemi nenit 81 dhe 105 të Ligjit për Patentë shofer shihet se ka mospërputhje, pra udhëzimi është pa bazë ligjore. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1104	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 04/2017 PËR PËRDORIMIN E ARMËVE DHE MUNICIONEVË TË KATEGORISË C8 PËR PASIVIZIM TË PËRKOHSHËM TË KAFSHËVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	30.06.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 4 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky udhëzim administrativ thirret në nenin 4 paragrafi 4 të ligjit për armë. Pas analizimit të dispozitës në fjalë, vërejtja se baza ligjore është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Andaj, rekomandohet që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi.

1105	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 05/2017 PËR KRITERET QË PËRBEJNË DËSHMI PËR SHITËSINË E ISH-RFJ-SE DHE BANIMIN E PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOSOVËS MË 1 JANAR 1998	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	14.07.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 32, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim është si rezultat i harmonizimit të bazës ligjore në mes të udhëzimit administrativ dhe dispozitës përkatëse të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës.
1106	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 06/2017 PËR PROGRAMIN, MËNYRËN E AFTËSIMIT DHE VEPRIMET E NJËSIVE SHKOLLLORE TË TRAFIKUT, RROBAT DHE EMBLEMAT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	29.08.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 6 paragrafi 4 të Ligji Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të këtij udhëzimi administrativ, konstatohet se ky udhëzim është nxjerr në pajtim me dispozitat ligjore të ligjit përkatës, andaj rekomandohet që udhëzimi të mbetet në fuqi.
1107	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 07/2017 PËR NDËRRIMIN E PATENTË SHOFERIT TË HUAJ, NË PATENTË SHOFERË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	21.07.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 97, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-64 për Patentë Shoferi.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim, pra që akti nënligjor në fjalë të mbetet në fuqi, është si rezultat i harmonizimit të bazës ligjore në mes të udhëzimit administrativ dhe dispozitës përkatëse të Ligjit për Patentë Shoferi.
1108	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 08/2017 PËR POLIGONET E QITJES PËR SUBJEKTET QË POSEDOJNË PAJISJE PËR QËLLIME TË VEÇANTA	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	21.07.2017	Ky udhëzim administrativ bazohet në nenin 36 paragrafi 1. nënparagrafi 1.9 të Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në kreun VIII të ligjit Nr. 03/L-246 Për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, në dispozitat kalimtare neni 36 paragrafi 1 nënparagrafi 1.9 është përcaktuar në mënyrë eksplicite nxerrja e aktit nënligjor për poligonet e qitjes për subjektet që posedojnë pajisje për qëllime të veçanta, në të cilën dispozitat është thirrë edhe ky akt nënligjor. Andaj përderisa ekziston baza ligjore, rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi.
1109	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 09/2017 PËR ARMET KOLEKSIONUESE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	21.07.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 2 paragrafi 1 nënparagrafi 1.29 dhe nenit 73 paragrafi 1.8 të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim vjen si rezultat i asaj se udhëzimi administrativ ka bazë ligjore në pikën 1.29.3 të nenit 2 dhe në nenin 73 paragrafi 1.8, të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë.
1110	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 10/2017 PËR VENDOSJEN E PAJISJEVE TË VEÇANTA SINJALIZUESE NË AUTOMJETE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	07.08.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 173 dhe nenin 262 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Duke parë që Ligji Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, në nenin 173, i jep autorizim ministrit të nxjerr akt nënligjor, siç është ky udhëzim administrativ, i cili rregullon pajisjet e veçanta sinjalizuese në automjete dhe duke parë që qëllimi i udhëzimit administrativ përputhet me dispozitat e ligjit në fuqi, rekomandohet që të mbetet në fuqi.
1111	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.11/2017 PËR REGJISTRIN QENDROR TË GJENDJES CIVILE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	30.11.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 26 paragrafi 4 dhe nenin 66 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4 të Ligjit Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ Nr.11/2017 për regjistrin qendror të gjendjes civile, ka bazë ligjore, rekomandohet që ky udhëzim të mbetet në fuqi. Ky udhëzim administrativ thirret në dispozitat përmbajtëse të ligjit, respektivisht në nenin 26 paragrafi 4 e që në mënyrë shprehimorë përcakton nxerrjen e një akti nënligjor që rregullon mënyrat e krijimit të Regjistrit qendror të gjendjes civile dhe rregullat për shfrytëzimin e teknologjisë informative që do të përdoren për këtë regjistër. Edhe në dispozitat kalimtare theksohet edhe njëherë i njëjti autorizim për Ministrin e punëve të brendshme, në të cilën dispozitat kalimtare thirret ky udhëzim administrativ, mirëpo do të ishte më e preferueshme që udhëzimi të thirret vetëm në dispozita përmbajtëse të ligjit, sepse tek dispozitat kalimtare, është përsëritur i njëjti autorizim.
1112	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 12/2017 PËR PËRMBAJTJEN E ELABORATIT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	30.11.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 38, të Ligjit Nr.04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Në dispozitat kalimtare, në nenin 38 të Ligjit nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, përcaktohet në mënyrë të përgjithshme, nxerrja e një numri të pakufizuar të akteve nënligjore lidhur me kushtet e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, në të cilin nen mbështetet ky udhëzim administrativ. Ky formulim i tillë i cili e autorizon ministrin për nxjerrje të akteve nënligjore. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1113	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 13/2017 PËR ETIKEN DHE PROCEDURËN DISIPLINORE NË AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	22.12.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 23, paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr. 04/L-064 Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pasi që ligji, respektivisht neni 23, paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, shprehimisht përcakton se akti nënligjor do të rregullohet procedura për shkeljet disiplinore, suspendimi dhe procedura disiplinore për punonjësit e AKF-së, në të cilën dispozitat mbështetet edhe ky udhëzim administrativ, si dhe si pasojë e përputhjes së qëllimit të udhëzimit administrativ me legjislativonin në fuqi, konstatohet se udhëzimi administrativ në fjalë ka bazë të mirëfilltë ligjore, andaj rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1114	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 14/2017 PËR REKRUTIM DHE PROCEDURAT TJERA TË PUNËS NË AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	22.12.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 23, paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pasi që dispozita në të cilën mbështetet ky udhëzim administrativ, e autorizon ministrin të nxjerr një akt nënligjor siç është ky udhëzim administrativ, pra pasi që ekziston baza ligjore e harmonizuar me dispozitat ligjore në fuqi, rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1115	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 15/2017 PËR PROCEDURËN E KUNDËRVAJTJES NË TRAFIKUN RRUGOR	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	26.12.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 254, paragrafi 6, nenin 257, paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pasi që Ligji Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, respektivisht neni 254, paragrafi 6 dhe neni 257, paragrafi 3 dhe 4 , shprehimisht e autorizon ministrin për nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ, dhe pasi që qëllimi i udhëzimit është në harmoni me dispozitat ligjore të lartëcekura, konstatohet që udhëzimi ka bazë ligjore të mirëfilltë dhe rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1116	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.16/2017 PËR PËRGATITJEN E KANDIDATËVE PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL NË LËMINË E MBROJTJES NGA ZJARRI	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	28.12.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 8, paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ në fjalë, ka bazë ligjore të harmonizuar me dispozitat e ligjit në fuqi. Udhëzim administrativ thirret në dispozitat përmbajtëse të ligjit, respektivisht në nenin 8 paragrafi 4 e që në mënyrë shprehimorë përcakton nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ.
1117	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 17/2017 PËR TESTIMIN DHE SERVISIMIN E APARATEVE PËR FIKJE TË ZJARRIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	28.12.2017	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 19 të Ligji Nr. 04/L012 për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky udhëzim administrativ përcaktohen kriteret që duhet të kenë aparatet për fikjen e zjarrit për garantimin e cilësisë, gatishmërisë për përdorim dhe kontrollim në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, si dhe kushtet të cilat duhet të plotësojnë personat e autorizuar që kryejnë këtë veprimtari, për të cilën është filltet pikërisht në nenin 19, dhe në të cilën dispozitat përcaktohet edhe nxerrja e akteve nënligjore pikërisht për këtë fushë. Pasi që udhëzimi administrativ ka bazë ligjore të mirëfilltë, rekomandohet që ky udhëzim të mbetet në fuqi.
1118	RREGULLORE (MPB) NR. 01/2016 PËR PLOTËSIMIN E STANDARDËVE TË PËRGJITHSHME THEMELORE TË SIGURIMIT NË AVIACIONIN CIVIL	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	22.01.2016	Kjo rregullore mbështetet në nenin 90, paragrafi 90.3 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të dispozitës në të cilat thirret kjo rregullore, vërehet se dispozita në fjalë shprehimisht autorizon ministrin për nxjerrjen e rregullores, siç është rasti me rregulloren nr. 01/2016, të cilat i bëjnë rregullat ndërkombëtare të sigurimit në avioacion, të aplikueshme për shërbimet ajrore vendore. Andaj, pasi që rregullorja është nxjerr në harmoni me dispozitat ligjore rekomandohet që të mbetet në fuqi.
1119	RREGULLORE (MPB) NR. 02/2016 PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET E GRADIMIT PËR PUNONJËSIT E AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	05.02.2016	Kjo rregullore mbështetet në nenin 23, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, të Ligjit Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Kjo rregullore mbështet në nenin 23 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, e cila dispozitat përputhet me qëllimin e rregullores, andaj konstatohet që rregullorja ka bazë ligjore të mirëfilltë dhe rekomandohet të mbetet në fuqi.
1120	RREGULLORE (MPB) NR. 03/2016 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË E MENAXHIMIT EMERGJENT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	01.06.2016	Kjo rregullore mbështetet në nenin 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore, nenin 23, paragrafi 12 të Rregullores Nr. 09/2012 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematzimin e Vendeve të Punës në Administratë Shtetërore.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Arsyeja e një rekomandimi të tillë vije si rezultat i asaj që kjo rregullore mbështetet në ligj i cili është i shfuqizuar. Mirëpo ligji i cili tanimë është në fuqi, rregullon çështjen për të cilën është nxjerr edhe kjo rregullore në nenin 28 paragrafi 3 të tij. Kompetenca e udhëheqësit të organit me miratim të ministrit për nxjerrjen e kësaj rregulloreje që është paraparë në ligjin e shfuqizuar, tanimë kjo kompetencë në ligjin i cili është në fuqi përcaktohet se është kompetencë e Kryeministrit. Andaj edhe është rekomanduar që ky akt nënligjor të harmonizohet me dispozitat e ligjit që është në fuqi.
1121	RREGULLORE (MPB) NR. 04/2016 PËR FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË AKOMODIMIT PËR PERSONAT E RIATDHESUAR	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	19.12.2016	Kjo rregullore mbështetet në nenin 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Kjo rregullore mbështetet në nenin 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe referimi në një akt të tillë juridik, nuk paraqet bazë ligjore të kësaj rregulloreje, andaj në mungesë të bazës ligjore juridike rekomandohet që rregullorja të shfuqizohet. Mirëpo, për mos të krijuar vakum ligjor është rekomanduar që t'i krijohet baza juridike ligjore.

1122	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 02/2016 PËR LEJEN E EKSPORTIT TË PËRKOHSHËM, VERIFIKIMIN E IMPORTIT NGA PËRDORUESI I FUNDIT, MASAT E SIGURISË TË INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA SHETËRORE PËR CAKTIMIN E PERSONIT PËRGJEGJËS DHE KRITERET PËR PËRCJELLJE GJATË TRANSPORTIT TË PQV-VE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	15.02.2016	Ky udhëzim administrativ bazohet në nenin 36 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, 1.12, 1.13 dhe 1.17 të Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatesë të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në kreun VIII të ligjit Nr. 03/L-246 Për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatesë të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, në dispozitat kalimtare neni 36 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, 1.12, 1.13 dhe 1.17, është përcaktuar nxerrja e akteve nënligjore për: Procedurat për lëshimin e lejes për eksportim të përkoeshëm të PQV-së; kriteret për përcjellje, përjashtimisht ky transportimi i PQV-së bëhet nga organet e autorizuar shtetërore për qëllime operacionale; procedurat për verifikimin e importit nga përdoruesi i fundit; dhe për masat e sigurisë të institucioneve të autorizuar shtetërore për siguri, që do të jenë përgjegjëse për caktimin e një personi përgjegjës, në të cilat dispozita është thirrë edhe ky akt nënligjor. Edhe pse ligji ka përcaktuar se veçmas të nxirren akte nënligjore për pikat e parashtruar më lart, ky akt nënligjor është thirrë në formë të përmblëdhur (kumulative) të të gjitha këto pika. Mirëpo përderisa, ekziston baza ligjore e këtij akti nënligjor, rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi.
1123	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 03/2016 PËR LEJE PËR LËVIZJE ME ARMË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	15.02.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 73 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandohet që ky udhëzim administrativ, të mbetet në fuqi, pasi që pas analizimit të dispozitave të ligjit në fuqi, dispozita në të cilën është thirrë udhëzimi administrativ, në mënyrë eksplicite ka përcaktuar se do të nxjerret një akt nënligjor për këtë çështje, andaj konstatohet që akti nënligjor është në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit në fuqi dhe rekomandohet që e njëjta të mbetet në fuqi.
1124	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 04/2016 PËR LISTËN E AUTORIZUAR TË PAJISJEVE PËR QËLLIME TË VEÇANTA PËR INSTITUCIONET SHETËRORE TË SIGURISË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	15.02.2016	Ky udhëzim administrativ bazohet në nenin 36, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-246 për pajisje me armë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në kreun VIII të ligjit Nr. 03/L-246 Për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatesë të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, në dispozitat kalimtare neni 36 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 është përcaktuar në mënyrë eksplicite nxerrja e aktit nënligjor për listën e autorizuar të pajisjeve të institucioneve shtetërore të sigurisë në bazë të kërkesave nga agjencionet ekzekutive, në të cilën dispozita është thirrë edhe ky akt nënligjor. Andaj përderisa ekziston baza ligjore, rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi.
1125	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 05/2016 PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT SHQYRTUES DHE KOMISIONIT PËR ANKESA	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	15.04.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 15, paragrafi 6 të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi Administrativ i nxjerr nga Ministri është në pajtim me autorizimet e legjislacionit në fuqi, përkatësisht ka bazë juridike në ligj. Andaj, pas analizës së këtij akti nënligjor, konstatohet që udhëzimi administrativ është në përputhje me dispozitat ligjore dhe rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1126	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 06/2016 PËR NUMRIN PERSONAL	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	28.06.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 40 dhe 66 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Duke parë që udhëzimi administrativ Nr.06/2016 për numrin personal, ka bazë të mirëfilltë ligjore, rekomandohet që ky udhëzim të mbetet në fuqi. Ky udhëzim administrativ thirret në dispozitat ligjore, respektivisht në nenin 40 paragrafi 3 e që në mënyrë shprehimore përcakton nxerrjen e një akti nënligjor që rregullon kriteret dhe procedurat e lëshimit të numrit personal. Edhe në dispozitat kalimtare theksohet edhe njëherë i njëjti autorizim për Ministrin e punëve të brendshme, në të cilën dispozita kalimtare thirret ky udhëzim administrativ, mirëpo do të ishte më e preferueshme që udhëzimi të thirret vetëm në dispozita në përmbajtësore të ligjit, sepse tek dispozitat kalimtare përsëritet i njëjti autorizim.
1127	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 08/2016 PËR KUSHTET MINIMALE TEKNIKE PËR RUAJTJEN E ARMËS, PUESEVE TË ARMËS DHE MUNICIONIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	20.07.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 44 paragrafi 5 dhe nenin 57 të Ligjit nr.05/L-022 për Armë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi Administrativ i nxjerr nga Ministri është në pajtim me autorizimet e legjislacionit në fuqi, përkatësisht ka bazë juridike në ligj, andaj rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi.
1128	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 09/2016 PËR KATALOGUN E LLOJEVE TË ARMËVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	20.07.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi Administrativ i nxjerr nga Ministri është në pajtim me autorizimet e legjislacionit në fuqi, përkatësisht ka bazë juridike në ligj, andaj edhe rekomandimi i tillë është rezultat i harmonizimit të bazë ligjore me dispozitat e ligjeve në fuqi.
1129	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 10/2016 PËR AFTËSIMIN TEORIK DHE PRAKTIK PËR ARMË, PROVIMIN PROFESIONAL, SI DHE VERIFIKIMIN E KUALIFIKIMIT TË INSTRUKTORËVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	20.07.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 12 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 05/L-022 për Ligjin për Armë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të udhëzimit administrativ vërejt se ky akt nënligjor është nxjerr nga Ministri është në pajtim me autorizimet e legjislacionit në fuqi, përkatësisht ka bazë juridike në ligj, andaj rekomandohet që të mbetet në fuqi.
1130	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 11/2016 PËR REALIZIMIN E MBIKËQYRJES ELEKTRONIKE DHE RAPORTIMIT NGA POLICIA E KOSOVËS, TË PERSONAVE TË CILËVE IU KUFIZOHET LËVIZJA	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	29.09.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligji Nr. 05/L-003 për Mbiqëqyrjen Elektronike të Personave, të Cilëve iu Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Dispozitat e ligjit në fuqi, më saktësisht neni 11, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-003 për Mbiqëqyrjen Elektronike të Personave, të Cilëve iu Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, shprehimisht i jep autorizim ministrit për nxjerrjen e një akti nënligjor për rregullimin e realizimit të mbiqëqyrjes elektronike dhe për mënyrën e raportimit nga ana e Policisë së Kosovës. Pas analizimit të dispozitave ligjore, konstatohet se udhëzimi është nxjerr në pajtim me këto dispozita, andaj rekomandohet që të mbetet në fuqi.
1131	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 12/2016 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËSË DIGJITALIZIMIT TË REGJISTRAVE THEMELTARË TË SKANUAR TË GJENDJES CIVILE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	07.10.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 66, paragrafi 5 dhe nenin 31, paragrafi 3 të Ligjit Nr.04/L-003 për Gjendjen Civil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Ky udhëzim administrativ në preambulë thirret në nenin 66 paragrafi 5, respektivisht në dispozitat kalimtare të ligjit për gjendjen civile. Formulimi që është përdorur në këtë dispozitë është shumë i përgjithshëm dhe formulimi i tillë bënë të mundur krijimin e akteve nënligjore në mënyrë të pakufizuar dhe kjo është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Në anën tjetër thirrja në nenin 31 paragrafi 3 nuk paraqet bazë ligjore përveç ndërlidhur edhe me paragrafin 4 të këtij neni, prandaj është rekomanduar që të mbetet në fuqi por të ndryshohet preambula e Udhëzimit Administrativ në mënyrë që të ketë harmonizim të plotë në mes të Ligjit dhe udhëzimit administrativ.
1132	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.13/2016 PËR PAJISJE ME LETËRNJOFTIM, PASAPORTË DHE PATENTË SHOFER ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	12.10.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 13 paragrafi 6 dhe nenin 24 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim, nenin 8 paragrafi 8.2 të Ligjit Nr.03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit, në nenin 134 të Ligji Nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Si edhe shihet nga ana analiza e këtij Udhëzimi Administrativ del se bazën juridike e kërkon t'a gjej në tri ligje të veçanta: Ligjin për Letërnjoftim, Patentë shoferi, dhe Dokumentet të Udhëtimit. Baza juridike nuk ekziston në asnjërën prej dispozitave në të cilat thirret. Sa i përket neni 13 të ligjit për letërnjoftim, kjo dispozitë përcakton se do të nxirret akti nënligjor për pajisje me letërnjoftim mirëpo nuk përcakton për pajisje me letërnjoftim në procedurë të përsheptuar. Po ashtu këtu mund të shtoj se lidhur me procedurën e pajisjes me letërnjoftim veçse ekziston akti nënligjor për këtë procedurë. Sa i përket dokumenteve të udhëtimit në nenin 8 paragrafi 8.2 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, anipse pse i referohet çështjes së kushtetevë në të cilat mund të lëshohet pasaportë në procedurë të përsheptuar, nuk ka përcaktuar me dispozitë të veçantë se kjo procedurë do të rregullohet me akti nënligjor. Prandaj është rekomandohet që në rast të ndryshim plotësim të ligjit për Dokumentet të Udhëtimit të krijohet baza juridike ku do të gjente mbështetje, e gjithashtu vien edhe për procedurën e përsheptuar të pajisjes me patentë shofer tek Ligji për Patentë shoferi dhe për procedurën e përsheptuar të pajisjes me letërnjoftim të Ligji për Letërnjoftim.
1133	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 14/2016 PËR SHKATËRRIMIN E AUTORIZUAR TË DOKUMENTEVE PUBLIKE DHE SHKRESAVE ZYRTARE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	12.10.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi për shfuqizim vjen si rezultat i asaj se. Udhëzimi administrativ nuk ka bazë ligjore. Neni 24 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim përcakton se "për zbatimin e këtij ligji Ministri mund të nxjerrë edhe akte të tjera nënligjore". Si edhe shihet ky është formulimi i përgjithshëm i cili në formë të pakufizuar parashih mundësin e nxjerrjes së udhëzimeve administrative. Andaj, rekomandohet që Ministria të rishikoj dispozitat e ligjit për të shikuar se a ka nevojë për akt nënligjor apo jo, e nëse ka nevojë, atëherë t'i krijohet baza e mirëfilltë juridike, duke parashikuar në mënyrë shprehimore nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ që në mënyrë më të hollësishe do ta rregullonte çështjen e shkatërrimit të autorizuar të dokumenteve publike dhe shkresave zyrtare.
1134	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 15/2016 PËR SHENYRËN E PRANIM - DORËZIMIT DHE TRANSPORTIMIT TË DOKUMENTEVE PUBLIKE DHE SHKRESAVE ZYRTARE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	12.10.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe referimi në një akt të tillë juridik, nuk paraqet bazë ligjore të këtij udhëzimi administrativ, andaj në mungesë të bazës ligjore juridike rekomandohet që rregullorja të shfuqizohet.
1135	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 18/2016 PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, PËRMBAJTJËS DHE MËNYRËS SË PUNIMIT TË LETËRNJOFTIMIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	22.12.2016	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 8, 9 dhe 24, paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të Ligjit Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim, veçanërisht nenet 8, 9 dhe 24, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, vërejt se këto dispozita në mënyrë eksplicite i japin autorizim ministrit për nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ. Andaj, duke qenë se qëllimi i udhëzimit administrativ në fjalë është në harmoni me dispozitat e ligjeve në fuqi, konstatohet që udhëzimi administrativ ka bazë ligjore të mirëfilltë dhe rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.

1136	RREGULLORE (MPB) NR. 01/2015 PËR THEMELIMIN, PËRBERJEN DHE PROCEDURËN E KOMISIONIT PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ZEVENDËSDREJTORËVE NË AGJENCINË E MENAXHIMIT EMERGJENT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	24.03.2015	Kjo rregullore mbështetet në nenin 7, paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim është si rezultat i harmonizimit të plotë të bazës ligjore në mes aktit nënligjor dhe dispozitës përkatëse të Ligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.
1137	RREGULLORE (MPB) NR. 02/2015 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	24.03.2015	Kjo rregullore mbështetet në nenin 12 dhe nenin 23, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rregullorja në fjalë, mbështetet në dispozita ligjore, respektivisht nenin 12 dhe nenin 23, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, e cila dispozitë e autorizon ministrin të nxjerr këtë rregullore. Duke parë përputhjen që ekziston mes dispozitave ligjore dhe qëllimit të rregullores, konstatohet që rregullorja ka bazë të mirëfilltë ligjore, dhe e njëjta të mbetet në fuqi.
1138	RREGULLORE (MPB) NR. 03/2015 PËR EMËRIMIN DHE MANDATIN E DREJTORËVE TË DEPARTAMENTEVE NË AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	06.07.2015	Kjo rregullore mbështetet në nenin 23, paragrafi 6, të Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandohet që rregullorja të shfuqizohet, për arsye se e njëjta mbështetet në një dispozitë, respektivisht në nenin 23 paragrafi 6, e cila dispozitë është e përgjithshme dhe e cila është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Sipas kësaj dispozite ministri apo kryeshefi ekzekutiv i AKF-së, autorizohen të nxjerrin akte nënligjore, pra edhe ato që nuk janë parapa në mënyrë eksplicite në ligj. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1139	RREGULLORE (MPB) NR. 04/2015 PËR SUBVENCIONIMIN E PROJEKTEVE QË PROMOVOJNË RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR NË REPUBLIKEN E KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	07.09.2015	Kjo rregullore mbështetet në nenin 8, nënparagrafin 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 35, paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.08/2015 për riintegrimin e personave të riatdhësuar dhe menaxhimin e programit të riintegritimit, si dhe nenit 38, paragrafi 6, të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Kjo rregullore mbështetet në nenin 35, paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.08/2015 për riintegrimin e personave të riatdhësuar dhe menaxhimin e programit të riintegritimit dhe referimi në një akt nënligjor, nuk paraqet bazë ligjore të mirëfilltë për këtë rregullore, andaj në mungesë të bazës ligjore juridike është rekomanduar që rregullorja të shfuqizohet.
1140	RREGULLORE (MPB) NR. 06/2015 PËR PËRSHKRIMIN E DETYRAVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË PERSONELIT TË AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	23.12.2015	Kjo rregullore mbështetet në nenin 23, paragrafin 6, të Ligjit Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Arsyeja e një rekomandimi të tillë, vie pasi që kjo rregullore mbështetet në nenin 23 paragrafin 6, ku sipas kësaj dispozite ministri apo kryeshefi ekzekutiv i AKF-së, autorizohet të nxjerr çfarëdo akte nënligjore, pra në rastin e tillë edhe ato të cilat nuk janë parapa shprehimisht në tekstin e ligjit. Pasur parasysh këtë fakt, dispozita e tillë është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, andaj rekomandohet që rregullorja të shfuqizohet apo në rast se rregullorja në fjalë llogaritet e nevojshme për çështjet të cilat i rregullon, në mënyrë që të mos mbetet vakum ligjor, t'i krijohet baza ligjore specifike.
1141	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 03/2015 PËR SHKRIMIN DHE LAJMERIMIT DHE ÇLAJMERIMIT TË VENDBANIMIT APO VENDQËNDRIMIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	23.01.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi vjen si rezultat i asaj se, Udhëzimi administrativ nuk ka bazë ligjore. Neni 17 dhe 25 Ligjit për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin nuk e përcakton mundësinë e nxjerrjes së aktit nënligjor për rregullimin e procedurave të lajmerimit dhe ç'lajmërimit të vendbanimit apo vendqëndrimit. Gjithashtu, edhe në dispozitat kalimtare në nenin 24 parashihet nxjerrjen e aktit nënligjor për të përcaktuar procedurën së lajmërimit dhe ç'lajmërimit të vendbanimit apo vendqëndrimit. Megjithatë me qëllim të evitimit të vakumit të menjeshëm ligjor në çështjet e lajmerimit dhe ç'lajmërimit të vendbanimit dhe vendqëndrimit, rekomandohet që ky Udhëzim Administrativ të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore.
1142	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 04/2015 PËR LISTËN E AUTORIZUAR TË PAJISJEVE PËR QËLLIME TË VEÇANTA PËR INSTITUCIONET SHITËTORE TË SIGURISË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	15.04.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 36, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatesë të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Udhëzimi administrativ në fjalë është i shfuqizuar. I tillë figuron edhe në gazetën zyrtare, ndërsa udhëzimi administrativ i cili e shfuqizon është udhëzimi administrativ (MPB) nr.04/2016 për listën e autorizuar të pajisjeve për qëllime të veçanta për institucionet shtetërore të sigurisë, i cili është punuar me numër rendor 62.
1143	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 08/2015 PËR RIREGJISTRIMIN NË REGJISTRAT THEMELTARË TË GJENDJES CIVILE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	13.05.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 55 dhe 66 paragrafi 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ nr.08/2015 për riregjistrim në regjistrat themeltarë të gjendjes civile, ka bazë ligjore të mirëfilltë, pasi që përputhet me dispozitat përmbajtëse të ligjit, respektivisht me nenin 55 paragrafi 2. Kjo dispozitë në mënyrë eksplicite përcakton se Kriteret, format, mënyrat dhe procedura e reregjistrimit do të rregullohet me akt nënligjor, në të cilën dispozitë mbështetet edhe ky udhëzim. Mirëpo, udhëzimi në fjalë mbështetet edhe në dispozitat kalimtare, të cilat autorizojnë nxjerrjen e aktit nënligjor për të njëjtin procedurë. Në rastin e tillë do të ishte më e favorshme që udhëzimi administrativ të mbështet vetëm në dispozitat përmbajtëse të ligjit, sepse tek dispozitat kalimtare është përsëritur i njëjti autorizim.
1144	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 09/2015 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË DIGJITALIZIMIT TË REGJISTRAVE THEMELTARË TË SKANUAR TË GJENDJES CIVILE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	13.05.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 66, paragrafi 5 dhe nenin 31, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Ky udhëzim administrativ është i shfuqizuar. I tillë figuron edhe në gazetën zyrtare, ndërsa udhëzimi i cili e shfuqizon është Udhëzimi administrativ nr. 12/2016 për përcaktimin e procedurës së digjitalizimit të regjistrave themeltarë të skanuar të gjendjes civile, i cili është punuar me nr. rendor 69.
1145	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 12/2015 PËR PROCEDURAT DHE FORMAT E VENDOSJES NË TREG TË EKSPLOZIVËVE DHE PRODUKTEVE PIROTEKNIKE, KRITERET PËR SHENJIMIN CE DHE SHENJIMIN E PAKOVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	01.07.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 13, paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozivëve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ mbështetet në nenin 13 paragrafi 4 të ligjit për përdorim civil të eksplozivëve, i cili në mënyrë eksplicite përcakton, nxjerrjen e një akti nënligjor, siç është edhe ky udhëzim administrativ, që do të rregulloj procedurat dhe format e vendosjes në treg të eksplozivëve për përdorim civil dhe produkteve piroteknike, përfshirë kriteret për shënjim CE dhe shënjimin e pakove. Përderisa ekziston, baza e mirëfilltë ligjore, rekomandohet që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi.
1146	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 13/2015 PËR LLOJIN, FORMËN, MODELIN E UNIFORMËS DHE KARTELËS SË IDENTIFIKIMIT PËR PJESETARËT E AMË/SMASHN	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	01.07.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 20 paragrafi 6 dhe nenin 86 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ mbështetet në nenin 20, paragrafi 6 dhe nenin 86 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, në të cilat dispozita autorizohet ministri i punëve të brendshme që me akt nënligjor, siç është ky udhëzim administrativ, të përcaktoj llojin, format, modelin, simbolat përkatëse si dhe përcaktohet forma dhe përmbajtja e kartelës së identifikimit për pjesëtarët e Strukturave për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë. Duke parë që udhëzimi administrativ ka bazë ligjore në përputhje me dispozitat ligjore, rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1147	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 14/2015 PËR HETIMIN E AKSIDENTIVE ME EKSPLOZIVË DHE PRODUKTE PIROTEKNIKE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	28.07.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 44, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozivëve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ mbështetet në nenin 44 paragrafi 3 të ligjit për përdorim civil të eksplozivëve, e cila dispozitë shprehimisht përcakton që me akt nënligjor të lëshuar nga ministria do të rregullohet hetimi i aksidentive dhe incidenteve me eksplozivë dhe fishkekzjarje. Përderisa ekziston baza ligjore e harmonizuar me dispozitat ligjore, rekomandohet që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi. Mirëpo, kërkoj që të rishikohet edhe njëherë brendia e këtij udhëzimi për përmirsimin e disa çështjeve teknike.
1148	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 16/2015 PËR PËRCAKTIMIN E SHKELQJEVE, MASAVE DISIPLINORE DHE PROCEDURËS DISIPLINORE NDAJ PUNONJËSVE TË IPK-SË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	09.09.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 31, paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim vjen si rezultat i asaj se udhëzimi administrativ ka bazë ligjore specifike edhe pse nuk është e përcaktuar në preambulë mbështetja e udhëzimit administrativ në nenin 30 par. 1. por vetëm në nenin 31 par. 1 nënparagrafi 1.1 në kuadër të dispozitave kalimtare të Ligjit për Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës. Andaj, konsideroj që më e preferueshme do ishte që baza ligjore për nxjerrjen e këtij Udhëzimi të mbetet vetëm në nenin 30 paragrafi 1, sepse baza ligjore e përsëritur edhe në dispozitat kalimtare është e panevojshme.
1149	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 17/2015 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME TË REGJISTRIMIT TË FAKTIT TË LINDJES, MARTESËS DHE VDEKJES	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	19.08.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 66, paragrafin 5 të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ky udhëzim administrativ në preambulë thirret në nenin 66 paragrafi 5, respektivisht në dispozitat kalimtare të ligjit për gjendjen civile. Formulimi që është përdorur në këtë dispozitë është shumë i përgjithshëm dhe formulimi i tillë bënë të mundur krijimin e akteve nënligjore në mënyrë të pakufizuar. Andaj, rekomandohet që Ministria të rishikoj dispozitat e ligjit për të shikuar se a ka nevojë për akt nënligjor apo jo, e nëse ka nevojë, atëherë t'i krijohet baza juridike, duke parashikuar në mënyrë shprehimore nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ që në mënyrë më të hollësishme do ta rregullonte çështjen për procedurën e përgjithshme të regjistrimit të faktit të lindjes, martesës dhe vdekjes
1150	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 19/2015 PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E NDËRRIMIT DHE KORRIGJIMIT TË EMRIT PERSONAL	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	02.11.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 66, paragrafin 5, të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ky udhëzim administrativ në preambulë thirret në nenin 66 paragrafi 5, respektivisht në dispozitat kalimtare të ligjit për gjendjen civile. Formulimi që është përdorur në këtë dispozitë është shumë i përgjithshëm dhe formulimi i tillë bënë të mundur krijimin e akteve nënligjore në mënyrë të pakufizuar. Andaj, rekomandohet që Ministria të rishikoj dispozitat e ligjit për të shikuar se a ka nevojë për akt nënligjor apo jo, e nëse ka nevojë, atëherë t'i krijohet baza juridike, duke parashikuar në mënyrë shprehimore nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ që në mënyrë më të hollësishme do ta rregullonte çështjen për kushtet dhe procedurat e ndërrimit dhe korigjimit të emrit personal.

1151	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 20/2015 PËR PROCEDURËN E INICIMIT TË HETIMIT PENAL	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	19.11.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 31 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Sipas dispozitave të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, respektivisht në nenin 31 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, në mënyrë eksplicite përcaktohet autorizimi i ministrit për nxjerrjen e këtij akti nënligjor. Duke parë që qëllimi i këtij udhëzimi administrativ përputhet me dispozitat ligjore në fuqi, konstatohet që udhëzimi administrativ ka bazë ligjore të mirëfilltë dhe rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1152	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 21/2015 PËR INSPEKTIMË NË POLICINË E KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	19.11.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 31 paragrafi 1 nënparagrafi 1.9 të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi Administrativ e ka bazën ligjore të mirëfilltë në Ligjin Inspektoratin Policor.
1153	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 24/2015 PËR REGJISTRIMIN E MËVONSHËM NË REGJISTRAT E GJENDJES CIVILE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	30.12.2015	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 54 dhe 66 nënparagrafi 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ në fjalë, ka bazë ligjore të harmonizuara me dispozitat e ligjit në fuqi. Udhëzim administrativ thirret në dispozitat përbajtëse të ligjit, respektivisht në nenin 54 paragrafin 2 e që në mënyrë shprehimore përcakton nxjerrjen e një akti nënligjor që rregullon kriteret, format, mënyrën dhe procedurat e regjistrimit të mëvonshëm. Edhe në dispozitat kalimtare theksohet edhe njëherë i njëjti autorizim për Ministrin e punëve të brendshme, në të cilin dispoziti kalimtare thirret ky udhëzim administrativ, mirëpo do të ishte më e preferueshme që udhëzimi të thirret vetëm në dispozita përbajtëse të ligjit, sepse tek dispozitat kalimtare, përsëritet i njëjti autorizim.
1154	RREGULLORE (MPB) NR. 01/2014 E BRENDSHME PËR QASJEN, RENDIN, SIGURIMIN DHE RUAJTJEN E OBJEKTIT TË MPB-SË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	31.01.2014	Kjo rregullore mbështetet në nenin 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandimi i tillë vije si rezultat i asaj që kjo rregullore nuk ka bazë të mirëfilltë ligjore, pasi që mbështetet vetëm në nenin 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011.
1155	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 02/2014 PËR DOKUMENTET E UDHËTIMIT PËR TË HUAJ	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	04.04.2014	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 137, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Përderisa neni në të cilin është mbështet ky udhëzim administrativ, përkatësisht neni 137 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, parasheh nxjerrjen e një akti nënligjor siç është ky udhëzim administrativ, që rregullon procedurën e lëshimit të dokumenteve të udhëtimit për të huajt, konstatohet që baza juridike ekziston dhe është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, andaj dhe rekomandohet që e njëjta të mbetet në fuqi.
1156	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 03/2014 PËR MENAXHIMIN DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË PROCESIN E RIPRANIMIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	15.04.2014	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 13 të Ligjit për Ripranim Nr. 03/L- 208.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi rrjedh si rezultat i asaj se, udhëzimi administrativ nuk ka bazë ligjore. Si edhe shihet neni 13 paragrafi 1 i Ligjit për Ripranim nuk përcakton të drejtën e ministrit që për rregullim me të hollësishtëm për menaxhimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale në procesin e ripranimit të nxjerrë akt nënligjor. Nga ana tjetër në paragrafin 2 të nenit 13 të këtij ligji ku përcaktohet se Ministria e Punëve të Brendshme (jo Ministri) do të nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji, është formulim i përgjithshëm i cili në formë të pakufizuar parasheh mundësinë e nxjerrjes së udhëzimeve administrative. Gjithsesi, me qëllim të evitimit të vakumit të menjëhershëm ligjor, rekomandohet që të mbetet në fuqi por njëherë t'i krijohet baza konkrete ligjore përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 03/L-208 për Ripranim, duke parashikuar në mënyrë shprehimore nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ që në mënyrë më të hollësishtme do ta rregullonte çështjen e menaxhimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në procesin e ripranimit.
1157	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 07/2014 PËR PERCJELLJEN ZYRTARË TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT TË TJ	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	13.05.2014	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 21 të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi i tillë vije pasi që neni 21, nuk përcakton në mënyrë decidive se kjo çështje do të rregullohet me udhëzim administrativ, përkatësisht të nxjerrë akt nënligjor, por dispozita në fjalë përcakton se do të rregullohet me akte të veçanta e që më e logjishme është që ligdhënia ka paraparë që kjo çështje të rregullohet me vendim. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1158	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 10/2020 PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË VIZAVE NË PIKËN E KALIMIT KUFITAR	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	24.12.2020	Ky udhëzim administrativ është nxjerr në mbështetje të nenit 26 dhe nenit 137, paragrafin 1, nënparagrafin 1.3 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim është si rezultat i harmonizimit të bazës ligjore në mes aktit nënligjor dhe dispozitës përkatëse të Ligjit për të huajt. Ndërsa rekomandimi për ndryshim të Ligjit për të Huajt është për të përmirësuar gabimin teknik nga njëra anë, ndërsa për me tepër do të ishte më se e arsyeshme që nga kjo dispozitë kalimtare të hiqet mundësia për nxjerrje të akteve nënligjore duke qenë se mundësia e nxjerrjes së aktit nënligjor për kushtet dhe procedurat e lëshimit të vizave në pikën e kalimit kufitar parashihet në nenin 26, andaj përsëritja e përcaktimit të nxjerrjes së të njëjtit akt nënligjor është e panevojshme.
1159	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 11/2014 PËR REGJISTRIN QENDOR TË AUTOMJETEVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	27.10.2014	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 301 të Ligjit Nr.02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rruqor.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim është si rezultat i harmonizimit të bazës ligjore në mes aktit nënligjor dhe dispozitës përkatëse të Ligjit për Siguri në Komunikacion.
1160	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 12 /2014 PËR KRITERET E SIGURISË SHITESË PËR EKSPLOZIVË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	06.11.2014	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 16, paragrafi 13 të Ligjit nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksploziveve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ mbështetet në nenin 16 paragrafi 13 të ligjit për përdorim civil të eksploziveve, i cili në mënyrë eksplicite përcakton, nxjerrjen e një akti nënligjor, siç është edhe ky udhëzim administrativ, që do të rregulloj dhe përcaktoj kriteret e distancave të depove për eksplozivë, kriteret e sigurisë për deponim dhe vendosjen e eksploziveve. Përderisa ekziston, baza e mirëfilltë ligjore, rekomandohet që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi.
1161	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 13/2014 PËR DEPONIMIN E AMONIUMIT DHE PLEHRAVE TË TJERE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	06.11.2014	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 12, të Ligjit nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksploziveve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Duke parë që udhëzimi administrativ, ka bazë ligjore të mirëfilltë e cila mbështetet në dispozitat ligjore, respektivisht neni 12 paragrafi 2 e cila dispozitë shprehimisht përcakton nxjerrjen e një akti nënligjor të tillë, rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1162	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 14/2014 PËR MASAT E POSAÇME TË SIGURISË GJATË TRANSPORTIMIT TË EKSPLOZIVËVE DHE FISHEKZJARRËVE TË LEJUAR	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	06.11.2014	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 7 dhe 32, të Ligjit nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksploziveve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Përderisa, udhëzimi administrativ nr.14/2014 për masat e posaçme të sigurisë gjatë transportimit të eksploziveve dhe fishekzjarrëve të lejuara, mbështetet në dispozitat ligjore, përkatësisht nenin 7 paragrafi 3 dhe neni 32 paragrafi 8, të cilat dispozita parashohin nxjerrjen e një akti nënligjor siç është ky udhëzim administrativ, atëherë ekziston baza ligjore e mirëfilltë. Andaj rekomandohet që ky udhëzim administrativ të mbetet në fuqi.
1163	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.15/2014 PËR PROVIMIN PROFESIONAL PËR INSPEKTORË, EMËRIMIN I TYRE DHE MANUALI I INSPEKTORËVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	03.12.2014	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 6, të Ligjit nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksploziveve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ mbështetet në dispozitat ligjore, përkatësisht në nenin 6 paragrafi 4, i cili autorizon ministrin e punëve të brendshme që me akt nënligjor të rregulloj procedurat e emërimit të inspektorëve dhe detajeve tjera. Përderisa, shohim se baza ligjore e këtij udhëzimi administrativ ekziston dhe është në përputhje me dispozitat ligjore, rekomandohet që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi.
1164	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 16/2014 PËR STEMËN IDENTIFIKUESË TË INSPEKTORATIT POLICOR TË KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	03.12.2014	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 31, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të udhëzimit dhe dispozitave të ligjit për inspektoratin policor të Kosovës, vërejta se udhëzimi administrativ është nxjerr në pajtim me dispozitat ligjore, dhe përderisa ka bazë ligjore të mirëfilltë, rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1165	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 17/2014 PËR FORMËN, PAJSJEN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	03.12.2014	Udhëzimi administrativ është nxjerr në mbështetje të nenit 31, paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi Administrativ ka bazë ligjore. Mirëpo rekomandimet sekondare janë sepse Ligji e parasheh nxjerrjen e këtij udhëzimi edhe në nenin 8 paragrafi 2 (gjë që do të ishte e prefruar të harmonizohet edhe me preambulën të udhëzimit administrativ) por edhe në kuadër të dispozitave kalimtare. Ligji nuk ka nevojë që sërish të përcaktoj bazën juridike në mënyrë të përsëritur tek dispozitat kalimtare, prandaj është rekomanduar që të hiqet kjo dispozitë.
1166	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 18/2014 PËR LLOJET E ARMATIMIT DHE MJETEVE TJERA TË PËRDORIMIT TË FORCËS NGA IPK	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	03.12.2014	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 31, paragrafi 1.7 të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandimi i tillë është rezultat i harmonizimit të bazës ligjore të udhëzimit administrativ në fjalë me dispozitat e ligjit në fuqi, përkatësisht me Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.
1167	RREGULLORE NR.01/2013-MPB PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET E GRADIMIT PËR PUNONJËSIT E AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	02.07.2013	Kjo rregullore mbështetet në nenin 23, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7. të Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Kjo rregullore është e shfuqizuar. E tillë figuron edhe në gazetën zyrtare, ndërsa rregulloja e cila e shfuqizon është Rregulloja nr. 02/2016 për procedurat dhe kushtet e gradimit për punonjësit e agjencisë së Kosovës për forenzikë, i cili është shkruar me nr. rendor 57.
1168	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2013 – MPB PËR VULËN VERIFIKUESË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	19.02.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 66 paragrafi 5 të Ligjit nr.04/L-003 për Gjendjen Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ky udhëzim administrativ në preambulë thirret në nenin 66 paragrafi 5, respektivisht në dispozitat kalimtare të ligjit për gjendjen civile. Formulimi që është përdorur në këtë dispozitë është shumë i përgjithshëm dhe formulimi i tillë bënë të mundur krijimin e akteve nënligjore në mënyrë të pakufizuar. Andaj, rekomandohet që Ministria të rishikoj dispozitat e ligjit për të shikuar se a ka nevojë për akt nënligjor apo jo, e nëse ka nevojë, atëherë t'i krijohet baza juridike, duke parashikuar në mënyrë shprehimore nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ që në mënyrë më të hollësishtme do ta rregullonte çështjen për vulën verifikuese.

1169	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 04/2013 – MPB PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LICENCAVE DHE LEJEVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	19.03.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37 të Ligjit për Përdorimin Civil të Eksplozivëve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi vjen si rezultat i asaj se, pas analizimit të Ligjit nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve, askund në dispozitat e cekura, përkatësisht në nenin 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, nuk i jepet autorizimi ministrit të punëve të brendshme që të kërkohet dispozitave ligjore të nxirret akt nënligjor. Përndryshe, ministria duhet që në rast të ndryshim/plotësimit të Ligjit nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve, të krijohet baza ligjore e cila përputhet me qëllimin e udhëzimit administrativ në fjalë, nëse e konsideron të nevojshëm mbetjen e tij në fuqi.
1170	UDHËZIM ADMINISTRATIV- MPB NR. 05/2013 PËR KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE DHE LARTËSINË E TAKSËS PËR INTERVENIMET E ZJARRFIKËSVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	15.04.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim, përcaktohet nxerrja e një akti nënligjor, siç është ky udhëzim administrativ me anë të cilit do të rregullohet forma dhe mënyra e kompenzimit, dhe lartësia e taksës. Pasi që vërehet se ky udhëzim administrativ është nxjerr në pajtim me legjislacionin në fuqi, d.m.th. që ka bazë ligjore të mirëfilltë, rekomandohet që të mbetet në fuqi.
1171	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 06/2013-MPB PËR BASHKËPUNIM ME ORGANIZATA KOMBËTARE DHE NËRKOMBËTARE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	04.07.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 3 të Ligjit nr. 04/L022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Udhëzimi administrativ nr.06/2013, për bashkëpunim me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare administrative, mbështetet në nenin 3 të ligjit për përdorimin civil të eksplozivëve. Kjo dispozitë në të cilën është thirrur udhëzimi administrativ, nuk i jep autorizim ministrit të punëve të brendshme për nxjerr një akt nënligjor të tillë. Duke pas parasysh këtë fakt, konstatohet që udhëzimi administrativ në fjalë nuk ka bazë ligjore. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1172	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 07/2013 – MPB PËR KLASIFIKIMIN E RREZIKSHMËRISË I KB-SË DHE GRUPET E PËRSHTATSHMËRISË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	04.07.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 10 të Ligjit nr. 04/L022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ mbështetet në nenin 10 të ligjit për përdorimin civil të eksplozivëve, në të cilën dispozitë përkatësisht paragrafi 10, përcakton shprehimisht që të nxirret një akt nënligjor, siç është ky udhëzim administrativ, me anë të të cilit do të rregullohet klasifikimi i rrezikshmërisë së KB-së dhe grupeve të pajtueshmërisë, në të cilin plan është hartuar edhe ky udhëzim administrativ. Andaj duke parë që udhëzimi administrativ, ka bazë ligjore të mirëfilltë, rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1173	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 08/2013 – MPB PËR EDUKIMIN, KRITERET E KUALIFIKIMIT PROFESIONAL DHE PROGRAMET PËR TRAJNIME PROFESIONALE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	04.07.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 9, paragrafin 4 të Ligjit nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në dispozitat ligjore, përkatësisht në nenin 9 paragrafin 4 të ligjit për përdorimin civil të eksplozivëve, në mënyrë eksplicite përcaktohet nxerrja e një akti nënligjor me të cilin do të rregullohet procedura për edukim, kriteret për kualifikimet profesionale, programet e trajnimit profesional, si dhe certifikimin profesional. Përderisa udhëzimi administrativ mbulon të gjitha fushat e lart cekura në nenin 9 paragrafin 4, dhe thirret pikërisht në këtë dispozitë, mund të konstatohet që udhëzimi administrativ ka bazë ligjore të mirëfilltë, andaj rekomandohet që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi.
1174	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 12/2013 – MPB PËR ZGJEDHJEN E DREJTORIT RAJONAL TË POLICISË PËR RAJONIN MITROVICË-VERI	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	22.07.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregulores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi i tillë është rezultat i asaj se udhëzimi administrativ mbështetet në nenin 8 paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011, dhe referimi në një dispozitë të tillë nuk krijon bazë ligjore të mirëfilltë. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1175	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 14/2013 PËR PIKAT E SHITJES ME PAKICË TË MJETEVE PIROTEKNIKE DHE FISHEKZJARRËVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	10.09.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 3, të Ligjit nr. 04/L022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Udhëzimi administrativ nr.14/2013 për pikat e shitjes me pakicë të mjeteve piroteknike dhe fishekzjarrëve, mbështetet në nenin 3 të ligjit për përdorimin civil të eksplozivëve. Kjo dispozitë në të cilën është thirrur udhëzimi administrativ, nuk i jep autorizim ministrit të punëve të brendshme për nxjerr një akt nënligjor të tillë. Duke pas parasysh këtë fakt, konstatohet që udhëzimi administrativ në fjalë nuk ka bazë ligjore. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1176	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.20/2013 PËR RREGULLAT E TRAFIKUT LOKAL KUFITAR DHE LEJEN E TRAFIKUT LOKAL KUFITAR	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	07.11.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 12 paragrafi 5 të Ligjit Nr.04/L-214 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandimi i tillë është rezultat i harmonizimit në mes të dispozitat të Ligjit për ndryshim plotësim të Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror dhe këtij udhëzimi administrativ. Përderisa neni 12 paragrafi 5 i ligjit, përcakton në mënyrë eksplicite nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ, konsideroj që ka bazë ligjore të mirëfilltë, dhe rekomandohet që të mbetet në fuqi.
1177	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 09/2020 PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E VAZHDMIT TË VIZËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	18.12.2020	Ky udhëzim administrativ është nxjerr në mbështetje të nenit 27 dhe 137, paragrafin 1, nënparagrafin 1.4 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky rekomandim është si rezultat i harmonizimit të plotë të bazës ligjore në mes aktit nënligjor dhe dispozitës përkatëse të Ligjit për të huajt
1178	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 23/2013 PËR PAGAT, SHITESAT DHE DOBITË TË JERA TË PUNONJËSVE NË INSPEKTORATIN POLICOR TË KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	26.11.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 28, paragrafi 1 dhe në nenin 31 paragrafi 1.10 të Ligjit nr. 03/L231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi Administrativ ka bazë ligjore. Mirëpo rekomandimet sekondare janë sepse Ligji i parashihet nxjerrjen e këtij udhëzimi edhe në nenin 28 paragrafi 1, por përseritet edhe në kuadër të dispozitave kalimtare. Ligji nuk ka nevojë që sërish të përcaktoj bazën juridike në mënyrë të përsëritur tek dispozitat kalimtare, prandaj është rekomanduar që të hiqet kjo dispozitë.
1179	UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.25/2013 PËR DOKUMENTET E GJENDJES CIVILE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	02.12.2013	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 18 dhe 66 të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ në fjalë ka bazë ligjore të mirëfilltë, në pajtim me dispozitat ligjore. Në nenin 18 të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, përcaktohet se llojet, forma, elementet përberëse, mënyra e mbajtjes, afati i përdorimit të dokumenteve, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe rregullat e lëshimit të këtyre dokumenteve do të rregullohen me akt nënligjor, në të cilin plan është ndërtuar edhe ky udhëzim administrativ. Në dispozitat kalimtare, theksohet i njëjti autorizim për ministrin e punëve të brendshme e në të cilin dispozitë është mbështet ky udhëzim administrativ. Do të ishte më adekuate që udhëzimi të mbështetet vetëm në dispozitat përmbajtëse të ligjit, pasi që autorizimi i njëjti thjeshtë është përsëritur tek dispozitat kalimtare.
1180	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 05/2012 – MPB PËR KOMISIONIN E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	03.02.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 66, paragrafit 2.1. të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Në Ligjin nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, në brendi të tij, respektivisht në neni 7 paragrafi 4, përcaktohet shprehimisht që puna e komisionit për shqyrtimin e ankesave do të rregullohen me akt nënligjor. Përderisa ky nen në mënyrë eksplicite përcakton nxjerrjen e një akti nënligjor të tillë, dhe ndodhet në dispozitat përmbajtëse të ligjit, rekomandohet që udhëzimit administrativ në fjalë, t'i ndryshohet preambula ashtu që nxjerrja e këtij udhëzimi administrativ të mbështetet në nenin 7 paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.
1181	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 06/2012 – MPB PËR TRAJNIMIN, CERTIFIKIMIN, RICERTIFIKIMIN DHE LICENCIMIN E INSTITUCIONEVE TRAJNUESE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	27.03.2012	Ky udhëzim administrativ bazohet në nenin 7, nenin 37 paragrafi 7 dhe nenin 38 paragrafi 13 të Ligjit nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Në Ligjin nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë, respektivisht në nenin 37 paragrafi 7, ku përcaktohet: " 7. Trajnimi themelor profesional, i kryer brenda ose jashtë vendit, më tej do të përcaktohet me akt nënligjor në përputhje me standardet profesionale të Kosovës." dhe në nenin 38 paragrafi 13, ku përcaktohet "13. Organi kompetent me akt nënligjor përcakton procedurat për licencimin e institucioneve të trajnimit të specializuar, aprovimin e programeve të trajnimit, trajnimit dhe certifikimin e punëtorëve të specializuar të sigurimit, njohjen e trajnimeve të specializuara brenda dhe jashtë vendit, trajnimit specializuar rifreskues dhe ricertifikimin e punëtorëve të sigurimit në funksionet si operator të mbrojtjes së afërta, roje të TPG-së dhe mbajtës të qeneve dhe provimet e organizuara nga organi kompetent për t'u vërtetuar se është mbarë trajnimi adekuat.", janë bazë ligjore në të cilat mbështetet ky akt nënligjor. Mirëpo, ky udhëzim administrativ thirret edhe në nenin 7, në të cilin nen mungon baza ligjore, prandaj rekomandohet që udhëzimit administrativ t'i ndryshohet preambula, dhe akti të mbështetet vetëm në dy dispozitat e lart cekura.
1182	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 07/2012 – MPB PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	27.03.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 8 paragrafi 4, të Ligjit Nr .04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi, pasi që ekziston harmonizim i bazës ligjore në mes të udhëzimit administrativ dhe dispozitave përkatëse, respektivisht nenit 8 paragrafi 4, të ligjit Nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.
1183	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 08/2012 – MPB PËR PROCEDURAT E INSPEKTIMIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	27.03.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 39 paragrafi 8, të Ligjit Nr. 04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi, pasi që ekziston harmonizim i bazës ligjore në mes të udhëzimit administrativ dhe dispozitave përkatëse, respektivisht nenit 39 paragrafi 8, të ligjit Nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.
1184	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 09/2012 – MPB PËR BLERJEN, RUAJTJEN DHE PËRDORIMIN E PAJISJEVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	27.03.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 30 paragrafi 10, 31 dhe 32 paragrafi 5, të Ligjit Nr. 04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi, pasi që ekziston harmonizim i bazës ligjore në mes të udhëzimit administrativ dhe dispozitave përkatëse, respektivisht nenit 30 paragrafi 10, neni 31 paragrafi 9 dhe neni 32 paragrafi 5 të ligjit Nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.
1185	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 10/2012 – MPB PËR MBLËDHJEN DHE MIRËMBAJTJEN E TË DHËNAVE NGA ORGANI KOMPETENT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	27.03.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 40 paragrafi 3, të Ligjit Nr.04/L004 për Shërbimet private të Sigurisë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në Ligjin Nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë, në nenin 40 paragrafi 3 përcaktohet në mënyrë eksplicite nxerrja e një akti nënligjor me anë të të cilit përcaktohen forma, përmbajtja, dhe mënyra për të dhënë që do të ruhen nga organi kompetent, në të cilën dispozitë thirret ky udhëzim administrativ. Andaj përderisa ekziston baza ligjore e këtij akti nënligjor, rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1186	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 11/2012 – MPB MBI MASAT, AUTORIZIMET DHE DETYRAT E KOMPANIVE PRIVATE TË SIGURIMIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	27.03.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 27 paragrafi 9, të Ligjit Nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në Ligjit Nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë, në nenin 27 paragrafi 9 përcaktohet shprehimisht nxerrja e një akti nënligjor me anë të të cilit përcaktohen autorizimet dhe detyrat e kompanive private të sigurimit, në të cilën dispozitë thirret ky udhëzim administrativ. Andaj përderisa ekziston baza ligjore e këtij akti nënligjor, rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.

1187	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 13/2012 - MPB PËR THEMELIMIN, PËRBËRJEN DHE PROCEDURAT E KOMISIONIT PËR EMËRIME TË LARTA NË POLICINË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	02.05.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 37, paragrafi 8 dhe nenin 55, paragrafi 2, nënparagrafit 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi Administrativ ka bazë ligjore. Ligji e parasheh nxjerrjen e këtij udhëzimi edhe në nenin 37 paragrafi 8 edhe në kuadër të dispozitave kalimtare. Ligji nuk ka nevojë që shërbët për caktim bazën juridike në mënyrë të përsëritur tek dispozitat kalimtare, prandaj rekomandohet që të hiqet kjo dispozitë në rast të ndryshimplotësitimit të ligjit.
1188	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 14/2012 – MPB PËR RRJEDHJEN E INFORMACIONEVE DHE KOMUNIKIMIN DIREKT TË DHZMP-SË ME AGJENCITË, DEPARTAMENTET DHE ZYRAT E MPB-SË.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	21.05.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në Rregulloren e Punës së Qeverisë Nr. 09/2011, neni 38, paragrafi 6, si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2010 për Organizimin dhe Strukturimin e Brendshëm të MPB-së.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandimi i tillë derikon si rezultat i mungesës në bazës ligjore të këtij udhëzimi administrativ. Andaj pasur parasysh këtë fakt rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë duhet shfuqizuar.
1189	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 15/2012 - MPB PËR MENAXHIMIN DHE SHPENZIMIN E FONDEVE TË VEGANTA POLICORE.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	29.05.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 55, paragrafit 2, nënparagrafit 2.2 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ ka bazë ligjore specifike në kuadër të Ligjit për Policinë, andaj rekomandohet që pasi dispozita ligjore e autorizon ministrin për nxjerrjen e këtij akti nënligjor, dhe pas konstatimit të ekzistimit të bazës së mirëfilltë juridike, rekomandohet që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi.
1190	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 16/2012 – MPB PËR DHËNIEN E MEDALJEVE NË POLICI.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	29.05.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 54, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ ka bazë ligjore mirëpo baza ligjore ndodhet në kuadër të dispozitave kalimtare konkretisht në nenin 55 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3. Andaj rekomandohet që ky udhëzim administrativ të harmonizohet me dispozitat e ligjit në fuqi, respektivisht të mos thirret në nenin 54 paragrafi 2 dh 3 por në nenin 55 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3.
1191	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 21/2012 PËR TRANSFERIMIN E SHËRBIMIT TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT NË NJËSITË PROFESIONALE TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT NGA KOMUNAT NË MPB-AMË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	29.06.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 7, paragrafi 1, nenin 24, paragrafi 1 si dhe nenin 25 të Ligjit nr. 04-L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Në nenin 8 paragrafi 2 i këtij Udhëzimi Administrativ është i përcaktuar afati i vlefshmërisë deri me datë 31.06.2013.
1192	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 23/2012 – MPB PËR NORMAT TEKNIKE PËR FURNIZIMIN E MJETEVE MOTORIKE ME DERIVATE TË NAFTËS, DEPONIMIN DHE TOÇITJEN E DERIVATEVE TË NAFTËS NË PIKAT E SHITJES ME PAKICË.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	02.07.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 38, të Ligjit nr.04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Në dispozitat kalimtare, në nenin 38 të Ligjit nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, përcaktohet në mënyrë të përgjithësuar, nxerrja e një numri të pakufizuar të akteve nënligjore lidhur me kushtet e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, në të cilin nen mbështetet ky udhëzim administrativ. Ky formulim i tillë i cili e autorizon ministrin për nxjerrje të pakufizuar të akteve nënligjore është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Për më tepër, nga titulli dhe qëllimi i udhëzimit administrativ shihet se nuk janë në përputhje me këtë dispozitë ligjore në të cilën mbështetet ky udhëzim. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1193	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 24/2012- MPB PËR RRJETIN E HIDRANTEVE PËR FIJEN E ZJARRIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	02.07.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 38, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Në dispozitat kalimtare, në nenin 38 të Ligjit nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, përcaktohet në mënyrë të përgjithësuar, nxerrja e një numri të pakufizuar të akteve nënligjore lidhur me kushtet e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, në të cilin nen mbështetet ky udhëzim administrativ. Ky formulim i tillë i cili e autorizon ministrin për nxjerrje të pakufizuar të akteve nënligjore. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1194	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 25/2012 - MPB LIDHUR ME KUSHTET E MARJES ME PUNËT E AVANCIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	02.07.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 32, paragrafi 2, të Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ mbështetet në nenin 32 paragrafi 2 i cili në mënyrë eksplicite përcakton, nxjerrjen e një akti nënligjor, siç është edhe ky udhëzim administrativ, që do të përcaktoj kushtet teknike të cilat duhet ti plotësoj institucioni i cili bën trajnimin dhe ngritjen profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimin. Përderisa ekziston, baza e mirëfilltë ligjore, rekomandohet që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi.
1195	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 26/2012 – MPB PËR UNIFORMËN DHE SIMBOLET E NJËSIVE PROFESIONALE TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	10.08.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 8, paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky udhëzim administrativ ka bazë ligjore të harmonizuar me dispozitat e ligjit, pasi që neni në të cilin mbështetet ky udhëzim administrativ përcakton shprehimisht nxjerrjen e një akti nënligjor që rregullon uniformën dhe simbolin për njësi të profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimin. Duke parë përputhjen e këtij udhëzimi administrativ me dispozitat ligjore në fuqi, konstatohet që udhëzimi administrativ ka bazë ligjore të mirëfilltë dhe rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1196	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 27/2012 - MPB PËR KËSHILLAT KOMUNALE PËR SIGURI NË BASHKËSI	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	22.08.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L076 për Policinë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi i tillë vjen si rezultat i asaj që në neni 55 paragrafi 3 në mënyrë eksplicite përcaktohet se Qeveria është organi kompetent me propozimin e Ministrisë për Punë të Brendshme të nxjerr akti nënligjor për këshillat komunale për siguri në bashkësi, rekomandohet që udhëzimi administrativ të shfuqizohet pasi që nuk është harmoni me dispozitat ligjore. Në rast se konsiderohet i nevojshëm, këtë akt nënligjor duhet ta nxjerr qeveria ose t'i krijohet baza ligjore specifike në ligj që e autorizon ministrin për nxjerrjen e këtij udhëzimi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1197	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 32/2012 -MPB PËR PAGAT, SHITESAT DHE DOBITË TJERA TË PUNONJESVE NË AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	27.09.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 23, (1.4) të Ligjit nr.04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Konstatohet se në nenin 23, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit nr.04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë përcakton shprehimisht nxjerrjen e një akti nënligjor, siç është ky udhëzim administrativ, dhe pasi që qëllimi i këtij udhëzimi është në harmoni me dispozitat ligjore, konstatohet se ekziston baza e mirëfilltë ligjore e këtij udhëzimi administrativ dhe rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1198	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 35/2012 -MPB PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E VLERËSIMIT DHE NOTIMIT TË PUNËS SË PUNONJESVE TË AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	27.09.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 23 (1.3) të Ligjit nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Përderisa neni në të cilin është mbështet ky udhëzim administrativ, përkatesisht neni 23 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, parasheh nxjerrjen e një akti nënligjor siç është ky udhëzim administrativ, që rregullon procedurën e vlerësimit për punonjësit e AKF-së, konstatohet që baza juridike ekziston dhe është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, andaj dhe rekomandohet që e njëjta të mbetet në fuqi.
1199	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 36/2012 -MPB PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT DHE PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES SË KRYESHËRIT EKZEKUTIV TË AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	27.09.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 14(4) të Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në Ligjin nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, në nenin 14 paragrafi 4 shprehimisht përcaktohet nxjerrja e një akti nënligjor që do të rregulloj çështjen e përbërjes së komisionit si dhe procedurën e përzgjedhjes. Duke parë që udhëzimi administrativ është nxjerr si pasojë e autorizimit që rrjedh nga dispozita më lart, konstatohet që udhëzimi administrativ në fjalë ka bazë ligjore të mirëfilltë dhe rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1200	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 38/2012 – MPB PËR REGJISTRIMIN E AUTOMJETEVE NGA TARGAT TË ISH RFJ-SË NË TARGA TË PËRKOQSHMË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	18.12.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 301 të Ligjit Nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Ky rekomandim është si rezultat i harmonizimit të bazës ligjore në mes aktit nënligjor dhe dispozitës përkatesë të Ligjit për Siguri në Komunikacion. Gjithsesi, rekomandohet që në rast të rishikimit të udhëzimit janë si pasojë e gabimeve teknike sepse neni 301 nuk ka paragrafe.
1201	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 39/2012-MPB PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR AFTËSITË PSIKO-FIZIKE TË ZJARRFIKËSVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	18.12.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 8, paragrafi 3, të Ligjit nr.04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Duke vërejtur se neni 8 paragrafi 3 i Ligjit nr.04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim, përcakton shprehimisht nxjerrjen e një akti nënligjor, siç është ky udhëzim administrativ, konstatohet se ekziston baza e mirëfilltë ligjore e këtij udhëzimi administrativ, andaj rekomandohet që i njëjti të mbetet në fuqi.
1202	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 40/2012-MPB PËR STEMËN IDENTIFIKUESË TË AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	26.12.2012	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 23(1.1) të Ligjit nr.04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të këtij udhëzimi administrativ, vërejtja se ky udhëzim është nxjerr në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Nga ky fakt rekomandohet që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi.
1203	RREGULLORE NR. 01/2012 PËR THEMELIMIN, ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË NJËSITIN E HELIKOPTERËVE	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme		Kjo rregullore mbështetet në paragrafin 3 të nenit 32 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë dhe paragrafin 5 të nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pasi që rregullorja përputhet me dispozitat ligjore në fuqi, përkatesisht në nenin 32 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë dhe nenin 33 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, konstatohet që rregullorja ka bazë ligjore të mirëfilltë, dhe rekomandohet që e njëjta të mbetet në fuqi.

1204	RREGULLORJA E PUNËS NR. 02/2012-MPB E KOMISIONIT KOMBËTAR TË SIGURIMIT TË AVIACIONIT CIVIL	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	08.08.2012	Kjo rregullore mbështetet në Komisionit Kombëtar për Sigurimin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, ("Komisioni"), i themeluar me vendimin nr. 08/19, datë 15.06.2011 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 89, të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, dhe në pajtim me paragrafin 6 të nenit 38, të Rregullores së Punës së Qeverisë nr.09/2011, me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe detyrave të komisionit, miraton Rregulloren e punës së Komisionit.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas verifikimit dhe analizimit të dispozitës 89 të Ligjit për Aviacion Civil, për informimin : Rregullorja e MPB me Nr. 01/2009 Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Kosovës, në pajtim me Nenet 3.5, 28.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 mbi Aviacionin Civil), është e harmonizuar me Rregulloren (KE) Nr 300/2008 e cila shfuqizon Rregulloren (KE) Nr 2320/2002, andaj cdo dispozitë e amendamenteve të Rregullores (KE) Nr 300/2008 siç janë në Shtojcën i të Marrëveshjes HPEA, do të jetë drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Për këtë arsye Rregullorja në fjalë konsiderohet e nevojshme të mbetet në fuqi në bazë të argumentimit/referimit të dispozitave të lartëcekura.
1205	RREGULLORE NR. 03/2012 PËR OFRIMIN E TRAJNIMEVE DHE SHËRBIMEVE PËR PERSONAT PRIVAT FIZIK DHE JURIDIK	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	27.09.2012	Kjo rregullore mbështetet në nenin 2 dhe nenin 19 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Duke parë që Ligji Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, shprehimisht në nenin 19 paragrafi 2, i jep autorizim ministrit të nxjerr një akt nënligjor, si kjo rregullore, dhe pasi që qëllimi i kësaj rregullore është në harmoni me dispozitat në fuqi, konkludoj që rregullorja ka bazë ligjore të mirëfilltë dhe rekomandohet që e njëjta të mbetet në fuqi.
1206	RREGULLORJA NR. 04/2012- MPB PËR ARMËMBAJTJE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	04.12.2012	Kjo rregullore mbështetet në nenin 38, paragrafi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës nr. 09/2011.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi i tillë vije si rezultat i asaj që kjo rregullore nuk ka bazë të mirëfilltë ligjore, pasi që mbështetet vetëm në nenin 38, paragrafi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës nr. 09/2011. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në kriimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1207	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 02/2011 – MPB PËR STRUKTURËN E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË INSPEKTORATIT POLICOR TË KOSOVËS.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	01.06.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 31 paragrafi 1.4 të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Udhëzimi Administrativ nr. 02/2011 për strukturën e organizimit të brendshëm të Inspektoriatit Policor të Kosovës nuk është në fuqi, mirëpo në Gazetën Zyrtare nuk është përditësuar një informacion i tillë. Përdërisa Gazeta Zyrtare është një burim parësor, në lidhje me aktet juridike rekomandohet që e njëjta të përditësohet në mënyrë që mos të shkaktoj mëdyshje të qytetarët e Republikës së Kosovës.
1208	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 07/2011 – MPB PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR IMPORT DHE PËRDORUESIN E FUNDIT, EKSPORTIN E PËRKOHSEM DHE MASAT E SIGURISË GJATË TRANSPORTIT TË PQV-VE.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	29.07.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 36 nënparagrafi 1.4 dhe 1.13 të Ligjit për pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatese të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Ky udhëzim administrativ është i shfuqizuar. I tillë figuron edhe në gazetën zyrtare, ndërsa udhëzimi i cili e shfuqizon është Udhëzim administrativ nr. 02/2016 për lejen e eksportit të përkohshëm, verifikimin e importit nga përdoruesi i fundit, masat e sigurisë të institucioneve të autorizuar shtetërore për caktimin e personit përgjegjës dhe kriteret për përcjellje gjatë transportit të pqv-ve, i cili është punuar me nr. rendor 60.
1209	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 09/2011 – MPB PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR RIPRANIM	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	09.08.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 13, paragrafi 2 i Ligjit për Ripranim.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi për shfuqizim vjen si rezultat i asaj se, Udhëzimi administrativ nuk ka bazë ligjore. Si edhe shihet neni 13 par.2 i Ligjit për Ripranim përcaktohet se: Ministria e Punëve të Brendshme (jo Ministri) do të nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji, është formulim i përgjithshëm i cili në formë të pakufizuar parashih mundësin e nxjerrjes së udhëzimeve administrative. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1210	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 10/2011 – MPB PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR KRYRJEN E HETIMIT TË INTEGRITETIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	19.09.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 31 paragrafi 1.8 të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ ka bazë ligjore specifike në Ligjin për Inspektoratin Policor, andaj edhe është rekomanduar që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi.
1211	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 14/2011 – PËR KUSHTET DHE KRITERET PËR PËRDORIMIN E FONDI TË POSAQËM DHE KONTROLLIN E TJ	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	19.09.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 31 paragrafi 1.3 të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ ka bazë ligjore specifike në Ligjin për Inspektoratin Policor, andaj edhe është rekomanduar që udhëzimi administrativ të mbetet në fuqi.
1212	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 17/2011 – MPB PËR PËRCAKTIMIN E UDHËHEQJESË SË EVIDENCAVE PËR LETËRNJOFTIME/ DOKUMENTE UDHËTIMI	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	27.10.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 36 (b) të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit dhe nenin 27 të Ligjit për Letërnjoftimin.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ e ka bazën ligjore specifike në ligj në kuadër të dispozitave kalimtare përkatësisht të kreun VIII nenin 36 pika b. Kjo dispozitë e parashih se për metodën e mbajtjes së evidencave do nxirret akt nënligjor. Megjithatë akti nënligjor ka bazë juridike përkatëse në ligji, rekomandohet që të mbetet në fuqi. Mirëpo në Ligjin për Letërnjoftimin nuk ekziston neni 27, përkatësisht udhëzimi nuk ka bazë juridike përkatëse në këtë ligj, prandaj udhëzimi duhet të ndryshohet ashtu që të mos thirret në këtë dispozitë.
1213	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 21/2011 – MPB PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË FORMULARËVE PËR APLIKIM PËR PASAPORTË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	27.10.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 36 (a) të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ ka bazë ligjore në ligjin për dokumentet e udhëtimit andaj është rekomanduar që të mbetet në fuqi.
1214	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 23/2011 – PËR PËRMBAJTJEN DHE PËRCAKTIMIN E FORMËS SË FORMULARËVE TË APLIKIMIT PËR LETËRNJOFTIM	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	27.10.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 27, të Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftim.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Ky udhëzim administrativ mbështetet në një dispozitë të përgjithshme në kuadër të Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin, i cili është shfuqizuar. Përdërisa Ligji nr. 05/L-015 për Letërnjoftim, i cili aktualisht është në fuqi, në nenin 13 paragrafi 6 dhe neni 24 paragrafi 2 nënparagrafi 1, shprehimisht përcakton nxjerrjen e një akti nënligjor për çështjet të cilat janë përcaktuar në qëllimin e udhëzimit administrativ në fjalë, andaj rekomandohet që udhëzimi administrativ të harmonizohet me dispozitat ligjore pozitive.
1215	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 25/2011 – MPB PËR NDËRRIMIN E PATENTË SHOFERËVE TË ISH RFJ-SË DHE RISHOYRTIMIN E MUNGESËSË SË KATEGORIVË.NË MUNGESË TË DOKUMENTACIONIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	08.11.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në Ligjin Nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ky rekomandim është sepse ky akt nënligjor thirret se është nxjerr në mbështetje të Ligjit për Siguri në Komunikacionin rrugor, pa u përcaktuar në dispozitë konkrete të ligjit. Pas analizimit të dispozitave të Ligjit për siguri në Komunikacionin rrugor, në asnjë dispozitë nuk përcaktohet që ministri ka autorizim për nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ. Andaj konsideroj se nuk ka bazë juridike dhe rekomandohet që të shfuqizohet. Mirëpo në rast se konsiderohet i nevojshëm udhëzimi administrativ, atëherë t'i krijohet baza ligjore specifike.
1216	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 27/2011 – MPB PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	19.12.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 10, 11, 14, 15, 20, 35, 43 dhe 44 të Ligjit nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi, pasi që ekziston harmonizim i bazës ligjore në mes të udhëzimit administrativ dhe dispozitave përkatëse, respektivisht neni 10 paragrafi 8, neni 11 paragrafi 6, neni 14 paragrafi 7, neni 15 paragrafi 5, neni 20 paragrafi 2, neni 35 paragrafi 6, neni 43 dhe neni 44 paragrafi 5, të ligjit Nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.
1217	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 29/2011 – MPB PËR QENDRËN E KONTROLLIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	19.12.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 21 të Ligjit nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi, pasi që ekziston harmonizim i bazës ligjore në mes të udhëzimit administrativ dhe dispozitave përkatëse, respektivisht neni 21 paragrafi 4, të ligjit Nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.
1218	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 30/2011 – MPB PËR MASAT, AUTORIZIMET DHE DETYRAT E PUNËTORËVE TË SIGURISË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	19.12.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 28 dhe 29 të Ligjit nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi, pasi që ekziston harmonizim i bazës ligjore në mes të udhëzimit administrativ dhe dispozitave përkatëse, respektivisht neni 28 paragrafi 12 dhe neni 29 paragrafi 11, të ligjit Nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.
1219	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 31/2011 – MPB PËR ÇAKTIMIN E OPERATORIT TË MBROJTJES SË AFËRT PËR PERSONIN QË SIGUROHET	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	19.12.2011	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 22 të Ligjit nr.04/L004 për Shërbimet e Private Sigurisë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë të mbetet në fuqi, pasi që ekziston harmonizim i bazës ligjore në mes të udhëzimit administrativ dhe dispozitave përkatëse, respektivisht neni 22 paragrafi 4, të ligjit Nr.04/L004 për Shërbimet Private të Sigurisë.
1220	RREGULLORE NR. 07/2011 PËR PLOTËSIMIN E STANDARDEVE TË PËRBASHKËTA THEMELORE MBI SIGURIMIN E AVIACIONIT CIVIL TË PËRCAKTUARA NË ANEKSIN E RREGULLORES NR. 01/2009 TË MBP-SË E MBËSHTETUR NË RREGULLOREN (KE) NR. 272/2009	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme		Në mbështetje të Nenit 145 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullores 2001/19 mbi degën e ekzekutiv të institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, dhe në pajtim me nenet 3.5 dhe 28.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Kjo Rregullore është shfuqizuar me Rregulloren (MPB) NR. 01/2016 për aviacion civil.
1221	RREGULLORJA MPB NR. 08/2011 PËR VENDOSJEN E KRITERIVE PËR TË LEJUAR SHITJET ANËTARE QË TË HQJEN DORË NGA STANDARDËT E PËRBASHËTA BAZË MBI SIGURIMIN E AVIACIONIT CIVIL DHE TË MIRATOJË MASA ALTERNATIVE TË SIGURIMIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme		Në mbështetje të Nenit 145 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullores 2001/19 mbi degën e ekzekutiv të institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, dhe në pajtim me nenet 3.5 dhe 28.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Kjo Rregullore është shfuqizuar me Rregulloren (MPB) NR. 04/2020 për vendosjen e kriterëve për të lejuar derogimin nga standardet e përbashkëta themelore mbi sigurimin e aviacionit civil dhe miratimin e masave alternative të sigurimit. Andaj rekomandohet që të evidentohet në Regjistrin e Akteve Nënligjore.



1222	RREGULLORJA MPB NR.10/2011 QË PËRCAKTON PROCEDURAT PËR KRYERJEN E INSPEKTIMEVE TË KOMISIONIT NË FUSHËN E SIGURIMIT TË AVIACIONIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme		Në mbështetje të Nenit 145 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullores 2001/19 mbi degën e ekzekutiv të institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, dhe në pajtim me nenet 3.5 dhe 28.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.		Të shfuqizohet akti nënligjor.	Ky akt nënligjor nuk ka bazë ligjore. I njëjti përcakton zbatueshmërinë direkte të akteve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës. Këtu duhet pasur parasysh se kjo çështje rregullohet vetëm përmes Kushtetutës.
1223	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 05/2010 – MPB PËR TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AZILKËRKUESVE.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	10.02.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 36 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-066 për Azil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandimi i tillë vjen pasi që, udhëzimi administrativ në fjalë mbështetet në dispozitat e ligjit që nuk është në fuqi. Ligji i cili tanimë është në fuqi, është Ligji Nr. 06/L-026 për Azil, i cili ligj nuk parashihet se për çështjet të cilat rregullohen udhëzimi në fjalë do të rregullohen me akt nënligjor, madje as nuk përcakton për fatin e këtyre udhëzimeve që kanë bazë ligjore në ligjet e shfuqizuara. Pasur parasysh këtë fakt, konstatohet që me shfuqizimin e ligjit duhet të shfuqizohet edhe akti nënligjor, ose në të kundërtën t'i krijohet baza ligjore në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.
1224	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 10/2010 – MPB PËR KUSHTET MINIMALE TEKNIKE DHE TË SIGURISË QË DUHET TË PËRMBUSHEN NË OBJEKTET E POLIGONEVE CIVILE TË QITJES.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	12.05.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 65 paragrafi 8 të Ligjit për Armët nr 03/L-143.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Pasi që udhëzimi administrativ Nr. 10/2010 – për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë që duhet të përmbushen në objektet e poligoneve civile të qitjes, mbështetet në Ligjin nr 03/L-143 për Armët, i cili është i shfuqizuar, rekomandohet që i udhëzimit në fjalë t'i krijohet baza ligjore në harmoni me dispozitat në fuqi, përkatësisht të mbështetet në nenin 64 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë.
1225	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 12/2010 – MPB LIDHUR ME KUSHTET MINIMALE TEKNIKE DHE TË SIGURISË SE OBJEKTEVE QË PËRDOREN PËR AFTËSIMIN PRAKTIK DHE TEORIK TË MANIPULIMIT ME ARME.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	12.05.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 12 paragrafi 7 të Ligjit për Armët nr. 03/L-143.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Pasi që udhëzimi administrativ Nr.12/2010 – mpb lidhur me kushtet minimale teknike dhe të sigurisë së objekteve që përdoren për aftësimin praktik dhe teorik të manipulimit me armë, mbështetet në Ligjin nr 03/L-143 për Armët, i cili është i shfuqizuar, rekomandohet që i udhëzimit në fjalë t'i krijohet baza ligjore në harmoni me dispozitat në fuqi, përkatësisht të mbështetet në nenin 12 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë.
1226	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 13/2010 –MPB PËR ARMËT KOLEKSIONUESE.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	12.05.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 19 të Ligjit për Armët Nr. 03/L-143.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Udhëzimi administrativ nr. 13/2010 për armët koleksionuese, mbështetet në Ligjin për Armët Nr. 03/L-143, i cili ligj është i shfuqizuar. Ligji Nr. 05/L-022 për Armë, i cili ligj tanimë është në fuqi, në nenin 73 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8, përcakton se udhëzimi administrativ në fjalë do të zbatohet deri në momentin e nxjerrjes së akteve tjera nënligjore. Mbështetur në dispozitat e ligjeve në fuqi, udhëzimi administrativ 09/2017 për armët koleksionuese në mënyrë të heshtur e abrogon udhëzimin administrativ 13/2010. Andaj, përdërisa udhëzimi administrativ në fjalë nuk është në fuqi, rekomandohet që kështu të figuroj edhe në gazetën zyrtare, ndërsa udhëzimi administrativ 09/2017 për armët koleksionuese i cili është në fuqi, është punuar me numër rendor 47.
1227	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 14/2010 -MPB PËR ARMËT E FTOHTA	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	12.05.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 77 të Ligjit për Armët Nr. 03/L-143.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Pasi që udhëzimi administrativ Nr. 14/2010 - Për Armët e Ftohta, mbështetet në Ligjin nr 03/L-143 për Armët, i cili është i shfuqizuar. Rekomandohet që i udhëzimit në fjalë t'i krijohet baza ligjore në harmoni me dispozitat në fuqi, përkatësisht të mbështetet në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi 1.24, të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë.
1228	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 15/2010 – MPB PËR LEGALIZIMIN E ARMËVE TË ZJARRIT QË I TAKOJNË KATEGORISË B, C DHE D1.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	12.05.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 32, paragrafi 5 të Ligjit për Armët Nr. 03/L-143.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky udhëzim administrativ, mbështetet në Ligjin për Armët Nr. 03/L-143, i cili është i shfuqizuar. Mirëpo, duke qenë se ligji i ri në mënyrë eksplicite ka përcaktuar se ky udhëzim administrativ, do të zbatohet deri në nxjerrjen e akteve nënligjore tjera që rregullojnë çështjen e njëjtë, konsideroj që udhëzimi administrativ për të mos krijuar vakum ligjor, të mbetet në fuqi dhe në rast të ndryshim-plotësimit të Ligjit në fuqi, t'i krijohet baza specifike.
1229	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 18/2010 – MPB – PËR ORGANIZIMIN DHE STRUKTURIMIN E AGJENCISË SË MENAXHIMIT EMERGJENT.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	07.09.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe Udhëzimit Administrativ 16/2010 për Organizimin dhe Strukturën e MPB-së.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Ky udhëzim administrativ është i shfuqizuar, kështu figuron edhe në gazetën zyrtare (GZRK).
1230	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 20/2010 – MPB PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E REGJISTRIT TË VENDBANIMIT APO VENDQËNDRIMIT, REGJISTRIT TË SHËNIMEVE TË ABCD-VE, SI DHE REGJISTRIT TË MYSAFIRËVE.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	07.09.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në Ligjin për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin Nr. 02/L-12, neni 17 paragrafi 1 dhe 2.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi për shfuqizim vjen si rezultat i asaj se, Udhëzimi administrativ nuk ka bazë ligjore. Neni 17 i Ligjit për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin nuk e përcakton mundësinë e nxjerrjes së aktit nënligjor për rregullimin me të hollësisht të formës dhe përmbajtjes së regjistrit të vendbanimit apo vendqëndrimit, regjistrit të shënimeve të ABCD-ve si regjistrit të mysafirëve. Gjithashtu, edhe në dispozitat kalimtare në nenin 24 parashihet nxjerrjen e katër akteve nënligjore, por asnjë udhëzim nuk i përket formës dhe përmbajtjes së regjistrit të vendbanimit apo vendqëndrimit, regjistrit të shënimeve të ABCD-ve si regjistrit të mysafirëve. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1231	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 23/2010 – MPB PËR MIRËBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E REGJISTRAVE PËR TË HUAJT.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	07.09.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në Ligjin për të Huajt Nr.03/L-126.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Udhëzimi administrativ në fjalë mbështetet në Ligjin për të Huajt Nr.03/L-126, i cili ligj është i shfuqizuar. Ligji i cili tanimë është në fuqi, përkatësisht, Ligji për të Huajt Nr.04/L-219, në nenin 138 paragrafi 2 nënparagrafi 2.7, përcakton se udhëzimi në fjalë do të zbatohet deri në nxjerrjen e udhëzimeve tjera administrative. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1232	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 24/2010 – MPB PËR PROCEDURAT E TRASHEGIMISË PËR ARME DHE MUNICIONIN NË RAST TË VDEKJESË SË PRONARIT TË ARMËS SE ZJARRIT.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	27.09.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 48 paragrafi 3, të Ligjit për Armët 03/ L-143.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Udhëzimi administrativ në fjalë mbështetet në Ligjin për Armë Nr.03/L-143, i cili ligj është i shfuqizuar. Ligji i cili tanimë është në fuqi, përkatësisht, Ligji për Armë Nr.05/L-022, në nenin 49 paragrafi 3 përcakton të nxirret një akt nënligjor i cili do të rregullojë çështjet e njëjta për të cilat është nxjerrë edhe udhëzimi administrativ në fjalë. Duke parë përputhjen midis qëllimit të udhëzimit administrativ me dispozitat e ligjeve në fuqi, përkatësisht me nenin 49 paragrafi 3, rekomandohet që udhëzimit administrativ t'i ndryshohet preambula, ashtu që të mbështetet në dispozita ligjore pozitive.
1233	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 25/2010 – MPB PËR GJURMININ E ARMËVE TË ZJARRIT, PJESËVE TË TYRE DHE MUNICIONIT.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	27.09.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 70, paragrafi 3, të Ligjit për Armët Nr. 03/L-143.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ në fjalë mbështetet në ligjin i cili është i shfuqizuar. Qëllimi për të cilin është nxjerrë udhëzimi administrativ, çështja e tillë nuk trajtohet në ligjin i cili është në fuqi. Mirëpo ligji në fuqi, respektivisht në nenin 73 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12, përcakton se udhëzimi administrativ në fjalë do të zbatohet deri në nxjerrjen e akteve tjera nënligjore. Andaj rekomandohet që të mbetet në fuqi, mirëpo në rast të ndryshimit eventual të ligjit t'i krijohet baza ligjore specifike.
1234	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 26/2010 – MPB PËR SHËNJIMIN E ARMËVE TË ZJARRIT, PJESËVE DHE MUNICIONIT TË TYRE.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	27.09.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 56 paragrafi 2, të Ligjit për Armët Nr. 03/L-143.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Ky udhëzim administrativ mbështetet në ligjin i cili është i shfuqizuar. Mirëpo, ligji i cili është në fuqi, në nenin 56 paragrafi 2 përcakton se do të nxjerrjet një akt nënligjor, qëllimi i të cilit përputhet me qëllimin e këtij udhëzimi administrativ. Andaj duke pasur parasysh këtë fakt, rekomandohet që udhëzimi administrativ në fjalë t'i ndryshohet preambula dhe të thirret në dispozitat ligjore pozitive.
1235	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 27/2010 – MPB PËR MËNYRËN E TRANSFERIMIT TË ARMËVE, PJESËVE TË TYRE DHE MUNICIONIT, PËRTEJ KUFIRIT SHITËTËROR.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	27.09.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 60 paragrafi 4, nenin 61 paragrafi 4 dhe nenin 62 paragrafi 5, të Ligjit për Armët Nr. 03/L-143.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Udhëzimi administrativ në fjalë mbështetet në ligji i cili është i shfuqizuar, mirëpo Ligji për Armët në fuqi, në mënyrë eksplicite përcakton në nenin 73 paragrafi 1 nënparagrafi 1.14, që udhëzimi administrativ në fjalë do të zbatohet deri në nxjerrjen e akteve tjera nënligjore. Pas analizimit të dispozitave të këtij ligji në fuqi, vërejtja se neni 60 rregullon çështjet e njëjta që parashihen edhe në qëllimin e udhëzimit administrativ në fjalë, dhe autorizon ministrin për nxjerrjen e një akti nënligjor për këto çështje, andaj rekomandohet që udhëzimi administrativ të harmonizohet me dispozitat e ligjit në fuqi. Pastaj në nenin 61 dhe 62 rregullon çështjet e njëjta që parashihen në qëllimin e udhëzimit administrativ në fjalë, mirëpo nuk përcakton që këto çështje të rregullohen me akt nënligjor, prandaj rekomandohet që me rast të ndryshim-plotësimit të ligjit në fuqi, udhëzimit administrativ t'i krijohet baza ligjore.
1236	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 30/2010 – MPB PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR SKANIMIN DHE PËRSHKRIMIN E REGJISTRAVE TË GJENDJES CIVILE.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	01.10.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 11 të Ligjit nr.2004/46 mbi Regjistrat e Gjendjes Civile.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Udhëzimi administrativ në fjalë mbështetet në ligjin i cili është i shfuqizuar. Ligji në fuqi në dispozitat përfundimtare në nenin 65, përcakton të shfuqizohet Ligji Nr. 2004/46 për Regjistrat e gjendjes civile, dhe çdo dispozitë e cila është në kundërshtim me ligjin në fuqi. Pas analizimit të dispozitave të ligjit në fuqi, asnjë dispozitë nuk trajton çështjen e skanimit dhe kopjimit të regjistrave për gjendjen civile e aq më pak nuk përcakton se çështja e tillë të rregullohet me akt nënligjor. Duke pasur parasysh këtë fakt, kostonoj që me shfuqizimin e ligjit duhet të shfuqizohet edhe udhëzimi administrativ që mbështetet në të.
1237	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.33/2010 – MPB, PËR PËRBERJEN E KOMISIONIT DHE PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES SE KRYESHEFIT EKZEKUTIV TE INSPEKTORATIT POLICOR TE KOSOVËS.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	17.12.2010	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 31 paragrafi 1.5 të Ligjit për Inspektoratin Policor te Kosovës.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi Administrativ ka bazë ligjore. Ligji e parashihet nxjerrjen e këtij udhëzimi edhe në nenin 13 paragrafi 4 edhe në kuadër të dispozitave kalimtare. Ligji nuk ka nevojë që nderitet në përsëritur tek dispozitat kalimtare, prandaj rekomandohet që të hiqet pjesa ku është përsëritur autorizimi për nxjerrje të aktit nënligjor të njëjtë, në rast të ndryshim/plotësimit të Ligjit për Inspektoratin e Policor të Kosovës.

1238	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 07/2009 – MPB PËR FUNKSIONIMIN E DEPOS QENDRORE TË MPB-SË	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	30.03.2009	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 25 paragrafi 7 të Rregullores për Punë të Qeverisë nr.1/2007.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandimi vjen si rezultat i asaj se, pas analizimit të këtij udhëzimi shihet se është i bazuar në rregullore dhe në Kushtetutë, dhe referimi i tillë nuk krijon bazë ligjore për nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ, andaj është rekomanduar që të anulohet respektivisht që të shfuqizohet, ose që t'i krijohet baza ligjore në ligjin përkatës.
1239	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 12/2009 – MPB PËR KOMPENSIMIN E SHUJTES DITORE PËR INSPЕКТОRËT POLICOR TË KOSOVËS.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	10.09.2009	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 9 të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Udhëzimi administrativ në fjalë, mbështetet në ligjin i cili është i shfuqizuar. Ligji i cili është në fuqi në mënyrë shprehimore, në nenin 32 paragrafi 1 të tij, përcakton se Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës Nr.03/L-036, si dhe aktet nënligjore që burojnë prej tij shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Duke pasur parasysh dispozitat ligjore në fuqi, udhëzimi administrativ në fjalë nuk është në fuqi. Mirëpo nëse ministria e konsideron të nevojshëm këtë udhëzim administrativ, rekomandohet që udhëzimit administrativ t'i ndryshohet preambula ashtu që të harmonizohet me dispozitat e ligjeve në fuqi, respektivisht të thirret në nenin 28 paragrafi 1.
1240	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 15/2009 – MPB PËR DHËNIEN E BURSAVE STUDENTËVE QË STUDIOJNË NË FUSHËN E SIGURISË JASHTË VENDIT.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	10.11.2009	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 25 paragrafi 7 të Rregullores për Punë të Qeverisë nr.1/2007.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandimi vjen si rezultat i asaj se, pas analizimit të këtij udhëzimi shihet se është i bazuar në rregullore dhe në Kushtetutë, dhe referimi i tillë nuk krijon bazë ligjore për nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ, andaj është rekomanduar që të anulohet respektivisht që të shfuqizohet, ose që t'i krijohet baza ligjore në ligjin përkatës.
1241	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2008 – MPB PËR PËRCAKTIMIN E VULAVE PËR HYRJE DHE DALJE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	13.06.2008	Ky udhëzim administrativ mbështetet në nenin 25 paragrafi 7 të Rregullores për Punë të Qeverisë nr.1/2007.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Rekomandimi i tillë vije si rezultat i asaj është që udhëzimi administrativ në fjalë nuk ka bazë ligjore të mirëfilltë në ligjin përkatës. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1242	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 14/2008 – MPB PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN, SI DHE MËNYRËN E APLIKIMIT DHE LËSHIMIT TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT PËR KTHIM (FLETËUDHËTIMIT)	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	02.09.2008	Ky udhëzim administrativ mbështetet në Ligjin nr.03/L037 për Dokumentet e Udhëtimit neni 8.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Nga analiza e nenit 8 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit del se vetëm në paragrafin 5 parashihet kompetenca e organit kompetent për lëshimin e dokumentit të udhëtimit për kthim, por nuk e autorizon Ministrin që për rregullimin me të hollësishëm të formës, përmbajtjes si dhe mënyrës së aplikimit dhe lëshimit të dokumentit të udhëtimit për kthim, të nxjerr akt nënligjor. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1243	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 15/2008 – MPB PËR LLOJET E SHKELJEVE TË RËNDA DHE TË LEHTA DISIPLINORE NË POLICINË E KOSOVËS.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	23.09.2008	Udhëzimi administrativ është nxjerr në mbështetje të nenit 73.2 pika (a) të Ligjit për Policinë.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Udhëzimi Administrativ nr. 15/2008 për llojet e shkeljeve të rënda dhe të lehta disiplinore në Policinë e Kosovës nuk është në fuqi, mirëpo në Gazetën Zyrtare nuk është përditësuar një informacion i tillë. Përditësimi i kësaj informacioni në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës rekomandohet që e njëjta të përditësohet në mënyrë që mos të shkaktojë mëdyshje te qytetarët e Republikës së Kosovës.
1244	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 20/2008 – MPB PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS SË FORMULARIT, PËRMBAJTJES, PROCEDURËS PËR PAJISJE ME PASAPORTË DIPLOMATIKE DHE ZYRTARE SI DHE UDHËHEQJEN E EVIDENCËS.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	15.10.2008	Udhëzimi administrativ është nxjerr në mbështetje të nenit 145 (2) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neneve 23, 31, 36 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ ka bazë ligjore të mirëfilltë pasi që dispozitat ligjore në mënyrë eksplicite përcaktojnë nxjerrjen e këtij akti nënligjor, andaj rekomandohet që të mbetet në fuqi.
1245	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 25/2008 – MPB PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN, MËNYRËN E APLIKIMIT TË LËSHIMIT TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT GRUPOR	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme	03.12.2008	Udhëzimi administrativ është nxjerr në mbështetje të nenit 6.1 dhe nenit 13 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit ligji nr.03/L037.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Në këtë dispozita ligjore përkatësisht në nenin 8.1 dhe 13 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit nuk specifikohet shprehimisht se për formën, përmbajtjen, mënyrën e aplikimit të lëshimit të dokumentit të udhëtimit grupor do të nxirret akt nënligjor. Ligji në nenin 8.1 përcakton kompetencën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për dhëniën e dokumentit të udhëtimit grupor, por nuk parashihet që për çështjet që ndërlidhen me tej për formën, përmbajtjen, mënyrën e aplikimit të lëshimit të dokumentit të udhëtimit se do të nxjerret akt nënligjor. Gjithashtu, edhe neni 13 përcakton kriteret mbi të cilat lëshohet dokumenti i udhëtimit grupor, por nuk e autorizon Ministrinë Punëve të Brendshme që të nxjerr akt nënligjor për sqarim të mëtejshëm të çështjeve që ndërlidhen me dokumentin e udhëtimit. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1246	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 26/2008 – MPB PËR MËNYRËN E PRODHIMIT, TREGITIMIT, TRANSPORTIT DHE ASGJËSIMIT TË PRODUKTEVE PIROTEKNIKE.	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	05.12.2008	Ky udhëzim administrativ mbështetet në kreun V të Ligjit Nr. 03/L-005 për Përdorimin Civil të Eksploziveve.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Arsyeja e një rekomandimi të tillë, vie pasi që ky udhëzim administrativ mbështetet në dispozita ligjore të Ligjit i cili është i shfuqizuar. Mirëpo, për të mos u krijuar vakumi ligjor për këtë fushë specifike, t'i krijohet baza ligjore në Ligjin nr. 04/L-022 për përdorimin civil të eksplozivëve.
1247	RREGULLORE (MPB) NR. 04/2020 PËR VENDOSJEN E KRITEREVE PËR TË LEJUAR DEROGIMIN NGA STANDARDET E PËRBASHKËTA THEMELORE MBI SIGURIMIN E AVIACIONIT CIVIL DHE MIRATIMIN E MASAVE ALTERNATIVE TË SIGURIMIT	Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.	18/11/2020	Kjo rregullore mbështetet në nenin 90, paragrafi 90.3 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Rregullorja në fjalë, mbështetet në dispozita ligjore, respektivisht nenin 90 paragrafi 90.3, të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, e cila dispozitë e autorizon ministrin të nxjerr këtë rregullore. Duke parë përputhjen që ekziston mes dispozitave ligjore dhe qëllimit të rregullores, konstatohet që rregullorja ka bazë të mirëfilltë ligjore, dhe e njëjta të mbetet në fuqi.
1248	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 13/2018 PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT TË INFORMATAVE NË ARSIMIN E LARTË	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	21.09.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1.13, të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dispozitave të nenit 8 (1.4) të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyres së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe dispozitave të nenit 38, paragrafi 6 të Rregullores së Punes së Qeverisë nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Neni 6 i Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë në ofrimin e arsimit të lartë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dokumentet plotësuese të nxjerrja në bazën e tij dhe të atyre të nxjerrja në bazë të nenit 14 të Ligjit për arsim në komunat e Republikës së Kosovës (nr. 03-L-068, të majit 2008). Me asnjë nënparagraf të paragrafi 1 apo të paragrafi 2 të këtij neni, nuk është paraparë nxjerrja e ndonjë akti nënligjor, që do të thotë as e Udhëzimit Administrativ për sistemin e Menaxhimit të informatave në arsimin e lartë si dhe as në nënparagrafin 1.13 të paragrafi 1 të këtij neni. Në një anë nënparagrafi 1.13 në fjalë është i përgjithshëm dhe nuk përcakton në mënyrë konkrete nxjerrjen e aktit nënligjor për sistemin e menaxhimit të informatave në arsimin e lartë, dhe nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore për nxjerrjen e udhëzimit administrativ në fjalë. Baza ligjore këtij Udhëzimi Administrativ nuk mund të konsiderohet si bazë relevante ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor sepse është dispozitë e karakterit të përgjithshëm. Andaj, baza ligjore këtij Udhëzimi Administrativ e mbështetur në paragrafin 1 të nënparagrafi 1.13 të nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, nuk mund të konsiderohet si bazë relevante ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor sepse është dispozitë e karakterit të përgjithshëm e pakufizueshme dhe jo bazë ligjore konkret për nxjerrje të aktit nënligjor. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1249	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 21/2016 PËR NDAJEN E MJETEVE BUXHETORE NGA KATEGORIA E SUBVENCIONEVE DHE TRANSFEREVE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	28.09.2016	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1.5, 1.6, 1.7, 1.9, 1.10, 1.12, të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.4, 14 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 8, paragrafi 1, pika 1.4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyres së Kryeministrit dhe Ministrive.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se as në nenin 6 të Ligjit për arsimin e lartë dhe as në nenin 5 paragrafi 14 të Ligjit për arsimin parauniversitar, në mënyrë decidue, nuk është paraparë nxjerrja e aktit nënligjor për ndajen buxhetore nga kategoria e subvencioneve dhe transferëve. Mirëpo në nenin 14 paragrafi 10 të Ligjit për arsimin e lartë parashihet nxjerrja e aktit nënligjor për përfshirjen e nxënësve në institucionet e aftësisimit në nivelin 4 të ISCED-it, e jo për çështjet që është rregulluar me Udhëzimin administrativ në fjalë. Mungon baza ligjore në ligjin për arsimin e lartë për nxjerrjen e këtij Udhëzimi administrativ. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.

1250	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 12/2018 PËR PARIMET DHE PROCEDURAT E NUOHJES SE DIPLOMAVE, GRADAVE DHE KUALIFIKIMEVE TE SHKOLLAV TE LARTA PROFESIONALE DHE UNIVERSITARE TE FITUARA JASHTE REPUBLIKES SE KOSOVES	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	10.09.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenint 6 te Ligjit nr. 04/L-037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, nenit 8, nenparagrafi 1.4 te rregullores nr. 02/2011 per fusat e pergjegjessise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Sipas nenit të theksuar (neni 6) të Ligjit në fjalë, konstatohet se në asnjë paragraf nuk është paraparë nxjerrja e aktit nënligjor i cili rregullon çështjet që i ka rregulluar ky Udhëzim administrativ. Do të thotë se nxjerrja e këtij Udhëzimi administrativ nuk ka bazë ligjore për nxjerrjen e tij. Në të vërtetë, neni 6 i ligjit në fjalë në paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 ka paraparë "nxjerrjen e aktit nënligjor me të cilin rregullohet autorizimi i formatit dhe i përmbajtjes së Diplomës dhe të Shtojcës së diplomës, në bashkëpunim me Sgjinëncë Kosovare për Akreditim që lëshohen nga bartësit e akredituar të arsimit të lartë.  Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1251	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 16/2015 PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONALIZIMIN E UNIONIT TE STUDENTVE TE REPUBLIKES SE KOSOVES	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	04.11.2015	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenint 33, paragrafi 1 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Neni 33 parimisht rregullon organizatat studentore, përkatësisht krijimin e një ose më shumë organizatave për përfaqësimin e studentëve...ndërsa statuti apo çdo dokument tjetër i bartësit të arsimit të lartë parasheh krijimin e tyre. Kjo nënkupton se për krijimin e organizatave studentore nuk parashihet nxjerrja e aktit nënligjor për themelimi e tyre, siç është vëpruar me Udhëzimin administrativ në fjalë. Do të thotë se nuk ka bazë ligjore për themelimin dhe funksionimin e unionit të studentëve të Republikës së Kosovës me Udhëzim administrativ, por "Statuti ose çdo dokument tjetër i bartësit të arsimit të lartë parasheh krijimin e organizatave studentore" (paragrafi 1 i nenit 33 të Ligjit për arsimin e lartë). Nëse kemi parasysh kuptimin e shprehjeve në nenin 3 paragrafi 1, nënparagraf 1.13 ku përcaktohet se "bartës është çdo institucion ose organ tjetër i autorizuar për ofrimin e shërbimeve arsimore në nivelin e arsimit të lartë" ndërsa sipas nën paragrafi 1.14 të nenit 3 të Ligjit për arsimin e lartë rrjedh se "bartës publik" është bartës i themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, del se krijimi i bartësit të arsimit të lartë bëhet sipas statutit ose të çdo dokumenti tjetër i themeluar nga arsimi të lartë, varësisht se a është bartës publik apo privat i arsimit.  Në bazë të theksimeve konstatohet se në dispozitën në të cilën mbështet nxjerrja e Udhëzimit administrativ (paragrafi 1 i nenit 33 të Ligjit për arsimin e lartë, nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore për nxjerrjen e tij, sepse në nenin në fjalë nuk figuron nxjerrja e aktit nënligjor për rregullimin e çështjeve nga neni 33 për themelimin dhe konstituimin e unionit të studentëve të Republikës së Kosovës. Duhet të përcaktohet baza ligjore në ligjin në fuqi.  Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1252	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 14/2017PËR NDARJEN E BURSAVE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	06.12.2017	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenint 32, te Ligjit nr. 04/L-037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, dispozitave te nenit 8 (1.4) te Rregullores nr. 02/2011 per fusat e pergjegjessise administrative te Zyres se kryeministrit dhe Ministrive, si dhe dispozitave te nenit 38, paragrafi 6 te Rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Lidhëhën nxjerrjen e këtij akti nënligjor e lënë si mundësi, duke u bazuar në nevojat ekonomike. Lidhëhëni, sipas nenit në fjalë ka paraparë aktin nligjor për krijimin e skemës apo skemave për mbështetje financiare të studentëve bazura në nevojat ekonomike.  Vërtetohet se nuk është paraparë nxjerrje e aktit nënligjor i cili rregullon çështjen për ndarjen e burrave. Andaj konsiderojmë se Udhëzim administrativ në fjalë nuk e ka bazën relevante ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili rregullon vetëm çështjen e ndarjes së burrave studentëve. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij. Me konkretisht, rekomandohet që ky Udhëzim administrativ të harmonizohet me bazën ligjore të përcaktuar në nenin 32 të Ligjit për arsimin e lartë.
1253	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 11/2015 KRAHASUESHMERIA DHE BARASVLERA E DIPLOMAVE DHE PROGRAME BOLONJES DHE TE SISTEMIT TE BOLONJES	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	21.09.2015	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenint 16, te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, ne pajtim me shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fusat e pergjegjessise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive, dhe nenin 38 (6) te Rregullores se punes se Qeverise nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Në nenin 16 të Ligjit në fjalë nuk ka dispozitë për nxjerrje të aktit nënligjor lidhur krahasueshmërinë dhe barasvlerën e diplomave dhe të programeve të Bolonjës dhe të sistemit të Bolonjës. Në të vërtetë në nenin 16 të theksuar nxjerrjen e dy akteve nënligjore lidhur me gradat dhe diplomatat dhe ato: 1) Aktin nënligjor për formatin e gradës apo diplomës (paragrafi 8) dhe 2) Aktin nënligjor për kërkesat shtesë arsimore, përveç gradës apo diplomës, si kusht për t'u punësuar në ndonjë profesion, i cili trajtohet nga ligje tjera apo në bazë të kushteve të përcaktuara në konventa apo marrëveshje ndërkombëtare.  Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1254	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 09/2015 PARIMET DHE PROCEDURAT E PRANIMIT TE DIPLOMAVE TE SHKOLLAVE TE LARTA PROFESIONALE DHE GRADAVE UNIVERSITARE TE FITUARA NE TERRITOTIN E REPUBLIKES SE SERBISE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	10.08.2015	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenint 6, paragrafi 1.6 te Ligjit 04/L-037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, nenit 8, paragrafi 1, pika 1.4) te rregullores nr.02/2011 per fusat e pergjegjessise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive, ne mbeshtetje te Konventes per Njohjen e Kualifikimeve ne fushen e arsimit te larte ne regionin Evropian te vitit 1997 ("Konventa e Lisbonës per njohjen") e nenshkruar nen organizimin te Keshillit te Evropes dhe UNESCO-s si dhe me te gjitha dokumentet e tjera percjelluese te kesaj Konvente; si dhe ne mbeshtetje te Marrëveshjes se Dialogut Kosove-Serbi te arritur ne Nentor 2011 (per pranimit te diplomave)	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Udhëzim Administrativ i përmendur, nuk e ka bazën ligjore në këtë nen, andaj gjatë harmonizimit të Ligjit në fjalë duhet pas në konsideratë edhe harmonizimin përkatësisht të përcaktimit të bazës ligjore të këtij udhëzimi administrativ. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1255	UDHËZIMI ADMINISTRATIV MASHT NR. 02/2015 MBAJTJA E ZGJEDHJEVE STUDENTORE DHE ZGJEDHJA E KESHILLAVE NE NJESI AKADEMIKE NE UNIVERSITETIN "FEHMI AGANI" TE GJAKOVES	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	27.02.2015	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te neneve 4, 21 dhe 22 te Ligjit nr.03/L189 per administraten shtetore te Republikës se Kosoves dhe neni 1 dhe 6 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fusat e pergjegjessise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive 22.03.2011, nenit 38 paragrafi 6 te rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se as në neni 1 dhe 6 si dhe as në asnjë dispozitë tjetër të Ligjit për Arsimin e Lartë nuk është paraparë nxjerrje e aktit nënligjor me përmbajtje që rregullon materjen që është rregulluar me Udhëzimin administrativ në fjalë. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1256	UDHËZIMI ADMINISTRATIV MASHT NR. 03/2015 MBAJTJA E ZGJEDHJEVE STUDENTORE DHE ZGJEDHJA E ORGANEVE DHE KESHILLAVE NE NJESI AKADEMIKE NE UNIVERSITETIN "ISA BOLETINI" NE MITROVICE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	27.02.2015	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te neneve 4, 21 dhe 22 te Ligjit nr.03/L189 per administraten shtetore te Republikës se Kosoves dhe neni 1 dhe 6 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fusat e pergjegjessise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive 22.03.2011, nenit 38 paragrafi 6 te rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se as në neni 1 dhe 6 si dhe as në asnjë dispozitë tjetër të Ligjit për Arsimin e Lartë nuk është paraparë nxjerrje e aktit nënligjor me përmbajtje që rregullon materjen që është rregulluar me Udhëzimin administrativ në fjalë. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1257	UDHËZIMI ADMINISTRATIV MASHT NR. 01/2015 MBAJTJA E ZGJEDHJEVE STUDENTORE DHE ZGJEDHJA E ORGANEVE DHE KESHILLAVE NE NJESI AKADEMIKE NE UNIVERISTETIN "KADRI ZEKA" TE GJILANIT	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	27.02.2016	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te neneve 4, 21 dhe 22 te Ligjit nr.03/L189 per administraten shtetore te Republikës se Kosoves dhe neni 1 dhe 6 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fusat e pergjegjessise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive 22.03.2011, nenit 38 paragrafi 6 te rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se as në neni 1 dhe 6 si dhe as në asnjë dispozitë tjetër të Ligjit për Arsimin e Lartë nuk është paraparë nxjerrje e aktit nënligjor me përmbajtje që rregullon materjen që është rregulluar me Udhëzimin administrativ në fjalë. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.

1258	UDHËZIMI ADMINISTRATIV MASHT NR. 33/2014 LIBRI AMËZ I STUDENTEVE TE INSTITUCIONEVE TE ARSIMIT TE LARTE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	01.10.2014	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbështetje te nenit 6, paragrafi 1.13 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e perqjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive 22.03.2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin e ligjit.	Baza ligjore në paragrafin 1 nënparagrafi 1.13 është e përgjithshme dhe nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore relevante. Andaj, konstatohet se nuk ekziston baza ligjore përkatëse. Konsiderojmë se baza ligjore në të cilat është bazuar nxjerrja e këtij akti nënligjor janë të përgjithshme. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1259	UDHËZIMI ADMINISTRATIV MASHT NR. 26/2014 PËR VERIFIKIMIN E DOKUMENACIONIT SHKOLLOR (PUBLIK DHE PRIVAT) PËR NEVOJAT E KANDIDATEVE QE SHKOLLOHEN JASHTË SHITËTIT	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	21.07.2014	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbështetje te nenit 6, paragrafi 1.13 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, nenit 8 te Ligjit per Inspektorin e Arsimit ne Kosove, te nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e perqjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Baza ligjore është e përgjithshme dhe nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore relevante. Andaj, konstatohet se nuk ekziston baza ligjore përkatëse. Konsiderojmë se baza ligjore në të cilat është bazuar nxjerrja e këtij akti nënligjor janë të përgjithshme. Kështuqë, për shkak të mos ekzistimit të bazës ligjore përkatëse rekomandohet se Udhëzimi administrativ në fjalë duhet të harmonizohet me ligjin në fjalë në fuqi, në të kundërtën duhet të anulohet/pezuohet ose të pezullohet zbatimi i tij.
1260	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 15/2014 KATEGORITE E STUDENTEVE ME PERPARESË PËR BANIM NE QENDREN E STUDENTEVE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	06.05.2014	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbështetje te nenit 32 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, ne nenin 9 paragrafi 1.11 dhe nenin 20 te Ligjit per Statusin dhe te Drejtat e Deshmoreve, Invalideve, veteraneve, Pjesetareve te Ushtrise Cilirimtare te Kosoves, Viktimave Civile dhe Familjeve te tyre, ne baze te nenit 12 nenparagrafi 1.2, i paragrafi 1 te Ligjit nr.03/L-95 per te Drejtat e ish te Denuarve dhe te Perndjekurve Politike, duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e perqjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky akt nënligjor ka bazë ligjore në Nenin 20 (1.4) të e Ligjit per Statusin dhe te Drejtat e Deshmoreve, Invalideve, veteraneve, Pjesetareve te Ushtrise Cilirimtare te Kosoves, Viktimave Civile dhe Familjeve te tyre, nenit 12 nenparagrafi 1.2, i paragrafi 1 te Ligjit nr.03/L-95 per te Drejtat e ish te Denuarve dhe te Perndjekurve Politike dhe Nenin 32 të Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves. Sidoqoftë në rastin e ndryshimit dhe plotësimit të aktit nënligjor në të ardhmen, të hiqet si bazë ligjore nga preambula Rregullorja e Punës së Qeverisë dhe Rregullorja për Fushat e Përqjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.
1261	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 17/2014 APLIKIMI I PAGESAVE TE STUDENTEVE NE UNIVERSITETET PUBLIKE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	06.05.2014	Ne baze te nenit 30 paragrafi 1 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, dhe duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e perqjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Konstatohet se ky Udhëzim administrative e ka bazën ligjore relevante në Ligjinin për Arsimin e Lartë për nxjerrjen e tij. Andaj, nxjerrja e këtij Udhëzimi Administrativ është kryer në pajtim me legjislacionin në fuqi.
1262	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 12/2013 MBAJTJA E ZGJEDHJEVE NE UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" TE PEJES	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	08.04.2013	Ne mbështetje te nenit 1 dhe 6 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, ne pajtim me shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e perqjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (dt.22.03.2011) nenin 38 (6) te Rregullores se punes se Qeverise nr.09/2011, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT),	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Konstatohet se as në nenin 1 dhe 6 si dhe as në asnjë dispozitë tjetër të Ligjit për Arsimin e Lartë nuk është paraparë nxjerrje e aktit nënligjor me përmbajtje që rregullon materjen që është rregulluar me Udhëzimin administrativ në fjalë. Andaj, Udhëzimi administrativ në fjalë konsiderohet se nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me Ligjin për Arsimin e Lartë, dhe rekomandohet shfuqizimi i tij.
1263	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 01/2013 EMERTIMI I INSTITUCIONEVE TE ARSIMIT TE LARTE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	16.01.2013	Ne mbështetje te nenit 11 paragrafi 5 dhe 6 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, ne pajtim me shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e perqjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (dt.22.03.2011) nenin 38 (6) te Rregullores se punes se Qeverise nr.09/2011, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT),	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Vlerësohet se ky Udhëzim Administrativ është nxjerrë në pajtim me bazën ligjore relevante të përcaktuar në nenin 11 paragrafi 5 të Ligjit për Arsimin e Lartë.
1264	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 23/2012 GRADAT DHE DIPLOMAT E BARTESVE TE ARSIMIT TE LART (BAL)	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	22.10.2012	Ne baze te nenit 16 Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e perqjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive 22.03.2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky Udhëzim administrative është nxjerrë në pajtim me bazën ligjore të përcaktuar në nenin 16 paragrafi 1.
1265	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 24/2012 KATEGORITE E STUDENTEVE PER ASISTENCE SI DHE KUSHTET PER FITIMIN E ASISTENCES	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	22.10.2012	Ne mbështetje te nenit 32 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, neni 9 paragrafi 1.11 dhe neni 20 i Ligjit per Statusin dhe te drejtat e Deshmoreve, Invalideve, veteraneve, Pjesemarresve te Ushtrise Cilirimtare te kosoves, Viktimave Civile dhe Familjareve te tyre, nenin 8 paragrafi 1.4, ne pajtim me shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e perqjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (dt.22.03.2011) dhe nenin 38 (6) te rregullores se Punes se Qeverise nr.09/2011,	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky akt nënligjor ka bazë ligjore në Nenin 20 (1.4) të e Ligjit per Statusin dhe te Drejtat e Deshmoreve, Invalideve, veteraneve, Pjesetareve te Ushtrise Cilirimtare te Kosoves, Viktimave Civile dhe Familjeve te tyre dhe nenit 32 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves. Sidoqoftë në rastin e ndryshimit dhe plotësimit të aktit nënligjor në të ardhmen, të hiqet si bazë ligjore nga preambula Rregullorja e Punës së Qeverisë dhe Rregullorja për Fushat e Përqjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.
1266	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 01/2016 PERCAKTIMI I KUSHTEVE, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PER ORGANIZIMIN E MESIMIT PLOTESUES PER NXENESIT E RIATDHESUAR	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	12.01.2016	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbështetje te nenit 49 te Ligjit nr.04/L032 per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves, nenit 8 paragrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e perqjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Udhëzimi administrativ është mbështetur në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar që që ka paraparë se "Ministria nxjerrë akte nënligjore brenda një (1) viti për zbatimin e këtij ligji dhe për çështjet që nuk mbulohehen me këtë ligj". Si dispozitë kalimtare në pjesën "ministria nxjerrë akte nënligjore brenda një (1) viti për zbatimin e këtij ligji" konsiderohet në rregull por pjesa tjetër "dhe për çështjet që nuk mbulohehen me këtë ligj" është dispozitë jo vetëm e përgjithshme por edhe autorizohet ministri me autorizime të pakufizueshme ligjore edhe "për çështjet që nuk mbulohehen me këtë ligj" që është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë dhe është dispozitë e përgjithshme sepse nuk përcakton konkretisht se për cilat çështje juridike ka autorizime. Kështu konsiderohet se baza juridike nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, i përgjithshëm dhe me autorizime të përgjithshme dhe të pakufizueshme për Ministrin. Kështu, vlerësohet se Udhëzimi administrativ në fjalë nuk është në pajtim me legjislacionin dhe se nuk bazë ligjore konkrete relevante për nxjerrjen e tij. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.

1267	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHTI) NR. 05/2021 PER NORMATIVIN MBI KUADRIN PROFESIONAL TE ARSIMIT TE PERGJITHESHEM	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	18.06.2021	Ne mbeshtetje te nenit 5 paragrafi 16, nenit 49 te Ligjit nr. 04/L-032 per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves, ne mbeshtetje te nenit 8, 10 dhe 11 te Ligjit nr.06/L-113 per Organizimin dhe funksionimin e Administrates Shtetore dhe te Agjencive te Pavarura, (gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 20190, nenit 8 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4, shtojca 1 paragrafi 7 i rregullores (QRK) nr. 02/2021 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive te dates 30.03.2021 dhe Udhëzimit Administrativ nr.03.2013 per standardet e hartimit te akteve normative.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konsiderojmë se baza ligjore në të cilat është bazuar nxjerrja e këtij akti nënligjor (paragrafi 16 dhe 49 i nenit 5 të Ligjit në fjalë) janë të përgjithshme dhe baza ligjore nuk është përcaktuar në dispozitat materiale të këtij ligji për rregullim me akt nënligjor të çështjes juridike për normativin për kuadrin profesional të arëimit të përgjithshëm, konsiderohet se është edhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Parimi i ligjshmërisë, sikurse edhe parimi i kushtetutshmërisë, është parim universal, sepse ekziston në të gjitha rendet juridike dhe në të gjitha shtetet. Ky është parim tepër i rëndësishëm dhe për te, sipas detyrës zyrtare, duhet të kujdeset të gjithë nxjerrësit e akteve nënligjore si dhe kryesit e veprimëve materiale. Në kuptimin juridik, parimi i ligjshmërisë nënkupton superioritetin absolut të ligjit në raport me të gjitha dispozitat e tjera juridike. Në kuptimin politik, ky parim ndërlihet me rendin demokratik dhe konsiderohet një nga supozimet e saja thelbësore. Në rastin konkret bartja Ministrisë, si organ ekzekutiv, të detyrimit që vet të rregullojë dhe sigurojë materjen e caktuar juridike në mënyrë të përgjithshme, me çka i jipen autorizime të pakufizueshme që "16. Ministria nxjerrë akte nënligjore në çdo fushë të përgjegjësive të saj në bazë të këtij ligji ose cilldo ligji tjetër në fuqi" apo neni 49 "1.Ministria nxjerrë akte nënligjore brenda një (1) viti për zbatimin e këtij ligji dhe për çështjet që nuk mbulohe me këtë ligj", duke mos e precizuar se materjen e caktuar juridike të caktuar për rregullim me akte nënligjore të saja, paraqet shkelje të ligjshmërisë . Vlen të theksohet se neni 5 i ligjit në fjalë ka paraparë bazën ligjore për nxjerrjen e 16 akteve nënligjore (paragrafi 1 nenparagrafi 1.8, nenparagrafet: 1.10, 2.2, 2.2, 2.3, 2.4, 3.1, 3.2, 3.3, 3.3, paragrafet: 6, 8, 9, 11, 13, 14.), ndërsa në asnjë paragraf apo nenparagraf të nenit 5 të këtij ligji nuk është përcaktuar nxjerrja e Udhëzimit Administrativ për Normativin për kuadrin profesional të arsimin ligjor të përgjithshëm. Konsiderojmë se baza ligjore në të cilat është bazuar nxjerrja e këtij akti nënligjor janë të përgjithshme Andaj, Udhëzimi Administrativ i përmendur për normativin dhe kuadrin profesional të Arsimit të përgjithshëm nuk e ka bazën ligjore në këtë nen, megjithatë me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, në rastin e harmonizimit të Ligjit në fjalë në të ardhmen, duhet pas në konsideratë edhe harmonizimin përkatësisht të përcaktimit të bazës ligjore të këtij udhëzimit administrativ në Ligjin si dhe të fshirjes së paragrafit 16 të nenit 5 dhe të paragrafit 1 të nenit 49 të këtij Ligji.
1268	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 03/2021 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT "PANELI I ART"	Ministri i Arsimit dhe Shkencës	15.03.2021	Ministri i Arsimit dhe Shkencës ne mbeshtetje te nenit 33 paragrafi 1 dhe nenit 5 paragrafi 16 te Ligjit nr.04/L-032 per Arsimin parauniversitar ne Republiken e Kosoves, nenit 12 dhe nenit 10 paragrafi 3 te Ligjit nr. 06/L-046 (Gazeta Zyrtare nr. 13/10 gusht 2018 per Inspektoratin e Arsimit ne republiken e Kosoves, nenit 8 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4, te Rregullores (QRK) nr. 6/2020 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive te dates 06.06.2020 dhe nenit 4 shtojces 11 te Rregullores (QRK) - nr. 07/2020 per Ndryshimin dhe Plotesimin e Rregullores (QRK) - nr. 06.2020 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive, dt.16.06.2020,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Akti nënligjor ka bazë ligjore në Nenin 18 (3) të Ligjit në fuqi për Inspektoratin e Arsimit.
1269	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 08/2018 PËR THEMELIMIN DHE FUQIZIMIN E EKIBEVE PËR PARANDALIM DHE REAGIM KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË NXËNËSVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	25.05.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ne mbeshtetje te nenit 3, nenit 5 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4, paragrafi 16 te Ligjit per Arsimin parauniversitar ne Republiken e Kosoves (Gazeta zyrtare nr17/16 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregullores se punes se Qeverise nr. 09/2011 (Gazeta zyrtare nr.15, 12.09.2011).	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Asnjë nga nenet e theksuara si mbeshtetje ligjore të këtij Udhëzimi administrativ, në mënyrë decisive nuk kanë paraparë nxjerrjen e udhëzimit administrativ për rregullimin e themelimit dhe fuqizimit të ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar. Sepse neni 3 i Ligjit për arsimin parauniversitar rregullon parimet e përgjithshme të arsimin parauniversitar, ndërsa neni 5 i ligjit në fjalë ka paraparë nxjerrjen e disa akteve nënligjore për rregullimin e çështjeve që nuk ka të bëjë me themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar, por për çështje tërësisht tjera në realizimin e detyrave të Ministrisë të përcaktuar në nenin 5 të Ligjit në fjalë. Sa i përket mbeshtetjes në Ligjin 16 të nenit 5 të këtij ligji se "Ministria nxjerrë akte nënligjore në çdo fushë të përgjegjësive të saj në bazë të këtij ligji ose cilldo ligji tjetër në fuqi", nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore relevante, sepse është e përgjithshme dhe bartja që Ministria vet ta rregullojë dhe sigurojë materjen e caktuar juridike në mënyrë të përgjithshme pa u përcaktuar çështja juridike e cila do të rregullohet me udhëzimin administrativ, në këtë mënyrë Ministrisë i jipen autorizime të pakufizueshme, konsiderojmë se është e paligjshme dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Andaj në Ligjin përkatës në fjalë, duhet të përcaktohet në mënyrë decisive/konkrete baza ligje për materjen e caktuar juridike që Udhëzimi administrativ në fjalë të harmonizohet me Ligjin.
1270	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 09/2018 GJIMNAZI I SPECIALIZUAR MATEMATIKOR NË PRISHTINË, FUNKSIONALITETIT DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE E TIJ	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	08.06.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ne mbeshtetje te nenit 5 paragrafi 16 dhe nenit 49 te Ligjit nr. 04/L-032 per Arsimin parauniversitar ne Republiken e Kosoves (Gazeta zyrtare nr17/16 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregullores se punes se Qeverise nr. 09/2011 (Gazeta zyrtare nr.15, 12.09.2011),	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Baza ligjore e këtij Udhëzimi administrativ është mbeshtetur në dispozita të cilat janë të karakterit të përgjithshëm, sepse mundësohet nxjerrja e aktit nënligjor "në çdo fushë fushë të përgjegjësive të saj në bazë të këtij ligji dhe cilldo ligji tjetër në fuqi" (Neni 5 paragrafi 16), apo "Ministria nxjerrë akte nënligjore...për zbatimin e këtij ligji dhe për çështjet tjera që nuk mbulohe me këtë ligj" (neni 49 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar), që është e kundërligjshme sepse organeve ekzekutive i jipen autorizime të pakufizueshme ligjore që është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Në Ligjin për Arsimin Parauniversitar duhet të përcaktohet baza konkrete ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili rregullon materjen konkrete juridike të institucionit arsimor në fjalë. Të gjeturat bëjnë me dije se ky Udhëzim Administrativ i nxjerrur nuk e ka të përcaktuar bazën ligjore konkrete në Ligjin për Arsimin Parauniversitar, por është bazuar në dispozitë të përgjithshme. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1271	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASH) NR. 85/2020 PER KALENDARIN E VITIT SHKOLLOR 2020/2021	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Ska date te nenshkrimimit (17.09.2020)	Ministri i Arsimit dhe Shkencës ne mbeshtetje te nenit 5 paragrafi 2 nenparagrafi 2.1 te Ligjit per Arsimin parauniversitar ne Republiken e Kosoves (Gazeta zyrtare nr17/16 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4, te Rregullores (QRK) nr. 06/2020 dhe shtojces 11 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (08.06.2020),	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky Udhëzim Administrativ e ka të përcaktuar bazën ligjore për nxjerrjen e saj, dhe Udhëzimi administrativ është nxjerrë në pajtim me bazën e përcaktuar ligjore, si dhe e ka shfuzquz Udhëzimin administrativ Nr. 18/19 të datës 29.08.2019, paraprak, dhe të gjitha udhëzimet administrative të mëparshme që kanë rregulluar këtë fushë. Rrjedhimisht, akti në fjalë nuk ka nevojë për ndryshime ose plotësime.
1272	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 106/2020 PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË DREJTORIT DHE TË ZËVENDËSDREJTORIT TË INSTITUCIONIT PUBLIK ARSIMOR PARAUNIVERSITAR	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	17.09.2020	Ministri i Arsimit dhe Shkencës ne mbeshtetje te nenit 5 paragrafi (d dhe h) te Ligjit per Arsim ne komunat e Republikes se Kosoves dhe neneve 5, 20, 34 dhe 35 te Ligjit per Arsimin parauniversitar, nenit 12 te Ligjit per inspektoratin e Arsimit ne Republiken e Kosoves ne mbeshtetje te nenit 8 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4, te Rregullores (QRK) nr. 06/2020 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive e dt. 06.06.2020, dhe nenit 4 te rregullores (QRK) nr.7/2020 per Ndryshimin dhe Plotesimin e Rregullores (QRK) - nr. 06/2020 per Fushat e Pergjegjesise Administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive, dt.16.06.2020,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Neni 5 paragrafi d) dhe i Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nuk parashihet çështjen e vlerësimit dhe të performancës së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar, por, në paragrafin d) bëhet fjalë për zgjedhjen e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar, që janë objekt i Udhëzimit administrativ në fjalë. Gjithashtu, në Ligjin për arsimin parauniversitar, në nenet e theksuara 5, 20, 34 dhe 35 nuk flitet çështjen juridike të vlerësimit të performancës së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar. Baza ligjore për nxjerrjen e këtij akti nënligjor për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitare, është paraparë në nenin 12 paragrafi 7 të Ligjit për Inspektoratin Arsimor të Republikës së Kosovës, e cila është relevante, ndërsa nenet e tjera të theksuara si baza ligjore janë të tepërta. Rrjedhimisht, rekomandohet të ndryshohet dhe plotësohet ky akt nënligjor, me bazë në Nenin 12 (7) të Ligjit në fuqi për Inspektoratin e Arsimit dhe njëherit të përfshihet edhe materia për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve sipas kërkesave të kësaj dispozite.

1273	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASH) NR. 119/2020 PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË MËSIMËDHËNËSVE ME BAZË NË SHKOLLË	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	07.10.2020	Ministri i Arsimit dhe Shkencës ne mbeshtetje te nenit 5 te Ligjit nr.04/L-032 per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr. 17/16 shtator 2011), nenit 3 pika (a) te Ligjit per arsimin ne komunat e Republikes se kosoves, nenit 4, shtojces 11 te Rregulores (QRK) nr.7/2020 per Ndryshimin dhe Potesimin e Rregulores (QRK) - nr. 06/2020 per Fushat e Pergjegjesise Administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive, dt.16.06.2020.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Nxjerrësi i këtij Udhëzimi Administrativ si bazë ligjore e ka marrë nën 5 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar dhe nën 3 paragrafi 1 nënparagrafi a) i Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat. Në asnjë nga nenet e theksuara të ligjeve të përmendura por as në dispozitat e tjera të këtyre ligjeve nuk është përcaktuar baza konkrete ligjore për nxjerrje të aktit nënligjor për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë. Bazat ligjore të theksuar në hyrjen e këtij Udhëzimi Administrativ janë dispozita të cilat rregullojnë përgjegjësitë kryesore të MASHT-it për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, si dhe detyrimet e përgjithshme (neni 5) dhe përgjegjësitë në zhvillimin e politikave dhe të hartimit e implemmentimit të legjislatcionit për zhvillimin e arsimit duke përfshirë zhvillimin e arsimit të lartë dhe shkencës në Kosovë (neni 3 paragrafi 1 nën a). Do të thotë se në ligjet e lartpërmendura nuk është përcaktuar baza relevante ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor për zhvillimin e profesionit të mësimitdhënësve me bazë në shkollë.  Prandaj, konstatohet se Udhëzimit Administrativ në fjalë është nxjerrë pa bazë ligjore konkrete të parapare me ligj. Gjithsesi me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.
1274	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 15/2019 PËR AKREDITIMIN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	28.09.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te neneve 6, 7 te Ligjit nr.04/L037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr. 19, 9 shtator 2011), nenit 8 paragrafi1, pika 1.4, te Rregulores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare nr. 1, 18 prill 2011),	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Neni 6 rregullon Këshillin Shtetëror për Arsimin Parauniversitar dhe në paragrafin 4 parashihet nxjerrjen e aktit nënligjor lidhur me çështjet administrative që kanë të bëjnë me këtë institucion (KSHAP), do të thotë se nuk parashihet nxjerrje të aktit nënligjor për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, siç është bërë me Udhëzimin në fjalë. Gjithashtu, as në nenin 7 të Ligjit të përmendur nuk parshifet të nxjerrjes së ndonjë akti nënligjor dhe as të aktit nënligjor që rregullon çështjen e akreditimit të institucioneve të arsimit parauniversitar. Në bazë të theksimeve konstatohet se Udhëzimi Administrativ është nxjerrë pa bazë ligjore të përcaktuara me ligj. Gjithsesi me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.
1275	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 03/2019 PËR DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E MASHT, DKA, SHKOLLAVE DHE KOORDINATORËVE NË ORGANIZIMIN, MENAXHIMIN, MBIKËQYRJES DHE ADRESIMIN E TË GJETURAVE NGA PROGRAMI PËR VLËRËSIMIN NËRËKOMBËTAR TË NXËNËSVE (PISA)	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	09.02.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 5 paragrafi 1 nenparagrafi 11, si dhe nenparagrafi 16 te Ligjit per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves nr 04/L-032 (Gazeta Zyrtare nr.17/16 shtator 2011), ne pajtim me shtojcen nr. 6 te Rregulores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive te dates 22.03.2011, nenit 38 paragrafi 8 te Rregulores se punes se Qeverise se Republikes se Kosoves,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Nënparragrafi 11 i paragrafit 1 të nenit 5 të këtij ligji nuk ka përcaktuar nxjerrje të aktit nënligjor rregullimin e çështjeve lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e MASHT-a, DKA, shkollave dhe koordinatorëve në organizimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe adresimin e të gjeturave nga programi për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve PISA). Nënparragrafi 11 i nenit në fjalë parashihet "organizimin dhe menaxhimin e vlerësimit të jashtëm për nivelet 1,2 dhe 3 të ISCED në përputhje me kërkesat për dhënjën e kualifikimeve të Kornizës Kombëtare të kualifikimeve dhe sipas nevojës , duke u konsultuar me Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve." Në dispozitat e theksuar (nenin 5 paragrafi 1 nënparagrafi 11) konstatohet nuk ka bazë ligjore konkrete për nxjerrje të ndonjë akti nënligjor dhe të Udhëzimit për detyrat dhe përgjegjësitë e MASHT, DKA, Shkollave dhe Koordinatorëve në organizimin, menaxhimin, mbikëqyrjes dhe adresimin e të gjeturave nga programi për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve (PISA). Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.
1276	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 04/2018 PËR PLANIFIKIMIN E INVESTIMEVE KAPITALE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	09.02.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 5 paragrafi 7 nenparagrafi 7.1, 7.5, 7.6 te Ligjit per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves nr 04/L-032 (Gazeta Zyrtare nr.17/16 shtator 2011), nenit 8 nenparagrafi 1.4 te Rregulores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregulores se punes se Qeverise nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Ligji për Arsimin Parauniversitar në paragrafin 7 nënparragrafet 7.1, 7.5 dhe 7.6 të ligjit në fuqi për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nuk ka përcaktuar asnjë bazë ligjor për nxjerrje të ndonjë akti nënligjor as për nxjerrjen e aktit nënligjor për rregullimin e çështjeve juridike të parapara në paragrafin 7 të nenit të të ligjit në fjalë. Gjithsesi, paragrafi 8 i nenit 5 të Ligjit në fuqi për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës, përcakton se "Përmes një akti nënligjor, Ministria miraton standardet e licencimit të institucioneve arsimore dhe aftësuese, përfshirë edhe standardet e cekura në paragrafin 7. të këtij neni".Rrjedhimisht, rekomandohet që te ndryshohet dhe plotësohet vetë akti nënligjor me qëllim të përcaktimit të bazës së saktë ligjore edhe në Nenin 7 (8) të Ligjit të sipër përmendur.
1277	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 04/2019 PËR NDERPRERJEN DHE NDALIMIN E PUNËS SË PERSONIT JURIDIK DHE NDALIMIN E PUNËS DHE INICIMIN E PROCEDURËS DISIPLINORE TË PERSONIT FIZIK	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	13.05.2019	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 13 paragrafi 2 nenparagrafi 2.3 dhe nenit 27 te Ligjit nr. 06/L-046 per Inspektoratin e Arsimit ne Republiken e Kosoves, nenit 46 paragrafi 5 i Ligjit per Arsimin parauniversitar ne Republiken e Kosoves (ligji nr. 04/L-032 - Gazeta Zyrtare nr.17/2011), nenit 11 paragrafi 3 i Ligjit te Larte ne Republiken e Kosoves (Ligji nr. 04/L-037 Gazeta Zyrtare nr. 14/2011) nenit 8 nenparagrafi 1.4 te Rregulores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregulores se punes se Qeverise nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15/2011),	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Sipas Nenit 13 paragrafi 2 nënparragrafet 2.1 dhe 2.2 të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit janë përcaktuar rastet kur inspektori i arsimit ndërprer dhe ndalon punën e personit juridik dhe fizik që ushtron veprimtari arsimore (edukative, arsimore dhe aftësuese) pa licencë pune nga MASHT (nënparragrafi 2.1) dhe punën e institucionit arsimor, personit juridik dhe fizik që ushtron veprimtari arsimore në kundërshtim me legjislatcionin në fuqi (nënparragrafi 2.2). Ndërsa për rastet e tjera për ndërprerjen dhe ndalimin e punës sipas nënparragrafit 2.3 të nenit 13 ka paraparë nxjerrjen e aktit nënligjor për rregullimin e rasteve tjera të ndërprerjes dhe ndalimit. Mbeshtëja në në paragrafin 5 të nenit 46 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe paragrafi 3 i nenit 11 të Ligjit për Arsimin e Lartë nuk mund të konsiderohen si bazë ligjore, sepse nuk parashohin nxjerrje të aktit nënligjor dhe ngase rregullojnë çështje tjera që nuk kanë ndërlidhje me rregullimin e çështjeve tjera për ndërprerjen dhe ndalimin e punës që parashihet me nënparragrafin 2.3 të nenit 13 të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit. Udhëzimi Administrativ në fjalë i analizuar konsiderohet se e ka bazën ligjore të përcaktuar në Ligjin Nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit (nënparragrafi 2.3 paragrafi 2 i nenit 13) dhe nxjerrja e tij është e ligjshme.
1278	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 05/2019 PËR PROCEDURAT KUR ANKESA NUK E SHTYNË EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË INSPEKTORIT TË ARSIMIT	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Ska date te nenshkrim	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit14, 24, 27 te Ligjit nr. 06/L-046 per Inspektoratin e Arsimit ne Republiken e Kosoves, nenit 8 nenparagrafi 1.4 te Rregulores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregulores se punes se Qeverise nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Lidhur me bazën ligjore për nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ në fjalë, vërtetohet se në asnjë nga nenet (14, 24 dhe 27 të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit) , në të cilat është mbështetur nxjerrja e këtij akti nënligjor, nuk është caktuar baza relevante ligjore për nxjerrje të aktit nënligjor i cili rregullon procedurën kur ankesa nuk e shpynë ekzekutimin e vendimit të inspektorit të arsimit. Kështu që ky akt nën konsiderohet se është nxjerrur pa patur bazën ligjore në ligjin përkatës, përkatësisht në Ligjin për Inspektoratin e Arsimit. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.
1279	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 06/2019 PËR ANULIMIN E DËFTESAVE PËR PËRFUNDIMIN E KLASËS, DËFTESAVE DHE PËRFUNDIMIN E NIVELIT TË ARSIMIT, CERTIFIKATAVE DHE DIPLOMAVE TË FITUARA NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN E APLIKUESHËM	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	13.05.2019	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 13 paragrafi 1.3 te Ligjit nr. 06/L-046 per Inspektoratin e Arsimit ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr. 13, 10 gusht 2018), nenit 8 paragrafi 1, nenparagrafi 1.4 te Rregulores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregulores se punes se Qeverise nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011),	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Nënparragrafi 1.3 i paragrafit 1 të nenit 13 të Ligjit për Inspektoratin e arsimit nuk përcakton nxjerrjen e aktit nënligjor për rregullimin e çështjeve për anulimin e dëftesave për përfundimin e klasës, dëftesave dhe përfundimin e nivelit të arsimit, certifikatave dhe diplomave të fituara në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm. Andaj, konsiderohet se Udhëzimi Administrativ në fjalë është nxjerrë pa patur bazën konkrete ligjore të përcaktuara me Ligjin për Inspektoratin Arsimor. Kështu që, Udhëzimi Administrativ në fjalë është nxjerrë pa bazë relevante ligjore. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.
1280	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 07/2019 PËR LOGON DHE VULAT E INSPEKTORATIT TË ARSIMIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	13.05.2019	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 4 paragrafi 4 te Ligjit nr. 06/L-046 per Inspektoratin e Arsimit ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr. 13, 10 gusht 2018), nenit 8 paragrafi 1, nenparagrafi 1.4 te Rregulores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregulores se punes se Qeverise nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011),	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Ky Udhëzim Administrativ është i ligjshëm sepse e ka bazën ligjore në Ligjin për Inspektoratin e Arsimit (neni 4 paragrafi 4 "Logo dhe teksti i vulave rregullohet përmes aktit nënligjor" dhe është nxjerrë në pajtim me bazën e përcaktuar ligjore për nxjerrjen e tij.
1281	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 04/2021 PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONALIZIMIN E KESHILLIT TE NXËNËSVE	Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë & dhe Inovacionit	18.06.2021	Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ne mbeshtetje te nenit 18 te Ligjit per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr.17/16 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1, paragrafi 1.4, shtojca 1 paragrafi 7 i Rregulores (QRK) nr. 02/2021 per fushat e pergjegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive te dates 30.03.2021,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se nuk është paraparë nxjerrje e aktit nënligjor. Udhëzimi administrativ në fjalë rekomandohet që harmonizohet dhe korrigjohet respektivisht të shfuzgohet për shkak të mungesës së bazës relevante ligjore për nxjerrjen e tij.

1282	UDHEZIMI ADMINISTRATIV: NR.02/2021 PER PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E UDHEZIMIT ADMINISTRATIV NR. 10/2019 DT.20.06.2019 DHE PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E UDHEZIMIT ADMINISTRATIV NR. 11/2015 DHE SHFUQIZIMIN E UDHEZIMIT ADMINISTRATIV 152/2020, DT.22.12.2020, KRAHASUESHMERIA DHE BARASVLERA E DIPLOMA VE DHE E PROGRAMEVE STUDIMORE PARA SISTEMIT TE BOLONJES DHE TE SISTEMIT TE BOLONJES SI DHE UDHEZIMI ADMINISTRATIV NR. 01/2021 I DT. 13.01.2021 KRAHASUESHMERIA DHE BARASVLERA E DIPLOMA VE DHE E PROGRAMEVE STUDIMORE PARA SISTEMIT TE BOLONJES	Ministri i Arsimit dhe Shkencës	28.09.2018	Ministri i Arsimit dhe Shkencës, ne mbeshtetje te nenit 16 dhe nenit 35 te Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr.14, 9 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1, nenparagrafi 1.4, te Rregullores nr. 06/2020 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive, ne mbeshtetje nenit 38 paragrafi 6 te Rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011), si dhe nenit 10 paragrafi 2 te Udhhezimit Administrativ nr. 03/2013 per standardet e hartimit te akteve normative,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	
1283	UDHEZIMI ADMINISTRATIV (MASH) NR. 136/2020 PER KRIJIMIN E STRUKTURES STIMULUESE PER MBESHTETJEN E SHKOLLIMIT TE NXENESVE NE DREJTIMIT DEFICITARE DHE PER VAJZAT/GRATE NE DREJTIMIT TEKNIKE NE INSTITUCIONET E ARSIMIT DHE AFTESIMIT PROFESIONAL (IAAP)	Ministri i Arsimit dhe Shkencës	Ska date te nenshkrimt	Ministri i Arsimit dhe Shkencës, ne mbeshtetje te nenit 49 te Ligjit per Arsimin Parauniversitar e Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr.17, 16 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1, nenparagrafi 1.4, dhe shtojces 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011),	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Udhëzimi administrativ është mbështetur në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar që që ka paraparë se "Ministria nxjerrë akte nënligjore brenda një (1) viti për zbatimin e këtij ligji dhe për çështjet që nuk mbulohe me këtë ligji". Si dispozitë kalmtare në pjesën "ministria nxjerrë akte nënligjore brenda një 1 viti për zbatimin e këtij ligji" konsiderohet në rregull por pjesa tjetër "dhe për çështjet që nuk mbulohe me këtë ligji" është dispozitë jo vetëm e përgjithshme por edhe autorizohet ministri me autorizime të pakufizueshme ligjore edhe "për çështjet që nuk mbulohe me këtë ligji" që është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë dhe është dispozitë e përgjithshme sepse nuk përcakton konkretisht se për cilat çështje juridike ka autorizime. Kështu konsiderohet se baza juridike nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, i përgjithshëm dhe me autorizime të përgjithshme dhe të pakufizueshme për Ministrin. Megjithatë me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.
1284	UDHEZIMI ADMINISTRATIV (MASH) NR. 86/2020 PER SISTEMIMIN E NXENESVE NE SHKOLLA, TE CILET JANE KTHYER PAS MIGRIMIT DHE U MUNGOJNE DOKUMENTET PERKATASE ARSIMORE.	Ministri i Arsimit dhe Shkencës	Ska date te nenshkrimt	Ministri i Arsimit dhe Shkencës, ne mbeshtetje te nenit 5 paragrafi 16 te Ligjit nr. 04/L-032 per Arsimin Parauniversitar e Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr.17, 16 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1, nenparagrafi 1.4, te Rregullores (QRK) nr. 6/2020 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive dt.06.06.2020, dhe nenit 4 te Rregullores (QRK) - nr. 07/2020 per Ndryshimin dhe Pletesimin e Rregullores (QRK) - nr. 06/2020 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive, dt.16.06.2020,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konsiderojmë se baza ligjore në të cilat është bazuar nxjerrja e këtij akti nënligjor (paragrafi 16 i nenit 5 të Ligjit në fjalë) janë të përgjithshme dhe baza ligjore nuk është përcaktuar në dispozitat materiale të këtij ligji për rregullim me akt nën ligor të çështjes juridike për normativin për kuadrin profesional të arësimit të përgjithshëm, konsiderohet se është edhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Parimi i ligjshmërisë, sikurse edhe parimi i kushtetutshmërisë, është parim universal, sepse ekziston në të gjitha rendet juridike dhe në të gjitha shtetet. Ky është parim tepër i rëndësishëm dhe për te, sipas detyrës zyrtare, duhet të kujdeset të gjithë nxjerrësit e akteve nënligjore si dhe kryesit e veprimve materiale. Andaj, Udhëzimi Administrativ i përmendur nuk e ka bazën ligjore në këtë nen, kështu që në rastin e harmonizimit të Ligjit në fjalë në të ardhmen, duhet pas në konsideratë edhe harmonizimin përkatësisht të përcaktimit të bazës ligjore të këtij udhëzimi administrativ në Ligji si dhe të shprehjes së paragrafit 16 të nenit 5.
1285	UDHEZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 02/2017 PER VLEFSHMERINE E PROGRAMEVE STUDIMORE TE BARTESVE PRIVAT TE LARTE (BPRAL)	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	16.02.2017	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te paragrafi 1.2 dhe 1.3 te nenit 2 dhe paragrafi 13 te nenit 6 te Ligjit per Arimin e Larte ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr. 14/09 shtator 2011), ne pajtim me shtojcen 6 te Rregullores nr.02/2011 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (dt.22.03.2011) dhe nenin 38 (6) te Rregullores se Punes se Qeverise nr.09/2011,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se as në neni 2 dhe 6 të Ligjit për Arsimin e Lartë nuk është paraparë nxjerrje e aktit nënligjor me përmbajtje që rregullon materjen që është rregulluar me Udhëzimin administrativ në fjalë. Madje neni 2 flet vetëm për parimet, ndërsa tek neni 6 nuk kemi paragraf te 13, sic është referuar ne udhezim Administrativ. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.
1286	UDHEZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 13/2019 PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E UDHEZIMIT ADMINISTRATIV ME NR. 08/2019 TE DT. 17.05.2019 PER PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E UDHEZIMIT ADMINISTRATIV NR. 15/2018 PER AKREDITIMIN E INSTITUCIONEVE TE ARSIMIT TE LARTE NE REPUBLIKEN E KOSOVES	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	02.07.2019	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 6 dhe 7 te Ligjit nr.04/L037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr.14/9 shtator 2011), nenit 8, nenparagrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive dhe nenit 10 paragrafi 1 te Udhhezimit Administrativ nr.03/2013 "Per Standardet e hartimit te akteve normative",	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Neni 6 rregullon Këshillin Shtetëror për Arsimin Parauniversitar dhe në paragrafin 4 parasheh nxjerrjen e aktit nënligjor lidhur me çështjet administrative që kanë të bëjnë me këtë institucion (KSHAP), do të thotë se nuk parasheh nxjerrje të aktit nënligjor për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, siç është bërë me Udhëzimin në fjalë. Gjithashtu, as në nenin 7 të Ligjit të përmendur nuk parshifet të nxjerrjes së ndonjë akti nënligjor dhe as të aktit nënligjor që rregullon çështjen e akreditimit të institucioneve të arsimit parauniversitar. Megjithatë me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.
1287	UDHEZIMI ADMINISTRATIV PER PLOTESIMIN DHE PRECIZIMIN (ANEKSI -I- MASHT) NR. 7/2018 E UA NR. 01/2018 PARIMET E NUOHJES SE PLATEFORMEAVE DHE REVISTAVE NDERKOMBETARE ME RECENSION	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	23.02.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 6 paragrafi 1, nenparagrafi 1.13 te Ligjit nr.04/L037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, nenit 8, paragrafi 1, nenparagrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregullores nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr.15.12.09.2011,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Baza ligjore në paragrafin 1 nënparagrafi 1.13 është e përgjithshme dhe nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore relevante. Andaj, konstatohet se nuk ekziston baza ligjore përkatëse/konkrete. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1288	UDHEZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 02/2019 PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E NENPARAGRAFIT 5.3.4 DHE NENPARAGRAFIT 5.3.5 TE NENPARAGRAFIT 5.3 TE PARAGRAFIT 5 TE NENIT 26 TE UDHEZIMIT ADMINISTRATIV "PER AKREDITIMIN E INSTITUCIONEVE TE ARSIMIT TE LARTE NE REPUBLIKEN E KOSOVES" ME NR. 15/2018 I DT. 28.09.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	31.01.2019	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 6 dhe 7 te Ligjit nr.04/L037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr.14/9 shtator 2011), nenit 8, nenparagrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive dhe nenit 10 paragrafi 1 te Udhhezimit Administrativ nr.03/2013 "Per Standardet e hartimit te akteve normative",	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Neni 6 rregullon Këshillin Shtetëror për Arsimin Parauniversitar dhe në paragrafin 4 parasheh nxjerrjen e aktit nënligjor lidhur me çështjet administrative që kanë të bëjnë me këtë institucion (KSHAP), do të thotë se nuk parasheh nxjerrje të aktit nënligjor për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, siç është bërë me Udhëzimin në fjalë. Gjithashtu, as në nenin 7 të Ligjit të përmendur nuk parshifet të nxjerrjes së ndonjë akti nënligjor dhe as të aktit nënligjor që rregullon çështjen e akreditimit të institucioneve të arsimit parauniversitar. Megjithatë me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.
1289	UDHEZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 08/2019 PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E UDHEZIMIT ADMINISTRATIV NR. 15/2018 PER AKREDITIMIN E INSTITUCIONEVE TE ARSIMIT TE LARTE NE REPUBLIKEN E KOSOVES	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	17.05.2019	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 6 dhe 7 te Ligjit nr.04/L037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr.14/9 shtator 2011), nenit 8, nenparagrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergegjesise administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive dhe nenit 10 paragrafi 1 te Udhhezimit Administrativ nr.03/2013 "Per Standardet e hartimit te akteve normative",	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Neni 6 rregullon Këshillin Shtetëror për Arsimin Parauniversitar dhe në paragrafin 4 parasheh nxjerrjen e aktit nënligjor lidhur me çështjet administrative që kanë të bëjnë me këtë institucion (KSHAP), do të thotë se nuk parasheh nxjerrje të aktit nënligjor për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, siç është bërë me Udhëzimin në fjalë. Gjithashtu, as në nenin 7 të Ligjit të përmendur nuk parshifet të nxjerrjes së ndonjë akti nënligjor dhe as të aktit nënligjor që rregullon çështjen e akreditimit të institucioneve të arsimit parauniversitar. Rrjedhimisht, konstatohet se Udhëzimi Administrativ është nxjerrë pa bazë ligjore të përcaktuar me ligj. Megjithatë me qëllim të evitimit të vakumit ligjor, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.

1290	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 11/2017 PËR PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR. 12/2016 PËR AKREDITIMIN E INSTITUCIONEVE TE ARSIMIT TE LARTE NE REPUBLIKEN E KOSOVES	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	25.08.2017	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 6 paragrafi 1.13 te Ligjit nr.04/L037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr.14, 9 shtator 2011), nenit 8, nenparagrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjese administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregullores nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr15,12.09.2011,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Baza ligjore në nenin 6, nënparagrafi 1.13 është e përgjithshme dhe nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore relevante. Andaj, konstatohet se nuk ekziston baza ligjore përkatëse.Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1291	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 01/2018 PARIMET E NJOHJES SE PLATEFORMEAVE DHE REVISTAVE NDERKOMBETARE ME RECENSION	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	23.02.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 6 paragrafi 1, nenparagrafi 1.13 te Ligjit nr.04/L037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, nenit 8, paragrafi 1, nenparagrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjese administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregullores nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr15,12.09.2011,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Baza ligjore në paragrafin 1 nënparagrafi 1.13 është e përgjithshme dhe nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore relevante. Andaj, konstatohet se nuk ekziston baza ligjore përkatëse.Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1292	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 06/2018 PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E EMERTIMIT TE ANETAREVE TE KESHILLIT SHETEROR TE CILESISE TE AGJENCISE SE KOSOVES PER AKREDITIM	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	07.05.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te dispozitave te nenit 7 paragrafi 4 dhe 5, nenparagrafi 1.13 te Ligjit nr.04/L037 per Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves, dispozitave te nenit 8, paragrafi 1, nenparagrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjese administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe dispozitave te nenit 38 paragrafi 6 te Rregullores nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr15,12.09.2011,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Në nenin 7 paragrafet 4 dhe 5 të Ligjit të përmendur nuk parshihet të nxjerrjes së ndonjë akti nënligjor. Konstatohet se Udhëzimi Administrativ është nxjerrë pa bazë ligjore të përcaktuar me ligj. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin e ligjit.
1293	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 02/2018 PËR QENDRAT BURIMORE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	19.01.2018	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te neneve 17, 39, 40, 42 te Ligjit nr 04/L-032 per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr. 17/16 shtator 2011), nenit 8 nenparagrafi 1.4 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjese administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te Rregullores se punes se Qeverise nr.09/2011 (Gazeta Zyrtare nr.15, 12.09.2011),	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ne asnjërin nga paragrafet te referuara (17,39,40, 42) te Ligjit te përmendur nuk parshihet të nxjerrjes së ndonjë akti nënligjor. Konstatohet se Udhëzimi Administrativ është nxjerrë pa bazë konkrete ligjore të përcaktuar me ligj. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin e ligjit.
1294	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 03/2017 PËR KESHILLIN SHETEROR PER LICENCIMIN E MESIMDHENESVE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	19.04.2017	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te neneve 4, 21, 22 te Ligjit nr. 03/L-189 per Administraten Shtetore te Republikës se Kosoves (Gazeta Zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), ne nenin 8 (1.4) dhe shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjese administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011) si dhe duke u bazuar ne nenin 32 te Ligjit nr 04/L-032 per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Nxjerrja e këtij Udhëzimi administrative është mbështetur në nenin 4, 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 82/2011) për administratën shtetërore, dhe në nenin 32 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/16 Shtator 2011). Konstatohet se në dispozitat e mbështetura të Ligjit për administratën shtetërore nuk është paraparë asnjë bazë ligjore për rregullimin e çështjes së Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve. Ndërkaq, në nenin 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, në të cilin është mbështet nxjerrja e këtij Udhëzimi administrative, konstatohet se nenin në fjalë ka 5 paragrafe dhe asnjë paragraf nuk ka paraparë nxjerrjen e aktit nënligjor me përmbajtjen që është caktuar në Udhëzimin në fjalë. Mirëpo konsiderohet se mbështetja e bazës ligjore për nxjerrjen e Udhëzimit administrative në fjalë është në paragrafin 1 të nenit 5 të këtij ligji ku ka paraparë se "Ministri emëron anëtarët e Këshillit Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve përbërjen, procedurat e tij, pagesat dhe çështjet e tjera." Rekomandohet që Udhëzimi administrativ të harmonizohet me paragrafin 1 të nenit 32 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, në të cilin është përcaktuar baza ligjore konkrete për nxjerrjen e tij.
1295	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 04/2017 PËR VLERESIMIN E PERFORMANCES SE INSTITUCIONEVE ARSIMORE NE ARSIMIN PARAUNIVERSITAR	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	18.04.2017	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te neneve 4, 21, 22 te Ligjit nr. 03/L-189 per Administraten Shtetore te Republikës se Kosoves (Gazeta Zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), ne nenin 8 (1.4) dhe shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjese administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011) si dhe duke u bazuar ne nenin 5 te Ligjit nr 04/L-032 per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Pas analizimit të dispozitave të neneve 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 82/21 Tetor 2010) dhe të nenit 5 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/16 Shtator 2011), se në asnjë nga nenet e theksuara të ligjeve të përmendura nuk parashihet ndonjë bazë juridike për nxjerrjen e aktit nënligjor për rregullimin e çështjes për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar, përkatësisht për rregullimin e përmbajtjes që është rregulluar me këtë Udhëzim Administrativ. Do të thot se mungon baza ligjore relevante për rregullimin e vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar në dispozitat e legjislatcionit të lartëpërmendur. Vlen të theksohet se Ligji për Arsimin Parauniversitar në nenin 33 paragrafi 3.3 ka paraparë nxjerrjen e aktit nënligjor për kërkesat për zhvillim profesional dhe performancë të mësimdhënësve në kuadër të procesit të licencimit, e jo për vlerësimin e performancës së institucioneve në arsimin parauniversitar siç është rregulluar me Udhëzimin administrativ në fjalë. Gjithashtu bëhet me dije se në Ligjin për Inspektoratin Arsimor në nenin 12 paragrafi 7 është paraparë se "Licencimi dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve, drejtorit dhe zëvendës drejtorit rregullohet me akt nënligjor", do të thot as paragrafi 7 i nenit 12 të këtij ligji nuk ka paraparë rregullimin e vlerësimit të performancës së institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1296	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 06/2017 PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E APROVIMIT TE PROGRAMEVE PER ZHVILLIMIN PROFESIONAL TE MESIMSHENESVE DHE PUNONJESVE ARSIMORE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	18.06.2017	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te neneve 4, 21, 22 te Ligjit nr. 03/L-189 per Administraten Shtetore te Republikës se Kosoves (Gazeta Zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), ne nenin 8 (1.4) dhe shtojcen 6 te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjese administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011) si dhe duke u bazuar ne nenin 5 te Ligjit nr 04/L-032 per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Pas analizimit të dispozitave të neneve 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 82/21 Tetor 2010) dhe të nenit 5 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/16 Shtator 2011), se në asnjë nga nenet e theksuara të ligjeve të përmendura nuk parashihet ndonjë bazë juridike për nxjerrjen e aktit nënligjor për rregullimin e çështjes për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar, përkatësisht për rregullimin e përmbajtjes që është rregulluar me këtë Udhëzim Administrativ. Do të thot se mungon baza ligjore relevante për rregullimin e vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar në dispozitat e legjislatcionit të lartëpërmendur. Konstatohet qe ne nenin 5 te Ligjit ne fjale, nuk ka asnje baze ligjore per rregullimin e qeshites lidhur me kriteret dhe procedurat e aprovimit te programit per zhvillimin profesional te mesimshenesve dhe punonjese arsimor konsiderohet qe nuk eshte ne pajtim me legjislatcionin ne fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1297	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 16/2017 VLERESIMI PEDAGOGJIK I FEMJJEVE ME NEVOJA TE VECANTA ARSIMORE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	22.12.2017	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ne mbeshtetje te nenit 5 paragrafi 16 dhe nenit 39 te Ligjit nr.04/L032 per Arsimin Parauniversitar ne Republiken e Kosoves (Gazeta Zyrtare nr.17/16 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1.4, te Rregullores nr. 02/2011 per fushat e pergjegjese administrative te Zyres se Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 te rregullores se Punes se Qeverise nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr.15, 12.09.2011),	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konsiderojmë se baza ligjore në të cilat është bazuar nxjerrja e këtij akti nënligjor (paragrafi 16 dhe 49 i nenit 5 të Ligjit në fjalë) janë të përgjithshme dhe baza ligjore nuk është përcaktuar në dispozitat materiale të këtij ligji për rregullim me akt nën ligjor të çështjes juridike për normativin për kuadrin profesional të arësimit të përgjithshëm, konsiderohet se është edhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Vlen të theksohet se neni 5 i ligjit në fjalë ka paraparë bazën ligjore për nxjerrjen e 16 akteve nënligjore (paragrafi 1 nënparagrafi 1.8, nënparagrafet: 1.10, 2.2, 2.2, 2.3, 2.4, 3.1, 3.2, 3.3, 3.3, paragrafet: 6, 8, 9, 11, 13, 14.) dhe konstatohet qe si ne nenin 5 ashtu edhe ne nenin 39 te Ligjit ne fjale, nuk ka asnje baze ligjore per nxjerrjen e ketij Udhëzimi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij. Në rastin e harmonizimit të Ligjit në fjalë në të ardhmen, duhet pas në konsideratë edhe harmonizimin përkatësisht të përcaktimit të bazës ligjore të këtij udhëzimi administrativ në Ligji si dhe të fshirjes së paragrafi 16 të nenit 5 të këtij Ligji.



1298	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 135/2020 PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E SHËNDETIT TË NXËNËSVE GJATË MËSIMIT PRAKTIK NË SHKOLLA DHE NË VENDIN E PUNËS	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë		Neni 11, 19, 26 dhe 31 i Ligjit 04/L-038 për Arsimin dhe aftësimin profesional në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.7/26 nëntor 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se në asnjë nga nenet e theksuara në hyrje të Udhëzimit Administrativ në fjalë, si mbështetje përkatësisht bazë ligjor, nuk është paraparë në mënyrë decisive nxjerrja e aktit nëligjor për mbrojtjen dhe ruajtjen e shëndetit të nxënësve gjatë mësimit praktik në shkolla dhe në vendin e punës. Andaj, vërtetohet se nuk ekziston baza ligjore relevante për nxjerrjen e Udhëzimit administrative në fjalë, kështuqë konsiderohet se nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1299	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 21/2018 PËR PËRBËRJEN, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT PËR PROFESIONET E RREGULLUARA (KSHPRR)	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	31.12.2018	Neni 8 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 05/L-066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 38/21 Nëntor 2016)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nëligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ në fjalë e ka bazën ligjore relevante të paraparë në Ligjin nr. 05/L-066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës, përkatësisht në nenin 8 paragrafi 4.
1300	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 21/2016 D.T 09.2016 PËR NDARJEN E MJETEVE BUXHETORE NGA KATEGORIA SUBVENCIONEVE DHE TRANSFEREVE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	28.09.2016	Neni 6 paragrafet 1.5, 1.6, 1.7, 1.9, 1.10, 1.12 të Ligjit nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19/9 shtator 2011, Neni 5 paragrafi 1.4 dhe neni 14 i Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/16 Shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se në asnjë nga dispozitat e cituara (neni 6 paragrafet 1.5, 1.6, 1.7, 1.9, 1.10, 1.12 të Ligjit për arsimin e lartë dhe në neni 14 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar) si mbështetje përkatësisht bazë ligjore për nxjerrje të Udhëzimit administrative në fjalë, në mënyrë decisive, nuk është paraparë baza për nxjerrjen e këtij akti nëligjor për "Ndarjen e Mjeteve buxhetore nga Kategoria e Subvencioneve dhe të transfereve". Andaj, konstatohet se Udhëzimi Administrativ nuk është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1301	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 17/2017 PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONEVE KËRKIMORE-SHKENCORE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	22.12.2017	Nenet 8, 11, 21, 23, 24, 25 dhe 35 të Ligjit nr. 2004/42 për Veprimtari Kërkimore Shkencore	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Ligji nr. 2004/42 i d.1 27 shtator 2004 në asnjë nga nenet theksuar në hyrje të Udhëzimit Administrativ si mbështetje ligjore përkatësisht bazë ligjore për nxjerrje, nuk ka paraparë bazë ligjore për nxjerrje të aktit nëligjor për rregullimin e licencimit të institucioneve kërkimore-studimore. Gjithashtu, vlen të theksohet se Ligji në fjalë është shfuqizuar me nxjerrjen e Ligjit të ri nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 11/02 Maj 2013). As Ligji i ri nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, në asnjë nen të saj nuk parashihet nxjerrje të aktit nëligjor i cili rregullon qëshje e licencimit të institucioneve kërkimore-shkencore. Andaj, Udhëzimi administrativ nuk ka bazë ligjore relevante për nxjerrjen e tij dhe konsiderohet se është në kundërshtim me Ligjin në fjalë të shfuqizuar për edhe me Ligjin e ri në fuqi, nëse akoma zbatohet. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1302	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 07/2017 PËR THEMELIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS PËR MËSIMDHËNËSIT DHE INSTRUKTORËVE TË NIVELIT TË 5-TË	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	20.06.2017	Neni 6 paragrafi 3.2 i Ligjit për për arsim dhe aftësim profesional, neni 5 paragrafi 1.3 i Ligjit për kualifikime Kombëtare	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nëligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Vërtetohet se në nenin 6 paragrafi 3.2 të Ligjit për Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Mësimdhënësit dhe Instruktorët e nivelit të 5-të, dhe se nxjerrja e Udhëzimit Administrativ në fjalë është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe nuk ka nevojë për ndonjë rekomandim në pajtim me nenin 27 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
1303	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 15/2017 PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I PROCESIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PËR PERSONAT E PRIFUAR NGA LIRIA NË INSTITUCIONET KORREKTUESE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	08.12.2017	Neni 83 i Ligjit Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; Neni 3 dhe neni 5 paragrafi 15 dhe 16 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se sipas nenit 83 paragrafi 7 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, është paraparë nxjerrja e aktit nëligjor për rregullimin e arsimimit të personave të dënuar, i cili nxirret nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me pëlqimin e Ministrisë të Drejtësisë. Mirëpo, në hyrje të Udhëzimit Administrativ nuk vërehet se a është dhënë edhe pëlqimi i Ministrisë të Drejtësisë sikurse është paraparë me paragrafin 7 të nenit 83. Nëse nuk ekziston pëlqimi i paraparë i Ministrisë për nxjerrjen e këtij akti nëligjor, edhe pse ekziston baza ligjore për nxjerrjen e tij, konsiderohet se nuk është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi, nga se pëlqimi për nxjerrjen barazohet me autorizimin e Ministrisë të MASHT-it për nxjerrjen e tij. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.  Në qoftë se për nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ në fjalë nuk është siguruar edhe pëlqimi për nxjerrjen e tij (paragrafi 7 i nenit 83 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale), rekomandohet që të sigurohet pëlqimi i paraparë.
1304	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 09/2019 KRITERET DHE PROCEDURAT PËR AKREDITIMIN E INSTITUCIONEVE QË ZBATOJNË NJOHJEN E MËSIMIT PRAKTIK NË KOSOVE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	18.06.2016	Neni 1, 2, 4, 6, 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare i dt. 7 nëntor 2008	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se në dispozitat e mbështetura Neni 1, 2, 4, 6 dhe 17 nuk ka bazë ligjore për nxjerrjen Udhëzimit Administrativ në fjalë, përveç në nenin 16 në të cilin është paraparë se nxirret akti nëligjor nga AKK (Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve), për rregullimin e qështjeve lidhur me "kërkesat që pritet të përmbushen nga institucione të vlerësimit" (paragrafi 1 dhe 2 i këtij Ligji), ndërsa Udhëzimi administrative në fjalë rregullon "kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit praktik në Kosovë, që nuk është në pajtim me përmbajtjen e caktuar në paragrafin 1 dhe të nenit 16 të këtij Ligji. Gjithashtu, Udhëzimin administrativ në fjalë, faktikisht e ka nxjerrë Ministri i arsimit, shkencës dhe teknologjisë, që konsiderohet se nuk është në pajtim me ligjin përkatës në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1305	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 28/2016 DT. 22.11.2016 PËR GRANTET AFATSHKURTERA TË MOBILITETIT DHE PËR PUESËMARRJE NË KONFERENCA SHKENCORE DHE NËDËRKOMBËTARE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	22.11.2016	Neni 5 paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 11/2 Maj 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se në nenin 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit në fjalë nuk është paraparë se për qështjet e dhëna në dispozitën në fjalë do të nxirret akti nëligjor. Andaj, konstatohet Udhëzimi Administrativ në fjalë nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi sepse nuk ka bazë relevante për nxjerrjen e tij. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1306	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 27/2016 DT. 22.11.2016 PËR MBËSHETJEN FINANCIARE PËR APLIKIM TË FONDEVE NGA MASHT PËR BOTIME DHE PUBLIKIME SHKENCORE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	22.11.2016	Neni 5 i Ligjit Nr. 04/L-135 i Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 11/2 Maj 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se në dispozitën e mbështetur të neni 5 të Ligjit për veprimtarinë Kërkimore-Shkencore nuk është paraparë baza ligjore për nxjerrje të aktit nëligjor për rregullimin e qështjeve juridike për mbështetjen financiare për aplikim të fondeve nga MASHT për botime dhe publikime shkencore. Kështuqë, vërtetohet se për shkak të mosqësimit të baza konkrete ligjore të paraparë në Ligjin në fjalë për nxjerrjen e aktit nëligjor, Udhëzimit administrativ në fjalë nuk është në pajtim me ligjin në fuqi.
1307	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 26/2016 DT. 22.11.2016 PËR APLIKIM NË PROJEKTET E VOGLA SHKENCORE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	22.11.2016	Neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.19 i Ligjit Nr. 04/L-135 i Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 11/2 Maj 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se në Nenin 5 të Ligjit në fjalë, i cili rregullon Financimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, në asnjë paragraf dhe nënparagraf të tij nuk është paraparë nxjerrja e ndonjë akti nëligjor për rregullimin e qështjeve juridike nga ky nen, por as për qështjet juridike nga nënparagrafi 1.19 i nenit 5 ligjëdhënësi nuk ka paraparë nxjerrje të aktit nëligjor. Kjo nënkupton se Udhëzimi administrative në fjalë është nxjerrë në kundërshtim me ligjin në fuqi, për shkak se në ligjin në fjalë nuk është paraparë baza konkrete për nxjerrje të aktit nëligjor për rregullimin e aplikimit në projektet shkencore siç është vepruar me Udhëzimin në fjalë. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.

1308	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 24/2016 PËR SIGURIM TË ÇILËSISË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	09.11.2016	Neni 5, neni 49 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/16 Shtator 2011).	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se Neni 5 i ligjit në fjalë në nuk ka paraparë nxjerrje të aktit nënligjor për rregullimin e çështjes së sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar. Gjithashtu as neni 49 nuk ka paraparë nxjerrje të aktit nënligjor për përmbajtjen që ka rregulluar Udhëzimi Administrativ në fjalë. Neni 49 në pjesën e parë rregullon afatin për nxjerrjen e akteve nënligjore (brenda një (1) viti), ndërsa në pjesën e dytë flet për nxjerrje të akteve nënligjore "për çështjet që nuk mbulohe me këtë ligje" e që nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore relevante për nxjerrjen e Udhëzimit administrative në fjalë, sepse është e përgjithshme duke dhënë autorizime të pakufizueshme ministrit për nxjerrje të aktit nënligjor për çështjet për të cilat nuk është caktuar në ligji baza ligjore konkrete. Andaj konsiderohet se Udhëzimi administrativ nuk ka bazë ligjore relevante dhe nuk është nxjerrë në pajtim me Ligjin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1309	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 23/2016 D.T. 09.11.2016 PËR PLANIN ZHVILLIMOR TË SHKOLLËS DHE PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL TË ARSIMIT	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	09.11.2016	Neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/16 Shtator 2011).	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, në të cilën është mbështetur nxjerrja e Udhëzimit administrative në fjalë, në të vërtetë nuk bënë fjalë për nxjerrje të aktit nënligjor, sepse është e shprehur menjëherë juridike e cila rregullon përgjegjësit kryesore të ministrisë "për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, si dhe detyrat e përgjithshme" ku bie edhe përgjegjësia e "zhvillimit të plotkave, hartimit dhe zbatimit të legjislacionit për zhvillimin e arsimit dhe aftësimin" nënparagrafi 1.1 i paragrafi 1 të neni 5). Do të thotë se dispozita në fjalë nuk ka paraparë nxjerrjen e aktit nënligjor për planin zhvillimor të shkollës dhe Planin zhvillimor komunal të arsimit siç është rregulluar me Udhëzimin administrative në fjalë. Andaj, konstatohet se Udhëzimi administrative e nxjerrë, pa bazë ligjore konkrete, konsiderohet se nuk është nxjerrë në pajtim me ligjin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1310	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 22/2016 PËR AKTIVITETET PROFESIONALE (DEPARTAMENTET) TË SHKOLLAVE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	09.11.2016	Neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe paragrafi 6; Neni 17 paragrafi 13; Neni 49 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/16 shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se në asnjë nga dispozitat në të cilat mbështetet nxjerrja e këtij Udhëzimi administrative (neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, paragrafi 6 i neni 5, neni 17 paragrafi 13 dhe neni 49 paragrafi 1) nuk figuron baza ligjore relevante për nxjerrjen e tij. Kështu që, se ky Udhëzim administrativ është nxjerrë në kundërshtim me ligjin në fuqë, sepse nuk ka pasur bazën ligjore konkrete të paraparë në Ligjin në fjalë. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1311	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 08/2016 DT. 26.05.2016 PËR VLËRESIMIN E NXËNËSVE SIPAS KORNIZËS SË KURIKULES SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	26.05.2016	Neni 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4 i Ligjit nr. 04 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/16 Shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ në fjalë e ka bazën ligjore relevante të paraparë në Ligjin nr. 04 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/16 Shtator 2011) përkatësisht në neni 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4, që do të thotë se është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
1312	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 07/2016 DT. 05.05.2016 PËR KUSHTET DHE KRITERET E VLËRESËSIMIT TË KANDIDATËVE TË ARSIMIT PËR TË RRITUR	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	05.05.2016	Neni 5 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit Nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 2/08 Janar 2016)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të dispozitave ligjore në të cilat mbështetet Udhëzimi administrativ në fjalë, konstatohet se ky Udhëzim administrativ e ka bazën ligjore relevante dhe se është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
1313	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 18/2015 PËR SISTEMIMIN E NXËNËSVE TË ÇILËT KANË MIGRUA NGA VITI SHKOLLOR 2014/2015	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	30.10.2015	Neni 49 i Ligjit nr. 04/L-038 për Arsimin Parauniversitar (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/16 shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Neni 49 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/16 Shtator 2011), në të cilin Udhëzimi administrative është mbështet për nxjerrjen e tij, konstatohet se nuk ka të paraparë nxjerrjen të aktit nënligjor për rregullimin e çështjes së sistemit të nxënësve të cilët kanë migruar nga viti shkollor 2014/2015. Njëherit konstatohet se dispozita në fjalë është e karakterit kalimtar, në të cilin, në mënyrë të përgjithshme, në pjesën e parë, parasheh se "Ministria nxjerrë akte nënligjore brenda një (1) viti për zbatimin e këtij ligji", ndërsa në pjesën e dytë parasheh nxjerrjen e akteve nënligjore "dhe për çështjet që nuk rregullohen me këtë ligji", që do të thotë se Ministrit i jipen autorizime të pakufizueshme për nxjerrje të akteve nënligjore, që konsiderohet se është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Andaj, konsiderohet se Udhëzimi administrative në fjalë nuk ka bazë ligjore konkrete përkatësisht relevante për nxjerrjen e tij dhe konsiderohet se nuk është nxjerrë në pajtim me ligjin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1314	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 18/2015 PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE STUDENTORE DHE ZGJEDHJA E ORGANEVE DHE KËSHILLAVE NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	23.11.2015	Nenet 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës; Neni 10 paragrafi 1 dhe 6 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 14/9 Shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se as në Ligjin nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 12/21 tetor 2011 (nenet 4, 21 dhe 22) si dhe as në nenet 1 dhe 6 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 14/9 Shtator 2011), nuk është paraparë baza ligjore konkrete për rregullimin e çështjes juridike" për Organizimin e Zgjedhjeve Studentore dhe Zgjedhja e organeve dhe këshillave në Universitetin e Shkencave të Aplikuar në Ferizaj " sikurse është bërë me Udhëzimin administrativ në fjalë. Andaj, Udhëzimi administrativ në fjalë konsiderohet se nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me Ligjin për Arsimin e lartë, dhe rekomandohet harmonizimi me ligjin në fuqi për krijimin e bazës përkatëse ligjor. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1315	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 10/2015 DT. 01.09.2015 PËR KONTRATËN E PUNËS PËR MËSIMDHËNËS TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	01.09.2015	Nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës; Neni 10 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, neni 3 (a) dhe (e) të Ligjit për Arsim në komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se në nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore, në neni 10 paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit nr. 03/L-212 dhe në neni 3 paragrafi 1 nënparagrafi (a) dhe (e) nuk është paraparë nxjerrja e aktit nënligjor për rregullimin e Kontratës së punës për mësimdhënës të arsimit parauniversitar. Andaj, konkludohet se nxjerrja e Udhëzimit Administrativ në fjalë nuk bënë ligjore konkrete të paraparë në legjislacionin në fuqi, dhe konsiderohet se është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1316	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 11/2016 DT. 15.06.2016 PËR PUNËN DHE PËRQJESËSITË E KONFERENCËS SË REKTORËVE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë		Neni 6 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se sipas Ligjit nr. 04/L-038 për Arsimin Parauniversitar (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/16 shtator 2011) në neni 6 bëhet fjalë për Këshillin shtetëror për arsimin parauniversitar, ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni është paraparë nxjerrja e aktit nënligjor që ka të bëjë me Këshillin Shtetëror për Arsimin parauniversitar (KSHAK), ndërsa nuk parasheh nxjerrja e aktit nënligjor për punën dhe përgjegjësitë e Konferencës së rektorëve të institucioneve publike të arsimit të lartë, siç është rregulluar me Udhëzimin administrativ në fjalë. Andaj konsiderohet se udhëzimi administrativ nuk ka bazë ligjore relevante për nxjerrjen e tij. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1317	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 02/2016 PËR AKTIVITETET E JASHTËZAKONSHME	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	12.01.2016	Neni 23 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/16 Shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi administrativ në fjalë e ka bazën ligjore relevante të paraparë në Ligjin nr. 04 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, përkatësisht në neni 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4, që do të thotë se është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
1318	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 07/2016 DT. 05.05.2016 PËR KUSHTET DHE KRITERET E VLËRESËSIMIT TË KANDIDATËVE TË ARSIMIT PËR TË RRITUR	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	05.05.2016	Neni 5 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit Nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 2/08 Janar 2016)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të dispozitave ligjore në të cilat është mbështet Udhëzimi administrativ në fjalë, konstatohet se ky Udhëzim administrativ e ka bazën ligjore relevante dhe se është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Meqenëse Udhëzimi administrative në fjalë ka bazën ligjore relevante për nxjerrjen e tij dhe është nxjerrë në pajtim me ligjin në fuqi, nuk na nevojë për asnjë rekomandim.
1319	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 13/2016 PAJISJA E NXËNËSVE ME TEKSTE SHKOLLORE, PËRDORIMI DHE RUAJTJA E TYRE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	13.07.2016	Neni 5 paragrafi 3 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/16 Shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Në neni 5 paragrafi 3 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, në të cilin nene është bazuar nxjerrja e këtij Udhëzimi administrative, konstatohet se nuk është përcaktuar nxjerrja e aktit nënligjor për rregullimin e pajisjes së nxënësve me tekste shkollorë përdorimin dhe ruajtjen e tyre. Kështu konstatohet se nxjerrja e këtij Udhëzimi administrative nuk është nxjerrë në pajtim me ligjin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.

1320	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 03/2016 KESHILLI DREJTUES I SHKOLLËS	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	26.01.2016	Neni 49 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/16 Shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se ky Udhëzim administrative si bazë ligjore ka marrë nënën 49 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/16 Shtator 2011), e cila është e përgjithshme dhe nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore relevante, por baza ligjore konkrete është dasht të caktohet në dispozitat material juridike të Ligjit në fjalë. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1321	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 04/2016 DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS NË QENDRAT E TESTIMIT	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	05.05.2016	Neni 13 i Ligjit për Provimin e Maturës Shtetërore i Ligjit nr. 05/L-018 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 2/08 Janar 2016)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të dispozitave ligjore në të cilat është mbështetur Udhëzimi administrativ në fjalë, konstatohet se ky Udhëzim administrativ e ka bazën ligjore relevante dhe se është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Meqenëse Udhëzimi administrative në fjalë ka bazën ligjore relevante për nxjerrjen e tij dhe është nxjerrë në pajtim me ligjin në fuqi, nuk na nevojë për asnjë rekomandim.
1322	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 19/2016 PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJVE NË INSTITUCIONE PARASHKOLLORE NË KOSOVË	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	26.08.2016	Neni 2 paragrafi 1 nënparagrafi 2.3 të Ligjit për Edukimin Parashkollor (UNMIK/RREG.- 2006/11/ 6 Mars 2006)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të dispozitave ligjore në të cilat është mbështetur Udhëzimi administrativ në fjalë, konstatohet se ky Udhëzim administrativ e ka bazën ligjore relevante dhe se është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Meqenëse Udhëzimi administrative në fjalë ka bazën ligjore relevante për nxjerrjen e tij dhe është nxjerrë në pajtim me ligjin në fuqi, nuk na nevojë për asnjë rekomandim.
1323	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 19/2016 PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KESHILLIT PËR APROVIMIN E GRANTEVE SHKOLLORE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	18.08.2016	Neni 5 paragrafi 16 dhe neni 49 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/16 Shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se dispozitat ligjore në të cilat është mbështetur ky Udhëzim administrative si bazë (neni 5 paragrafi 16 dhe neni 49 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/16 Shtator 2011)), janë të përgjithshme e jo konkrete për rregullimin e çështjeve juridike për themelimin dhe funksionimin e Këshillit për aprovimin e granteve shkollore, nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore relevante, por baza ligjore konkrete është dasht të caktohet në dispozitat materiale juridike të Ligjit në fjalë. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1324	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 15/2016 LICENCIMI DHE REGJISTRIMI I INSTITUCIONEVE EDUKATIVO-ARSIMORE PARASHKOLLORE PRIVATE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë		Neni 26 të Ligjit nr. 04/L-038 mbi Edukimin Parashkollor (Gazeta zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes Kosovë nr. 1/01 Qershor 2006)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Neni 26 i Ligjit nr. 04/L-038 mbi Edukimin Parashkollor (Gazeta zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes Kosovë nr. 1/01 Qershor 2006) ka paraparë Licencimin e institucioneve parashkollore private e bën MASHT-in, që nënkupton se nuk është paraparë edhe nxjerrja e aktit nënligjor për licencimin e institucioneve parashkollore private. Andaj, konsiderojmë se nuk ekziston baza juridike për nxjerrjen e Udhëzimit administrativ në fjalë dhe se ky udhëzim administrativ nuk është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi, sepse mungon baza ligjore konkrete për nxjerrjen e tij. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1325	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 09/2016 APLIKIMI I MASAVE AFIRMATIVE DHE VENDEVE TË REZERVUARA PËR REGJISTRIM TË KANDIDATËVE NGA KOMUNITETET JO SHUMICË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	03.06.2016	Neni 6 I Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19/9 Shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se në neni 6 të Ligjit për Arsimin e Lartë nuk ekziston dispozita konkrete për nxjerrjen e aktit nënligjor me të cilin rregullohet çështja juridike për Masat Afirmative dhe vendete të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet jo shumicë në institucionet publike të arsimit. Andaj, nxjerrja e këtij Udhëzimi administrativ nuk është në pajtim me Ligjin përkatës në fuqi, sepse nuk ka bazë ligjore konkrete për nxjerrjen e tij. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1326	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 10/2016 TË DT. 7.06.2016 PËR THEMELIMIN E SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR PËR ARSIM, SHKENCË DHE TEKNOLOGJINË NË KOSOVË	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	08.09.2016	Neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësiwe administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive; Neni 38 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta zyrtare nr. 15/12.09.2011); të Vendimit të Qeverisë nr. 05/32 të dt. 03.06.2015 për Strategjinë për sistemin e Planifikimit të Integruar	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se Udhëzimi administrative në fjalë mbështeten e tij e bazon vetëm në dispozitat e Rregullores së Qeverisë nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësiwe administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive (Neni 8 nënparagrafi 1.4), në neni 38 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta zyrtare nr. 15/12.09.2011) dhe në Vendimin e Qeverisë nr. 05/32 të dt. 03.06.2015 për Strategjinë për sistemin e Planifikimit të Integruar, ndërsa nuk mbështeten në ligjin përkatës në fuqi. Kjo nënkupton se nxjerrja e këtij Udhëzimi administrativ nuk ka pazë ligjore relevante të përcaktuar në ligjin në fuqi, andaj konsiderohet se është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1327	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 06/2016 DT. 15.05.2016 PËR KUSHTET DHE KRITERET E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	05.05.2016	Neni 5 paragrafi 2 dhe paragrafi 4 I Ligjit nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 2/08 Janar 2016)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Vërtetohet se ky Udhëzim administrativ e ka bazën ligjore relevante dhe konsiderohet se është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
1328	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 05/2016 TË DT. 05.05.2016 PËR DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRUESIT DHE MBIKËQYRËSIT GJATË PROCESIT TË ADMINISTRIMIT TË PRODHIMIT TË MATURËS SHTETËRORE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	05.05.2016	Neni 14 Ligjit nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 2/08 Janar 2016)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Konstatohet se udhëzimi administrativ në fjalë është nxjerrë në pajtim me bazën ligjore relevante (paragrafi 3 i neni 4) të paraparë në Ligjin nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 2/08 Janar 2016).
1329	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 04/2015 DT. 05.05.2015 PËR DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONEVE NË QENDRAT E TESTIMIT	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	29.04.2015	Neni 14 i Ligjit Nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 2/08 Janar 2016)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Pas analizimit të dispozitave ligjore në të cilat është mbështetur Udhëzimi administrativ në fjalë, konstatohet se ky Udhëzim administrativ nuk e ka bazën ligjore relevante, nga se në dispozitën e theksuar (neni 14) është paraparë nxjerrja e aktit nënligjor për rregullimin e "themelimit, funksionimit dhe të përbërjes së Këshillit për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe për të rriturit" e jo për "detyrat dhe përgjegjësiwe e komisioneve në qendrat e testimit" siç është rregulluar me Udhëzimin administrative në fjalë. Andaj, konstatohet se ky Udhëzim administrativ nuk është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1330	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 17/2015 ORET E PUNËS TË PERSONELIT TË PUNËSUAR NË INSTITUCIONET QË I ZBATOJNË PROGRAMET PËR ARSIMIN PROFESIONAL	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	06.11.2015	Neni 24 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin profesional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Në neni 24 paragrafi 3 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, në të cilin nen është bazuar nxjerrja e këtij Udhëzimi administrative, konstatohet se është paraparë nxjerrja e aktit nënligjor për rregullimin çështjeve së punës të personelit të punësuar në institucionet që i zbatojnë programet për arsimin profesional Kështu që vërtetohet se ky Udhëzim Administrativ është nxjerrë në pajtim me ligjin në fuqi.
1331	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 15/2015 IMPELENTIMI I PROVIMEVE PËRFUNDITARE PËR MODULET PRAKTIKE PËR NXËNËSIT NË PUNËTORI-NDËRMARRJE DHE REZULTATET E TË MËSUARIT	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	30.10.2015	Neni 17 paragrafi 2 I Ligjit Nr. 04/2-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 2/21 Janar 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të dispozitave ligjore në të cilat është mbështetur Udhëzimi administrativ në fjalë, konstatohet se ky Udhëzim administrativ e ka bazën ligjore relevante dhe se është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
1332	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 14/2015 IMPELENTIMI I PROVIMEVE PËRFUNDITARE PËR MODULET PRAKTIKE PËR NXËNËSIT NË PUNËTORI-NDËRMARRJE DHE REZULTATET E TË MËSUARIT	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	30.10.2015	neni 29 paragrafi 3 I Ligjit Nr. 04/7-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7/26 mars 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Konstatohet se ekziston baza ligjore në ligjin në fjalë për nxjerrjen e këtij akti nënligjore dhe se i njëjti është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

1333	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 05/2015 NORMATIVI PËR MËSIMDHËNËSIT TË ARSIMIT PROFESIONAL	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	07.07.2015	Neni 24 paragrafi 6 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/16 Shtator 2011), nenit 19 dhe nenit 34 paragrafi 1 i Ligjit nr. 04/L-135 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 7/26 mars 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se neni 24 paragrafi 6 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar nuk ka bazë konkrete ligjore për rregullimin e çështjeve të normativit të mësimdhënësit të Arsimit profesional. Ndërsa Neni 34 paragrafi 1 pjesa e dytë ku është paraparë se Ministri nxjerrë akte nënligjore "për çështje tjera që nuk janë në kundërshtim me këtë ligj" është dispozitë e përgjithshme dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, nga se ministrit i jepen autorizime të pakufizueshme për të rregulluar çështje juridike që konkretisht nuk janë paraparë në dispozitat material të Ligjit përkatës në fuqi. Kurse neni 19 në të cilin mbështetet nxjerrja e këtij akti nënligjor në të vërtetë parasheh rregullimin me akt nënligjor të çështjeve që kanë të bëjnë me "organizimin dhe planifikimin e procesit në arsimin profesional" e jo për normativin për mësimdhënësit të Arsimit Profesional që është rregulluar me Udhëzimin administrativ në fjalë. Andaj, vërtetohet se për nxjerrjen e këtij akti nënligjor nuk ka bazë ligjore relevante dhe konsiderohet se është nxjerrë në kundërshtim me ligjin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1334	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 04/2015 THEMELIMI, FUNKSIONIMI DHE PËRBËRJA E KËSHILLIT PËR ARSIM PROFESIONAL PËR TË RRITUR	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	29.04.2015	Neni 14 dhe 15 i Ligjit nr. 04/L-138 për Arsim dhe Aftësimin Profesional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 mars 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se dispozitat ligjore në të cilat është mbështetur ky Udhëzim administrativ si bazë ligjore për nxjerrjen e tij (Neni 14 dhe 15) nuk kanë bazë ligjore relevante për nxjerrjen e tij, përkatësisht për rregullimin e çështjes juridike që ka të bëjë me themelimin, funksionimin dhe përbërjen e Këshillit për Arsim dhe Aftësimin Profesional për të rritur. Në të vërtetë neni 14 ka paraparë se "KAAPRr mund të themelojë, jo të nxjerrë akti nënligjor, komitete profesionale të përhershme dhe grupe punuese të përkohshme për të ndërmarrë aktivitetet të veçanta", ndërsa neni 15, gjithashtu nuk ka paraparë nxjerrje të aktit nënligjor për përbajtjen e Udhëzimit administrativ në fjalë, sepse vet neni e ka rregulluar përbërjen e Këshillit për Arsim dhe Aftësimin profesional (KAPPRr). Kjo bënë me dije se Ministria (MASHT) KAAPRr e themelon me Vendim e jo me Udhëzim administrativ. Konstatohet se në dispozitat e lartpërmendura, në të cilat është mbështetur nxjerrja e këtij udhëzimi administrative nuk ekziston baza ligjore konkrete për nxjerrjen e tij. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1335	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 03/2015 MBATJA E ZGJEDHJEVE STUDENTORE DHE ZGJEDHJA E ORGANEVE DHE KËSHILLAVE NË NJËSI AKADEMIKE NË UNIVERSITETIN "ISA BOLETINI" NË MITROVICË	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	27.02.2015	nenet 4, 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe nenet 1 dhe 6 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se as në Ligjin nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 12/21 tetor 2011 (nenet 4, 21 dhe 22) si dhe as në nenet 1 dhe 6 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 14/9 Shtator 2011), nuk ka bazë ligjore konkrete për nxjerrje të aktit nënligjor për rregullimin e çështjes lidhur me " Mbatjen e zgjedhjeve studentore dhe zgjedhja e organeve dhe këshillave në njësi akademike në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë". Andaj, Udhëzimi administrativ në fjalë konsiderohet se nuk ka bazë ligjore konkrete të paraparë në ligjin përkatës, kështu që konsiderohet se është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1336	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 06/2015 PËR NORMATIVIN MBI KUDARIN PROFESIONAL TË ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë		Neni 49 paragrafi 1 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/16 Shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Konstatohet se dispozita e nenit 49 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar në të cilën është mbështetur ky Udhëzim administrativ është dispozitë e përgjithshme e jo konkrete dhe nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore relevante për nxjerrjen e këtij akti nënligjor. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1337	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 01/2014 ORGANIZIMI DHE PLANIFIKIMI I PROCESIT ARSIMOR NË ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	28.01.2014	Neni 19 i Ligjit Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Konstatohet se Udhëzimi Administrativ në fjalë, pas analizimit të dispozitave ligjore në të cilat mbështet, e ka bazën ligjore relevante dhe vërtetohet se është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
1338	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 02/2014 NUMRI I NXENËSVE ME MODULE SHKOLLORE, SIGURIA E NXENËSVE	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	28.01.2014	Neni 5 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Vërtetohet se nxjerrja e këtij Udhëzimi administrativ është në pajtim me bazën ligjore të paraparë me nenin 5 paragrafi 4 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional.
1339	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 03/2014 PËR ZBATIMIN E PLANTI DHE PROGRAMIT TË ARSIMIT PROFESIONAL PËR FUSHAT: ADMINISTRATE, EKONOMI, SHËNDËTËSI, HORTICULTURE USHOIMORE, MAKINERI, ELEKTRO-HOTELERI- TURIZËM, KOMUNIKACION, KOMI-TEKNOLOGJI, NDËRTIMTARI, GRAFIKË, TEKSTIL	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	28.01.2014	Neni 24 dhe 49 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 17/16 Shtator 2011	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se ky Udhëzim Administrativ nuk ka bazë ligjore konkrete në dispozitat në të cilat është thirrë për nxjerrjen e tij. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1340	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 04/2014 KUSHTET DHE KRITERET PËR VEPRIMTARI EKONOMIKE TË INSTITUCIONEVE TË AAP	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	28.01.2014	Neni 7 pika 2 i Ligjit Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Pas analizimit të dispozitave ligjore në të cilat bazohet ky Udhëzim Administrativ, vërtetohet i njëjti e ka bazën ligjore konkrete dhe është nxjerrë në pajtim me ligjin përkatës.
1341	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 06/2014 KODI I MIRËSJELLJES DHE MASAT DISIPLINORE PËR NXENËS TË SHKOLLAVE TË LARTA	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	28.01.2014	Neni 22 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 17/16 Shtator 2011	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Pas analizimit të nenit 22 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe të nenit 31 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, konstatohet se në dispozitat në fjalë nuk është paraparë baza ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor për rregullimin e çështjeve lidhur Kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxenës të shkollave të larta sikurse është bërë me Udhëzimin administrative në fjalë. Në të vërtetë, sipas nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, është përcaktuar se "Rregullat e shkollës i miraton komuna pas pranimit të propozimit të këshillit drejtues të shkollës", që do të thot se nuk është paraparë se nxirret akti nënligjor nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kështu që, në mungesë të bazës ligjore relevante konsiderohet se Udhëzimi administrativ në fjalë nuk është nxjerrë në pajtim me ligjin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1342	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 07/2014 AVANCIMI, AUTONOMIA DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	28.01.2014	Neni 5 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se në dispozitën në të cilën bazohet nxjerrja e këtij akti nënligjor ekziston baza konkrete ligjore për nxjerrjen e tij, por aktin nënligjor në fjalë e nxjerrë Qeveria e jo Ministri, sepse paragrafi 3 i nenit 5 të Ligjit në fjalë përcakton se avancimi, autonomia dhe funksionimi institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional rregullohet me akt nënligjor, të propozuar nga Ministria përkatëse dhe të aprovuar nga Qeveria".  Rekomandohet harmonizimi me ligjin në fuqi që të nxirret nga Qeveria siç e ka përcaktuar Ligji përkatës në neni 5 paragrafi 3. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1343	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 09/2014 PËR NORMATIVIN MBI KUADRIN PROFESIONAL TË ARSIMIT	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë		Nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 82/21 Tetor 2010) dhe neni 49 paragrafi 1 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 17/16 Shtator 2011)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se në dispozitat ligjore të lartpërmendura në të cilat është mbështetur nxjerrja e këtij Udhëzimi administrativ nuk ka bazë relevante të caktuar për rregullimin e çështjeve që janë rregulluar në aktin nënligjor në fjalë. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.
1344	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 01/2014 PËRMBAJTJA E KONTRATËS PËR ORGANIZIMIN E AARR PËR KANDIDATË DHE PUNËDHËNËS	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	05.05.2014	Neni 13 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 2/21 Janar 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Vërtetohet se Udhëzimi administrativ në fjalë e ka bazën ligjore relevante të paraparë me nenin 13 paragrafi 2 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur, dhe është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

1345	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 35/2013 ORGANIZIMI I PROVIMIT PROFESIONAL PËRFUNDIMTAR	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	23.12.2013	Neni 21 paragrafi 5 Ligjit Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Vërtetohet se sipas nenit 21 paragrafi 5 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional është parapara nxjerrja e aktit nënligjor për "Implementimin e provimeve dhe vlerësimit e rezultateve mësimore", ndërsa faktikisht është nxjerrë Udhëzimi administrativ për organizimin e Provimit Profesional Përfundimtar. Konstatohet se Udhëzimi administrativ në fjalë faktikisht nuk përputhet me bazën e përcaktuar ligjore në nenin 21 paragrafi 5, sepse rregullon organizimin e provimit profesional përfundimtar, e jo implementimin dhe vlerësimit e rezultateve mësimore. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e tij. Më konkretisht, ekomandohet harmonizimi i këtij Udhëzimi administrative me bazën ligjore relevante të përcaktuar në nenin 21 paragrafi 5 i Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesionale.
1346	UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 34/2013 PËRBËRJA, FUNKSIONIMI, DETYRAT, MADNATI I PRËFAQËSIMIT TË KËSHILLAVE DREJTUES TEK INSITUCIONET E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL (AAP)	Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	23.12.2013	Neni 22 të Ligjit Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars 2013)	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Konstatohet se Udhëzimi administrative në fjalë e ka bazën konkrete ligjore dhe është nxjerrë në pajtim me ligjin në fuqi.
1726	UDHËZIM ADMINISTRATIV 04/2007 MBLEDHJA DHE SHFRYTEZIMI I MJETEVE NGA BASHKËPAGESA E SHFRYTEZUESVE TË SHËRBIMEVE SHËNDËTËSORE DHE TË HYRAVE VETANAKE TË INSTITUCIONEVE SHËNDËTËSORE	Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave	9/24/2007	"Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 "Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës", Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes", Neni 1.3 (d); Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 "Amandamentimi i Rregulloreve së UNMIK-ut 2001/19 "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes" Shtojca VI (iii). Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë së Shëndetësisë me Rregulloren Nr. 2002/5 të datës 04 Mars 2002, posaçërisht me Shtojcën VI, paragrafi (i) që e autorizon Ministrinë e Shëndetësisë, për ta zhvilluar politikën shëndetësore dhe të zbatojë legjislacionin për një sistem jo diskriminues dhe të përgjegjshëm të kujdesit shëndetësor dhe me paragrafin (ii) që e autorizon Ministrinë të bashkërendojë ofrimin e aktiviteve në sektorin e Shëndetësisë Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe me Rregulloren e UNMIK 2006/61.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Ky udhëzim nuk ka bazë ligjore. Gjithsesi në Ligjin Nr. 02/L-78 për Shëndetësinë Publike, përkatësisht Nenin 36 (3) jepet baza ligjore për nxjerrjen e një akti nënligjor në lidhje me mënyrën e krijimit dhe shpenzimit të hyrave vetanake.
1727	UDHËZIM ADMINISTRATIV 05/2007 NDALIMI I PIRJES SË DUHANIT DHE VENDOSJA E SHENJAVE TË NDALIMIT, SHENJËZIMI I PAKETIMEVE TË PRODHIMEVE TË DUHANIT NGA PRODHUESIT DHE IMPORTUESIT E TIJ	Ministria e Shëndetësisë	10/1/2007	Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 "Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës", Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes", Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 "Për ndryshimin e Rregulloreve së UNMIK-ut 2001/19 "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes" , Bazuar në Ligjin për Shëndetësi Nr.2004/4, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/31 dhe bazuar në Ligjin për Duhanin Nr. 02/L-36, neni 10, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/1,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Ligji Nr. 2004/4 është shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, si dhe Ligji Nr.02/L-36 i shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit, andaj, pas analizimit të UA, rekomandohet shfuqizimin e këtij akti nënligjor, pasi që baza ligjore për nxjerrjen e tij është shfuqizuar nga ligji tjetër.
1728	UDHËZIM ADMINISTRATIV 06/2007 NDALIMI I SHITJES SË PRODHIMEVE TË DUHANIT PERSONAVE MË TË RINJ SE 18 VJEÇ	Ministria e Shëndetësisë	10/1/2007	Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 "Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës", Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes", Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 "Për ndryshimin e Rregulloreve së UNMIK-ut 2001/19 "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes" , Bazuar në Ligjin për Shëndetësi Nr.2004/4, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/31 dhe bazuar në Ligjin për Duhanin Nr. 02/L-36, neni 10, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/1.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Ligji Nr. 2004/4 është shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, si dhe Ligji Nr.02/L-36 i shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit, andaj, pas analizimit të UA, rekomandohet shfuqizimin e këtij akti nënligjor, pasi që baza ligjore për nxjerrjen e tij është shfuqizuar nga ligji tjetër.
1729	UDHËZIM ADMINISTRATIV 07/2007 MASAT PËR ZVOGËLIMIN DHE KUFIZIMIN E PIRJES SË DUHANIT	Ministria e Shëndetësisë	10/1/2007	Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 "Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës", Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes", Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 "Për ndryshimin e Rregulloreve së UNMIK-ut 2001/19 "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes" , Bazuar në Ligjin për Shëndetësi Nr.2004/4, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/31 dhe bazuar në Ligjin për Duhanin Nr. 02/L-36, neni 10, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/1.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Ligji Nr. 2004/4 është shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, si dhe Ligji Nr.02/L-36 i shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit, andaj, pas analizimit të UA, rekomandohet shfuqizimin e këtij akti nënligjor, pasi që baza ligjore për nxjerrjen e tij është shfuqizuar nga ligji tjetër.
1730	UDHËZIMI ADMINISTRATIV 08/2007 PËR SHËRBIMIN SPITALOR NË KOSOVË	Ministria e Shëndetësisë	11/20/2007	Bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 "Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës", Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes", Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 "Për ndryshimin e Rregulloreve së UNMIK-ut 2001/19 "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes", Shtojca VI (i) që e autorizon Ministrinë e Shëndetësisë, për ta zhvilluar politikën shëndetësore dhe të zbatojë legjislacionin për një sistem jo diskriminues dhe të përgjegjshëm të kujdesit shëndetësor dhe me paragrafin (ii) Koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për nxitjen e zhvillimit koherent të politikës për shëndetësi (iii) vendos norma, standarde dhe nxjerr udhëzime administrative për sektorin e shëndetësisë, Duke u bazuar në Ligjin për Shëndetësi Nr. 2004/4, neni 17, nënparagrafi (c); Ligjin për Veprimtari Private në Shëndetësi me theks të veçantë në nenin 4 paragrafi 4.8.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i UA 08/2007, sepse ligjet në zbatimin e të cilave është nxjerrë akti nënligjor, janë shfuqizuar nga Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

1731	UDHËZIM ADMINISTRATIV 09/2007 PËR ZBATIMIN E FLETORËS PËR SHTATZËNA DHE TË FLETORËS SË SHËNETIT TË FEMJËS	Ministria e Shëndetësisë	11/23/2007	Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 "Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës", Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes", Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 "Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes" Bazuar në Ligjin për Shëndetësi Nr. 2004/4, neni 11 paragrafi 1, neni 17 paragrafi (c), neni 19 paragrafi 1 nënparagrafi (a) dhe (c), neni 20 paragrafi 1, neni 64 dhe neni 102. Në pajtim me Ligjin për Shëndetin Riprodhues Nr. 02/L-76, neni 9 paragrafi 2.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Ky udhëzim administrativ ka bazë ligjore në Nenin 9 (3) të Ligjit për Shëndetin Riprodhues 02/L-76, por kjo bazë mungon në preambulen e këtij udhëzimi administrativ. Prandaj, rekomandohet që të nxjerret udhëzimi i ri me bazën e sakte ligjore në nenin e sipërpërmendur.
1732	UDHËZIM ADMINISTRATIV 11/2007 DEPONIMI, DISTRIBUIMI DHE DISPERZIMI I PRODUKTEVE FARMACEUTIKE TË LISTËS ESENCIALE	Ministria e Shëndetësisë	27.12.2007	Në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2001/9 "Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës", Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, "Mbi Degën e Ekzekutiv të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë", Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 "Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë", Bazuar në Ligjin Për Shëndetësi Nr. 2004/4 të shpallur me Rregulloren e UNMIK Nr.2004/31, neni 33	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës konkrete ligjore me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.	Pas analizimit të UA 09/2007, konstatohet se Udhëzimi Administrativ nuk ka bazë të mirëfilltë ligjore. Megjithatë, me qëllim të evitimit të vakumit ligjor në këtë fushë, rekomandohet Ministria e Shëndetësisë që t'i krijojë bazën e mirëfilltë ligjore.
1733	UDHËZIM ADMINISTRATIV 02/2006 FORMIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONEVE PËR VLERËSIMIN E PËRMBUSHJES SË KUSHTEVE TEKNIKE DHE PROFESIONALE PËR LICENCIM TË INSTITUCIONEVE PRIVATE TË KUJDESIT SHËNETËSOR	Ministria e Shëndetësisë	2/15/2006	Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë me Rregulloren Nr. 2002/5 të datës 04 mars 2002, posaçërisht paragrafin (vi) që e autorizon Ministrinë e Shëndetësisë, për ta zhvilluar politikën dhe të zbatojë legjislacionin për një sistem jodiskriminues dhe të përgjegjshëm të kujdesit shëndetësor dhe me paragrafin (ii) që e autorizon Ministrinë të bashkërendojë ofrimin e kativiteve në sektorin e Shëndetësisë në mënyrë që ta përparojë zhvillimin koherent të politikës së mbrojtjes shëndetësore. Duke pasur parasysh, Kreu VII, Neni 18.1, të Ligjit për Veprimtarinë private në Shëndetësi, për themelimin e Komisioneve për vlerësimin e përmbushjes së kushteve teknike dhe profesionale.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Pas analizimit të UA 02/2006, rekomandohet shfuqizimi i tij, sepse ligji në zbatimin e të cilit është nxjerrë akti nënligjor është shfuqizuar nga Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.
1734	UDHËZIM ADMINISTRATIV 04/2006 EDUKIMI THEMELOR PROFESIONAL DHE PROVIMI I LICENCËS PËR PUNËTORËT SHËNETËSOR	Ministria e Shëndetësisë	4/14/2006	Mbështetur në autoritetin e dhënë IPVQ të Kosovës, nga ana e Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës; Në bazë të mandatit të Ministrisë të Shëndetësisë të përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 mbi Degën e Ekzekutiv të IPVQ të Kosovës; Duke marrë parasysh nenin 67 të ligjit për Shëndetësi të Kosovës 2/2004.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Ligji në zbatimin e të cilit është nxjerrë akti nënligjor, është shfuqizuar nga Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi. Njëherit ligji në fuqi për Shëndetësi në Nenin 70 përcakton bazën ligjore për nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ. Rrjedhimisht, rekomandohet të nxjerret akti i ri nënligjor me bazë ligjore në Nenin 70 të Ligjit në fuqi për Shëndetësinë, mirëpo vetëm për sa i përket rregullimit të çështjeve që kanë të bëjnë me praktikën dhe provimin profesional.
1735	UDHËZIM ADMINISTRATIV 05/2006 PËR ORGANIZIMIN E INSPEKTORATIT SANITAR NË RKS	Ministria e Shëndetësisë	5/22/2006	Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë me Rregulloren Nr. 2002/5 Aneksi VI pika (i), Krijon politikën dhe implementon ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor, pika (ii) Koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për nxitjen e zhvillimit koherent të politikës për shëndetësi (iii) vendos norma, standarde dhe nxjerr udhëzime administrative për sektorin e shëndetësisë, Në bazë të Ligjit Nr. 22/2003 "Për Inspektoriatin Sanitar të Kosovës", Ligjeve të aplikueshme: Ligji mbi mbikqyrjen shëndetësore të artikulave ushqimorë dhe të sendeve të përdorimit të gjërë Nr. 47/78, Ligji për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitse që rrezikojnë mbarë vendin Nr. 51/57.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Neni 2 i Ligjit Nr. 22/2003- Organizimi i Inspektoriatit Sanitar të Kosovës, në paragrafin 3 të përcakton se, "Ministria e Shëndetësisë nxjerr akte nënligjore për funksionimin e kësaj strukture."
1736	UDHËZIM ADMINISTRATIV 07/2006 QARKULLUESIT FARMACEUTIK ME PAKICË (BARNATORET)	Ministria e Shëndetësisë	6/8/2006	Duke u nisur nga Rregullorja Nr. 1999/1 të 25 Korrik-ut 1999 të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), meqë është ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/10 e 3 marsit 2000 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/11 "Përmirësimi i Direktivës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2000/12 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/10 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale", Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/19 "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes", Urdhëresa Administrative (Shëndetësi) 7/2000 "Mbi Themelimin e Agjencionit të Kosovës për Rregullatva të Barnave", Ligji për Produktet Medicinale dhe Pajisjet Medicinale Nr. 2003/26 (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/23).	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i UA 07/2006, sepse ligji në zbatimin e të cilit është nxjerrë akti nënligjor, është shfuqizuar nga Ligjin Nr. 03/L-188 për Produkte dhe Pajisje Medicinale.
1737	UDHËZIM ADMINISTRATIV 10/2006 LEJET TEKNIKE-TEKNOLOGJIKE PROFESIONALE PËR PRODHIMIN E PRODUKTEVE USHQIMORE	Ministria e Shëndetësisë	7/11/2006	Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë me Rregulloren 2002/5 Aneksi VI pika (i), krijon politikën dhe impementon ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor, pika (ii) koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent të politikës për shëndetësi, pika (iii), vendos norma standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare. Bazuar në Ligjin Nr. 22/2003 "Për Inspektoriatin Sanitar të Kosovës", Ligjin Nr. 47/78 "Mbi mbikqyrjen shëndetësore të artikulave ushqimorë dhe të sendeve të përdorimit të përgjithshëm". Me qëllim të zbatimit të Udhëzimit Administrativ (MSH) Nr. 08/2005 "Mbi standardet tekniko-teknologjike që duhet të plotësojnë objektet prodhuese ushqimore.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi Administrativ 10/2006 ka bazën ligjore të qëndrueshme tek Ligji bazik dhe funksioni i nxjerrjes së tij është në zbatim të Udhëzimit 08/2005, andaj, rekomandohet të mbetet në fuqi.

1738	UDHËZIM ADMINISTRATIV 11/2006 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.22/2003 "PËR INSPEKTORATIN SANITAR TË KOSOVËS"	Ministria e Shëndetësisë	7/11/2006	Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë me Rregulloren 2002/5 Aneksi VI pika (i), krijon politikën dhe implemton ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor, pika (ii), koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent të politikës për shëndetësi, pika (iii), vendos norma standarde dhe nxjerrë udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare. Në bazë të dispozitave të Nenit 2 dhe Nenit 37, të Ligjit Nr. 22/2003 "Për Inspektoriatin Sanitar të Kosovës", i cili autorizon Ministrinë e Shëndetësisë të nxjerrë akte nënligjore për funksionimin e Inspektoriatit Sanitar të Kosovës, si dhe është përgjegjës për implementimin e këtij Ligji	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Akti nënligjor ka bazë konkrete ligjore, andaj mbetet në fuqi.	Udhëzimi Administrativ 11/2006 ka bazën ligjore të qëndrueshme nga Ligji bazik dhe rekomandohet të mbetet në fuqi.
1739	UDHËZIM ADMINISTRATIV 19/2006 DISPERSIZIM I LISTËS ESENCIALE TË BARËRAVE NË KUJDESIN PËRËSOR SHËNDETËSOR	Ministria e Shëndetësisë	12/29/2006	Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë me Rregulloren 2002/5 Aneksi VI pika (i), krijon politikën dhe implemton ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor, pika (ii), koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent të politikës për shëndetësi, pika (iii), vendos norma standarde dhe nxjerrë udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare. Bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.08/212 të datës 23.08.06; Bazuar në Vendimin e ZMSH Nr. 95-XII-06 të Ministrisë së Shëndetësisë të datës 21.12.2006, për Dispersizimin e barërave nga lista Esenciale nga Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Pas analizimit të UA Nr.19/2006, bazës ligjore mbi nxjerrjen e këtij akti nënligjor, rekomandohet shfuqizimi i tij, për shkak se ky Udhëzim nuk e ka të përcaktuar saktë dispozitën ligjore në fuqi. I njëjti është nxjerrë duke u bazuar në rregulloren të UNMIK-ut dhe vendime të qeverisë dhe të ministrit që burojnë nga viti 2006.
1740	UDHËZIM ADMINISTRATIV 02/2005 PËR MËNYRËN E FITIMIT TË NJOHURIVE THEMELORE MBI SIGURINË DHE CILËSINË E ARTIKUJVE USHQIMOR	Ministria e Shëndetësisë	Shtator 2005	Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë me Rregulloren 2002/5 Aneksi VI pika (i), krijon politikën dhe implemton ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor, pika (ii), koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent të politikës për shëndetësi, pika (iii), vendos norma standarde dhe nxjerrë udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare. Në bazë të Ligjit për Inspektoriatin Sanitar të Kosovës Nr. 2003/22, Ligjeve të aplikueshme: Ligji mbi rregullshmrinë shëndetësore të artikujve ushqimor 47/78, Ligji mbi sëmundjet ngjitëse që rrezikojnë mbarë vendin 51/84; Udhëzimeve Administrative dhe Direktivave BE-së 93/43/EEC, 2013/13/EEC, 94/36/EEC, 88/344/EEC.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	UA Nr.19/2006, nuk e ka të përcaktuar saktë bazën ligjore tek Ligji nr. 2003/22 por vetëm në formë të përgjithësuar si dhe thirret në formë të përgjithësuar në Ligjet nr 47/78, 51/84 si dhe në Direktivat e BE-së të shfuqizuara, andaj, rekomandohet shfuqizimi i këtij akti nënligjor.
1741	UDHËZIM ADMINISTRATIV 03/2005 THEMELIMI, DETYRAT DHE PËRBERJA E KËSHILLAVE MBIKQYRESE TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE	Ministria e Shëndetësisë	2/15/2005	Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren Nr.2001/19 të datës 13 shtator 2001, si dhe me Rregulloren Nr. 2002/5 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut mbi Ekzekutivin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, në veçanti me shtojcën 6 pika (ii) që të kordinojë aktivitetet në sektorin e shëndetësisë, pika (iii) që të vendosë norma standarde dhe të nxjerrë udhëzime për sektorin e shëndetësisë në pajtim me standardet relevante ndërkombëtare, pika (iv) që të mbikqyrë zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet tjera sipas nevojës; Bazuar në Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, veçanish Kapitulli VIII, neni 49.3 për Mbikqyrjen e institucioneve shëndetësore nga Këshilli Mbikqyrës dhe Neni 49.4 mbi mënyrën e zgjedhjes, e shikarkimit dhe mandate i këshillit mbikqyrës të institucioneve.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i UA 03/2005, sepse ligji në zbatimin e të cilit është nxjerrë akti nënligjor, është shfuqizuar nga Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi
1742	UDHËZIM ADMINISTRATIV 08/2005 STANDARDET TEKNIKE-TEKNOLOGJIKE QË DUHET TI PLOTËSOJNË OBJEKTET (FABRIKAT) PRODHUESE USHQIMORE	Ministria e Shëndetësisë	Mars 2005	Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë me rregulloren Nr. 2002/5 Aneksi VI pika (i), krijon politikën dhe implemton ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor, pika (ii), koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent të politikës për shëndetësi, pika (iii), vendos norma standarde dhe nxjerrë udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare. Në bazë të Ligjit për Inspektoriatin Sanitar të Kosovës Nr. 22/2003, Ligjeve të aplikueshme: Ligji mbi rregullshmrinë shëndetësore të artikujve ushqimor 47/78, dhe Direktivave BE-së 93/43/EEC, 2000/13/EEC, 94/36/EEC, 88/344/EEC, 852/2004 (EC), 178/2002/EC.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të ndryshohet dhe plotësohet vet akti nënligjor.	Ky UA nuk e ka të përcaktuar saktë bazën ligjore për nxjerrjen e saj kur i referohet Ligjit Nr.22/2003 dhe Ligjeve të aplikueshme, prandaj, konstatohet që Udhëzimi përkatës ka mangësi në referencën e bazës ligjore. Rekomandohet të Plotësohet/Ndryshohet, në mënyrë që të reflektoj saktë bazën ligjore.
1743	UDHËZIM ADMINISTRATIV 09/2005 STANDARDET E CILËSISË PËR LICENCIMIN DHE AKREDITIMIN E INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE DHE IMPLEMENTIMI E TYRE	Ministria e Shëndetësisë	12/9/2005	Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren Nr. 2002/5 të datës 04 Mars 2002, posaçërisht me shtojcën VI, paragrafi (i) që e autorizon Ministrinë e Shëndetësisë, për ta zhvilluar politikën e punës dhe të zbatojë legjislacionin për një sistem jo diskriminues dhe të përgjithshëm të kujdesit shëndetësor dhe me paragrafin (ii) që e autorizon Ministrinë të bashkërendojë ofrimin e aktiviteteve në sektorin e Shëndetësisë në mënyrë që ta përparojë zhvillimin koherent të politikës së mbrojtjes shëndetësore; Me qëllim të krijimit të mekanizmeve për implementimin e Ligjit të Shëndetësisë posaçërisht Neneve 101 dhe 102, dhe akteve tjera ligjore për mbikqyrje të jashtme dhe të brendshme të institucioneve shëndetësore;	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i UA 09/2005, sepse ligji në zbatimin e të cilit është nxjerrë akti nënligjor, është shfuqizuar nga Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi. Rekomandohet që urgenisht të nxjerrret udhezimi i ri administrativ për tu harmonizuar me Nenin 42 (4) të Ligjit aktual për Shendetesi.
1744	UDHËZIM ADMINISTRATIV 10/2005 PËR ORGANIZIMIN E INSTITUTIT KOMBËTAR SË SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS	Ministria e Shëndetësisë	12/9/2005	Në pajtim me autorizimin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren Nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001, Rregulloren 2002/5, shtojca VI dhe Rregulloren 2005/15 që autorizon Ministrinë që të përpiloj norma dhe standarde dhe të nxjerrë udhëzime për lëminë e shëndetësisë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Ligjin e Shëndetësisë së Kosovës nr.2004/4.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i UA 09/2005, sepse ligji në zbatimin e të cilit është nxjerrë akti nënligjor, është shfuqizuar nga Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

1745	UDHËZIM ADMINISTRATIV 11/2005 PËR THEMELIMIN DHE ORGANIZIMIN E DEPARTAMENTIT FARMACEUTIK	Ministria e Shëndetësisë	12/9/2005	Në pajtim me autorizimin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren Nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001, Rregulloren 2002/5, shtojça VI dhe Rregulloren 2005/15 që autorizon Ministrinë që të përpilojë norma dhe standarde dhe të nxjerrë udhëzime për lëminë e shëndetësisë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Ligjin e Shëndetësisë së Kosovës nr.2004/4.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i UA 09/2005, sepse ligji në zbatimin e të cilit është nxjerrë akti nënligjor, është shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.
1746	UDHËZIM ADMINISTRATIV 12/2005 PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE USHQIMORE	Ministria e Shëndetësisë	12/14/2005	Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë me rregulloren Nr. 2002/5 Ankesi VI pika (i), krijon politikën dhe implemton ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor, pika (ii), koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent të politikës për shëndetësi, pika (iii), vendos norma standarde dhe nxjerrë udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare. Bazuar në: Ligjin për Inspektoriatin Sanitar të Kosovës Nr. 22/2003, Ligjin Nr. 47/78 "Mbi rregullshëmërinë shëndetësore të artikujve ushqimor", Ligji Nr.2004/17 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve", dhe në Direktivat 2000/13/EEC.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet të shfuqizohet, sepse ky Udhëzim NUK e ka të përcaktuar saktë bazën ligjore për nxjerrjen e saj që buron nga Ligji Nr. 22/2003, si dhe duke marrë në konsideratë se Ligji Nr.2004/17 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve" është shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-121 dhe Direktiva 2000/13/EC nuk është në fuqi, andaj, nxjerrja e një Udhëzimi të ri është i domosdoshëm në mënyrë që të reflektoj saktë bazën ligjore.
1747	UDHËZIM ADMINISTRATIV 13/2005 PËR PROCEDURAT E MIRATIMIT TË ETIKES	Ministria e Shëndetësisë	12/28/2005	Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë me rregulloren Nr. 2002/5 Ankesi VI pika (i), krijon politikën dhe implemton ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor, pika (ii), koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent të politikës për shëndetësi, pika (iii), vendos norma standarde dhe nxjerrë udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare. Bazuar në: Ligjin Nr. 22/2003 "Për Inspektoriatin Sanitar të Kosovës", Ligjin Nr. 47/78 "Mbi rregullshëmërinë shëndetësore të artikujve ushqimor", Ligji Nr. 2004/17 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve", dhe në Direktivat 2000/13/EEC; Me qëllim të aplikimit të Udhëzimit Administrativ (MSH) Nr. 12/2005 "Për Etikimin e Produkteve Ushqimore" datë 14.12.2005.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet të shfuqizohet, sepse ky Udhëzim NUK e ka të përcaktuar saktë bazën ligjore për nxjerrjen e saj që buron nga Ligji Nr. 22/2003, si dhe duke marrë në konsideratë se Ligji Nr.2004/17 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve" është shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-121 dhe Direktiva 2000/13/EC nuk është në fuqi, andaj, nxjerrja e një Udhëzimi të ri është i domosdoshëm në mënyrë që të reflektoj saktë bazën ligjore.
1748	UDHËZIM ADMINISTRATIV 20/2004 INSPEKTORATIT SANITAR TË KOSOVËS	Ministria e Shëndetësisë	3/30/2004	Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë me rregulloren Nr. 2002/5 Ankesi VI pika (i), krijon politikën dhe implemton ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor, pika (ii), koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent të politikës për shëndetësi, pika (iii), vendos norma standarde dhe nxjerrë udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare. Bazuar në Ligjin Nr. 22/2003 "Për Inspektoriatin Sanitar të Kosovës", Ligjeve të aplikueshme: a) Ligjin Nr. 47/78 "Mbi rregullshëmërinë shëndetësore të artikujve ushqimor", b) Ligji mbi sëmundjet ngjitëse që rrezikojnë mbarë vendin 51/84.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Ky UA nuk e ka të përcaktuar saktë bazën ligjore për nxjerrjen e saj kur i referohet Ligjit Nr.22/2003 dhe Ligjeve të aplikueshme, prandaj, konstatohet që Udhëzimi përkatës ka mangësi në referencën e bazës ligjore. Rekomandohet të Plotësohet, dhe të reflektoj saktë bazën ligjore.
1749	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 23/2004 ( NË SHËNDETËSI) ZHVILLIMI I VAZHUESHËM PROFESIONAL	Ministria e Shëndetësisë	4/16/2004	Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren Nr. 2002/5, në veçanti shtojça VI, paragrafin (iii), që të përpilojë norma dhe standarde dhe të nxjerrë udhëzime për lëminë e shëndetësisë në pajtim me standardet.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i aktit nënligjor, sepse pas analizimit është vërtetuar se i njëjti nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore.
1750	UDHËZIM ADMINISTRATIV 24/2004 VULA ZYRTARE E PROFESIONISTIT SHËNDETËSOR	Ministria e Shëndetësisë	6/7/2004	Mbështetur në autoritetin e dhënë Institucioneve të Përkohshme Vet- Qeverisë të Kosovës nga ana e Administratës së Përkohshme të Misionit Të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19, mbi Kornizën Kushtetuese për Vet-qeverisjen e Përkohshme në Kosovë' Duke i patur parasysh përgjegjësit e përcaktuara me nenin 5.4 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vet-Qeverisë të Kosovës; Në bazë të mandatit të Ministrisë së Shëndetësisë, të përcaktuar me Shtojcën VI të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/5, që plotëson Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vet-Qeverisë të Kosovës; Duke patur parasysh nenin 67, të (Projekt) Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, të miratuar në Shkurt të vitit 2004 nga Kuvendi i Kosovës.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Pas analizimit të aktit nënligjor, rekomandohet shfuqizimi i tij, pasi që i njëjti është antiligjor me faktin se është nxjerrë duke u bazuar në projektligji.
1751	UDHËZIM ADMINISTRATIV 27/2004 VEPRIMTARIA E KËSHILLIT PROFESIONAL	Ministria e Shëndetësisë	02.08.2004	Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 si dhe me Rregulloren Nr. 2002/5 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut mbi Ekzekutivin e Institucioneve të përkohshme të Vetëqeverisjes, në veçanti Shtojcën 6 pika (ii) që të kordinojë aktivitetet në sektorin e shëndetësisë, pika (iii) që vendosë norma dhe standarde dhe të nxjerrë udhëzime në sektorin e shëndetësisë në pajtim me standardet relevante ndërkombëtare, pika (iv) mbikqyrë zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet tjera sipas nevojës;	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i aktit nënligjor, sepse pas analizimit është vërtetuar se i njëjti nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore në fuqi.
1752	UDHËZIM ADMINISTRATIV 28/2004 THEMELIMI I QENDRES PËR EDUKIM TË VAZHUESHËM INFERMIERIK	Ministria e Shëndetësisë	9/8/2004	Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren nr. 2002/5, në veçanti Shtojcën 6 pika (i) që autorizon Ministrinë e Shëndetësisë të zhvillojë politikë dhe të impementojë legjislacionin për sistemin jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdes shëndetësor, paragrafin (iii) që autorizon Ministrinë të zhvillojë norma dhe standarde dhe të nxjerrë udhëzime në sektorin e shëndetësisë sa i përket standardeve ndërkombëtare; Bazuar në Udhëzimet Administrative (Shëndetësi) 18/2000, 15/2001, 16/2003 dhe 23/2004 lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve shëndetësor.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i aktit nënligjor, sepse pas analizimit është vërtetuar se i njëjti nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore në fuqi.

1753	UDHËZIM ADMINISTRATIV 30/2004 ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I SHËRBIMIT PROFESIONAL TË SHËNDETIT MENDOR TË KOSOVËS	Ministria e Shëndetësisë	9/23/2004	Në bazë të mandatit të Ministrisë së Shëndetësisë, të përcaktuar në Shtojcën VI të Rregullores së UNMIK-ut 2002/5, që plotëson Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vet-Cevisëse të Kosovës; Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001, që të përpiqej norma dhe standarde dhe të nxjerrë udhëzime në sektorin e shëndetësisë sa i përket standardeve ndërkombëtare; Në bazë të nenit 79 të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës që ka hyrë në fuqi me 20.08.2004.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Pas analizimit të UA 30/2004, rekomandohet shfuqizimi i tij, sepse ligji në zbatimin e të cilit është nxjerrë akti nënligjor, është shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.
1754	UDHËZIM ADMINISTRATIV 32/2004 PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË PRODUKTEVE MEDICINALE DHE PAJISJEVE MEDICINALE PËR TË CILAT NEVOJITET LICENCA PËR IMPORT	Ministria e Shëndetësisë	12/2/2004	Duke u nisur nga Rregullorja Nr. 1999/1 të 25 Korrik-ut 1999 të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), meqë është ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut mbi Ekzekutivin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, Shtojca VI pika (v), Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2001/19 "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë", Urdhëresa Administrative (Shëndetësi) 7/2000 "Mbi Themelimin e Agjencionit të Kosovës për Rregullativate të Barnave", Rregullorja e UNMIK-ut 2000/52 "Mbi importin, prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e prodhimeve farmaceutike, përfshirë barnat narkotike dhe substancat psikotrope", Udhëzimi administrativ (Shëndetësi) 28/2000 "Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut 2000/52 "Mbi importin, prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e prodhimeve farmaceutike, përfshirë barnat narkotike dhe substancat psikotrope" Ligji për Produktet Medicinale dhe Pajisjet Medicinale Nr. 2003/26 (Rregullorja e UNMIK-ut 2004/23, respektivisht neni 5 dhe 23 i këtij Ligji. Ligji për Aktivitetet e Tregtisë me Jashtë Nr.2002/6 (Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2003/15), respektivisht neni 16 pika (a) i këtij Ligji,	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Pas analizimit të UA 32/2004, rekomandohet shfuqizimi i tij, sepse ligji në zbatimin e të cilit është nxjerrë akti nënligjor, është shfuqizuar dhe atë: Ligji Nr.2002/6 shfuqizohet nga Ligji Nr. 04/L-048 për Tregti me Jashtë dhe Ligji Nr. 2003/26 është shfuqizuar nga Ligji Nr. 03/L-188 për Produktet dhe Pajisje Medicinale.
1755	UDHËZIM ADMINISTRATIV 03/2003 PREZENTIMI I REGJISTRIT SHËNDETËSOR UNIK NË KUJDESIN PRIMAR SHËNDETËSOR	Ministria e Shëndetësisë	2/17/2003	Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren nr. 2002/5 të datës 04 mars 2002, në veçanti Shtojca VI, paragrafi (ii) që e autorizon Ministrinë të bashkërendojë ofrimin e aktiviteteve në sektorin e Shëndetësisë në mënyrë që ta përparojë zhvillimin koherent të politikës shëndetësore dhe paragrafi (iii) që autorizon Ministrinë të zhvillojë norma dhe standarde dhe të nxjerrë udhëzime në sektorin e shëndetësisë sa i përket standardeve ndërkombëtare.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i aktit nënligjor, sepse pas analizimit është vërtetuar se i njëjti nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore në fuqi.
1756	UDHËZIM ADMINISTRATIV 08/2003 THEMELIMI I QENDRES TË MJEKËSISË SPORTIVE	Ministria e Shëndetësisë	7/1/2003	Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren nr. 2002/5 të datës 04 mars 2002, Shtojca VI, posaqërisht pika (iii) për të vendosë norma dhe standarde dhe të nxjerrë udhëzime në sektorin e shëndetësisë sa i përket standardeve ndërkombëtare, pika (vi) që i jep kësaj Ministrie të menaxhojë shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlihet me kujdesin shëndetësor nën përgjegjësinë e kësaj Ministrie, pika (vii) përkrahë pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlihen me shëndetin;	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i aktit nënligjor, sepse pas analizimit është vërtetuar se i njëjti nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore në fuqi.
1757	UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 9/2003 (NË SHËNDETËSI) MBI AUTORIZIMIN E PËRKOHSHËM TË MARKETINGUT TË PRODUKTEVE MEDICINALE TË PLASUARA NË KOSOVË	Ministria e Shëndetësisë	8/25/2003	Duke u nisur nga Rregullorja Nr. 1999/1 të 25 Korrik-ut 1999 të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), meqë është ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/10 e 3 marsit 2000 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2002/11 "Përmirësimi i Direktivës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2000/12 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/10 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale", Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/19 "Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes", Urdhëresa Administrative (Shëndetësi) 7/2000 "Mbi Themelimin e Agjencionit të Kosovës për Rregullativate të Barnave", Rregullorja e UNMIK-ut 2000/52 "Mbi importin, prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e prodhimeve farmaceutike, përfshirë barnat narkotike dhe substancat psikotrope," Udhëzimi administrativ (Shëndetësi) 28/2000 "Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut 2000/52 "Mbi importin, prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e prodhimeve farmaceutike, përfshirë barnat narkotike dhe substancat psikotrope.	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Udhëzimi Administrativ i ri do të duhej të mbështetet tek Ligji Nr. 04/L-190 për Produktet dhe Pajisje Medicinale, si dhe në legjislacionin tjetër në fuqi. Rekomandohet shfuqizimi i aktit nënligjor, sepse pas analizimit është vërtetuar se i njëjti nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore në fuqi.



1758	UDHËZIM ADMINISTRATIV 11/2003 MBI LICËNCIMIN DHE RAPORTIMIN E OPERIMIT ME PREKURSORË NË KOSOVË	Ministria e Shëndetësisë	10/22/2003	Duke u nisur nga Konventa e Kombeve të Bashkuara të vitit 1988 Kundër Trafikut legal me Barna Narkotike dhe Substanca Psikotrope, Rregullorja Nr.1999/1 të 25 Korrik-ut 1999 të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), siç është ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2002/5 "Përmirësimi i Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/19 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë", Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/10 e 3 marsit 2000 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/52 "Mbi importin, prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e prodhimeve farmaceutike, përfshirë barnat narkotike dhe substancat psikotrope", Udhëzimi administrativ (Shëndetësi) 28/2000 "Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut 2000/52 "Mbi importin, prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e prodhimeve farmaceutike, përfshirë barnat narkotike dhe substancat psikotrope", Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) 28/2000 "Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut 2000/52 "Mbi importin, prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e prodhimeve farmaceutike, përfshirë barnat narkotike dhe substancat psikotrope", Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2003/15 "Mbi shpalljen e Ligjit të Adoptuar nga Asamblea (Kuvendi) e Kosovës për Aktivitetin e Tregtisë së Jashtme", Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2003/26 "Mbi kodin e përkohshëm të procedurës penale në Kosovë" dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2003/25 "Mbi Kodin e përkohshëm penal të Kosovës",	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Rekomandohet shfuqizimi i UA dhe nxjerrja e një Udhëzimi të ri që do të kishte si referencë legjislacionin në fuqi, respektivisht, Ligjin Nr. 02/L-128 për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë, Ligjin Nr. 2003/26 për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale, Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Kodin e Procedurës Penale, Ligji Nr. 04/L-048 për Tregti me Jashtë si dhe Rregulloret në fuqi. Sa i përket legjislacionit ndërkombëtar, Udhëzimi është në nxjerr duke iu referuar Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1988 kundër Trafikut illegal me Barna Narkotike dhe Substanca Psikotrope, andaj, vlerësohet se i njëjti duhet të shfuqizohet dhe me Udhëzimin e ri të inkorporohet në tërësi baza ligjore në fuqi.
1759	UDHËZIM ADMINISTRATIV 12/2003 THEMELIMI I QENDRËS KLINIKE STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS	Ministria e Shëndetësisë	11/4/2003	Në bazë të mandatit të Ministrisë së Shëndetësisë, të përcaktuar në Shtojcën VI të Rregullores së UNMIK-ut 2002/5, që plotëson Rregullorën e UNMIK-ut 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vet-Qeverisëse të Kosovës; Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregullorën nr. 2002/5 Ankesi 6, pika (iii), për të vendosur norma dhe udhëzime administrative për sektorin e shëndetësisë duke respektuar standardet relevante ndërkombëtare; pika (vi) që i jep kësaj Ministrie të menaxhojë shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlihet me kujdesin shëndetësor nën përgjegjësinë e kësaj ministrie; pika (vii) përkrahë pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlihet me shëndetin.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Aktualisht ekziston statuti që rregullon themelimin e qendres stomatologjike. Prandaj rekomandohet shfuqizimi i këtij akti nënligjor.
1760	UDHËZIM ADMINISTRATIVE 13/2003 THEMELIMI I SPITALIT TË FERIZAJIT	Ministria e Shëndetësisë	11/10/2003	Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregullorën nr. 2002/5 Ankesi 6, pika (iii), për të vendosur norma dhe udhëzime administrative për sektorin e shëndetësisë duke respektuar standardet relevante ndërkombëtare; pika (vi) që i jep kësaj Ministrie të menaxhojë shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlihet me kujdesin shëndetësor nën përgjegjësinë e kësaj ministrie; pika (vii) përkrahë pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlihet me shëndetin; me qëllim të rregullimit të aktiviteteve të Ministrisë në përgjithësi ose të lëmvie të veprimtarisë së Ministrisë.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Aktualisht ekziston statuti që rregullon themelimin e këtij spitali. Prandaj rekomandohet shfuqizimi i këtij akti nënligjor.
1761	UDHËZIM ADMINISTRATIV 14/2003 THEMELIMI I SPITALIT NË VUSHTRË	Ministria e Shëndetësisë	11/10/2003	Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregullorën nr. 2002/5 Ankesi 6, pika (iii), për të vendosur norma dhe udhëzime administrative për sektorin e shëndetësisë duke respektuar standardet relevante ndërkombëtare; pika (vi) që i jep kësaj Ministrie të menaxhojë shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlihet me kujdesin shëndetësor nën përgjegjësinë e kësaj ministrie; pika (vii) përkrahë pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlihet me shëndetin; me qëllim të rregullimit të aktiviteteve të Ministrisë në përgjithësi ose të lëmvie të veprimtarisë së Ministrisë.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Aktualisht ekziston statuti që rregullon themelimin e këtij spitali. Prandaj rekomandohet shfuqizimi i këtij akti nënligjor.
1762	UDHËZIM ADMINISTRATIV 15/2003 PAGESA E EKSPERTËVE PROFESIONAL DHE KOMISIONEVE FUNKSIONALE	Ministria e Shëndetësisë	12/3/2003	Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregullorën nr. 2002/5 Ankesi 6, që të zhvillojë norma dhe standarde dhe të nxjerrë udhëzime administrative për sektorin shëndetësor.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të shfuqizohet akti nënligjor.	Mungon baza e saktë ligjore si referencë për nxjerrjen e aktit nënligjor. Udhëzimi Administrativ 15/2003 si referencë ka Rregullorën 2002/5 Aneksi 6, ku në terma të përgjithshëm përcaktohet autoriteti i Ministrisë për nxjerrjen e akteve nënligjore, por mungon baza ligjore në të cilën do të mbështetet nxjerrja e aktit nënligjor, andaj, rekomandohet shfuqizimi i këtij Udhëzimi.
1763	UDHËZIM ADMINISTRATIV 16/2003 EDUKIMI THEMELOR PROFESIONAL DHE PROVIMI I LICËNCËS PËR PUNTORËT SHËNDËTËSORË	Ministria e Shëndetësisë	12/12/2003	Në bazë të autoritetit dhënë Ministrisë së Shëndetësisë nëpërmjet Rregullores nr. 2002/5 Shtojca 6, që të zhvillojë norma dhe standarde dhe të nxjerrë udhëzime administrative për sektorin shëndetësor.	Uebfaqja Zyrtare e Ministrisë	Të evidentohet në Gazetën Zyrtare, Regjistrin e Akteve Nënligjore dhe Uebfaqen Zyrtare të Ministrisë.	Në Gazetë Zyrtare është i publikuar edhe një Udhëzim Administrativ Nr. 04/2006, publikuar me dt. 14.04.2006, që i referohet Edukimi Themelor Profesional dhe Provimi i Licëncës për Punëtorët Shëndetësorë, dhe i njëjti ka shfuqizuar këtë Udhëzim në Nenin 8 (1) të tij.